

BASHKIA KORÇE



PLANI STRATEGJIK PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK


2005 – 2010



NË SHËRBIM DHE NË INTERES TË KOMUNITETIT

BASHKIA E KORÇËS

Plani Strategjik për Zhvillimin Ekonomik
2005 – 2010





Ky plan strategjik është hartuar nga grupe të gjera të interesuara, nga Bashkia e Korçës nën drejtimin dhe këshillimin e Grupit të Bankës Botërore, Institutit të Shoqërisë së Hapur, LGI dhe FLAG. Grupi i Bankës Botërore, Instituti i Shoqërisë së Hapur, LGI dhe FLAG nuk mbajnë përgjegjësi për saktësinë ose përmbajtjen e strategjisë; megjithatë ato përgëzojnë Bashkinë për cilësinë e punës së bërë.



*Kopertina Kilica Graphics
Redaktorë: Artan Rroji dhe Dr. Iain Wilson
Përktheu Marsela Dhimitri
Shtypur në Maluka shpk*

E drejta e botimit © 2006 Bashkia e Korçës

Përmbajtja e Lëndës	faqe
Shkurtime	5
Fjala e kryetarit të bashkisë.....	6
I. Parathënie	8
II. Hyrje	9
III. Rëndësia e PSZhEV për komunitetin tonë	10
IV. Plani Strategjik.....	11
Struktura e Planit Strategjik	12
Filozofia që qëndron pas Planit Strategjik	12
V. Zhvillimi i Planit Strategjik	14
Parimet orientuese.....	15
Metodologjia	15
Procesi i planifikimit	16
Qasja organizative për zhvillimin e Planit	17
Forumi DELTA i Kryetarëve të Bashkisë.....	17
Pjesëmarrja dhe konsultimi.....	17
Përmbledhje e vlerësimit të gjendjes së ekonomisë vendore	20
Perceptimi i bizneseve.....	20
Vizioni dhe Qëllimet	21
Përfitimet e pritshme	23
Zbatimi i Planit.....	24
Qasja organizative për zbatimin e Planit.....	24
Financimi i Planit Strategjik	25
VI. Pamje e përgjithshme e komunitetit të Korçës.....	26
VII. Profili ekonomik i Korçës	28
Bujqësia.....	28
Veshmbathja	29
Agrobiznesi	29



Ndërtimi	30
Turizmi	30
Investimet e huaja	31
Infrastruktura.....	31
Sektori financiar dhe sistemi bankar	32
Programet e zhvillimit të qarkut.....	32
VIII. Zhvillimi i një vizioni për ZhEV	34
Përkrahja e grupeve brenda sektorit të përpunimit bujqësor.....	36
Industria e përpunimit të mishit	36
Industria e përpunimit të frutave dhe perimeve	36
Tërheqja e investimeve të huaja në sektorin e përpunimit ushqimor.....	37
Konkluzionet.....	39
IX. Dokumentet përbërëse të Planit Strategjik.....	40
a. SWOT, analiza e konsoliduar	41
b. Matrica e qëllimeve, objektivave, programeve dhe projekteve të Planit.....	43
c. Matrica e zbatimit të Planit Strategjik	47
d. Matrica e prioriteteve të projekteve.....	53
e. Fishat e projekteve.....	56
Aneksi. Raporti mbi “Monitorimin i krijimit të klimës së biznesit në qytet”	88

Shkurtime

DELTA	Drejtimi i Ekonomisë Vendore nëpërmjet Teknikave dhe Aleancave
KZhEB	Komisioni i Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë
DZhEB	Departamenti i Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë
FLAG	Fondacioni për Autonomi Vendore dhe Qeverisje
LGI	Iniciativa për Qeverinë Vendore dhe Reformën në Shërbimet Publike (pjesë e Institutit Shoqëria e Hapur e Fondacionit Soros)
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
PSZhEV	Plani Strategjik i Zhvillimit Ekonomik Vendor
SWOT	Analiza e Pikave të Forta, Pikave të Dobëta, Mundësive dhe Kërcënimeve
BB	Banka Botërore



Fjala e kryetarit të bashkisë

Qyteti i Korçës ndodhet në pjesën juglindore të Shqipërisë dhe është një nga qytetet më të mëdha në vend për sa i përket aspektit të madhësisë së popullsisë dhe sipërfaqes. Bashkia ka një infrastrukturë të zhvilluar relativisht mirë që i jep mundësi qytetarëve të gëzojnë një standart normal jetese.

Historikisht, bujqësia në Korçë ka qenë mbështetja kryesore e qarkut me tregtinë e bërë me qytetet e tjera të mëdha në Shqipëri apo vendet përreth. Qyteti rrethohet nga tokë bujqësore pjellore dhe shtrihet pranë kufijve me Greqinë dhe Maqedoninë. Pozita e saj gjeografike konsiderohet si një nga pikat e saj më të forta që favorizon zhvillimin e saj ekonomik. Megjithatë, e ardhmja e zhvillimit të agrobiznesit qëndron në konceptin e zhvillimit më të gjerë ekonomik. Për shembull, Korça është një destinacion turistik dhe shtrihet shumë pranë vendeve të tjera turistike në Shqipëri.

Avantazhe të tjera të rëndësishme të Korçës që kanë nevojë të vihen në pah janë respektimi i ligjit nga ana e qytetarëve dhe ekzistenca e traditave historike, profesionalizmi dhe kultura, ndërsa kostot e punës në qytet janë të ulëta si rezultat i pagave përgjithësisht të ulëta.

Nga ana tjetër, infrastruktura e qytetit ka nevojë për shumë përmirësime dhe buxheti i kufizuar i bashkisë nuk krijon mundësi për shumë investime, ndërsa politikat e taksave nuk favorizojnë zhvillimin e bizneseve. Niveli aktual ekonomik është i ulët dhe kjo vlen edhe për fuqinë blerëse të popullsisë. Për më tepër, qytetarët nuk shpenzojnë para.

Ekziston një rrezik i afërt që një numër i konsiderueshëm i bizneseve ekzistuese, sidomos ato të mëdhatë, të lënë qytetin. Gjatë një dekade e gjysëm të procesit të tranzicionit drejt një ekonomi tregu, strukturat ekonomike të bashkisë së Korçës kanë bërë pak duke krijuar një pengesë për zhvillimin ekonomik dhe social të qytetit. Strukturat bashkëkohore nuk kanë mundur të krijojnë mundësi punësimi.

Me qëllim ndalimin e kësaj tendence negative, bashkia ka zhvilluar tani një Strategji të re e cila ka për qëllim të promovojë zhvillimin ekonomik të qytetit të bazuar në zhvillimin lokal të bizneseve. Kjo strategji e re përqendrohet në bashkëpunimin e ngushtë midis bashkisë dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ekzistuese që shihen si një element kryesor në zhvillimin ekonomik të qytetit. Konceptet dhe metodologjia e Zhvillimi Ekonomik Vendor mbi të cilat bazohet ky bashkëpunim kanë të bëjnë me krijimin e kushteve për përmirësimin e klimës së biznesit, promovimin e krijimit të bizneseve të reja, zhvillimin e bizneseve ekzistuese, mundësinë e tyre për zgjerim si dhe tërheqjen e investuesve të huaj dhe vendas në të njëjtën kohë.

Zbatimi i këtij koncepti kërkon që autoritetet bashkiake, nëpërmjet zhvillimit të partneritetit midis qeverisë vendore dhe sektorit privat të luajnë një rol të ri në zhvillimin ekonomik të qytetit, kështu që

së bashku ato të vendosin mbi qëllimet e përbashkëta dhe të zbatojnë projektet e ZhEV. Kjo Strategji demonstroi vizionin e zhvillimit ekonomik të bashkisë në pesë vitet e ardhshme nëpërmjet mbështetjes së zhvillimit të biznesit duke zbatuar objektivat që duhet të arrihen dhe duke zbatuar programet e projektet për arritjen e këtyre objektiveve. Procesi i zhvillimit të një Plani Strategjik ishte një faktor i rëndësishëm në vendosjen e një bashkëpunimi konkret midis qeverisë vendore dhe sektorit privat.

Qëllimi final që ne kërkojmë të arrijmë është, nëpërmjet zbatimit të kësaj Strategjie, krijimi i kushteve më të mira për zhvillimin ekonomik të qytetit të Korçës dhe rrjedhimisht, krijimi i kushteve më të mira të jetesës për qytetarët e saj.

Kjo strategji është hartuar në bashkëpunim me ndihmesën e vazhdueshme të programit DELTA të Bankës Botërore, me financimin e Fondacionit SOROS.

Falënderojmë veçanërisht:

- projektin e GTZ “Mbështetje e ekonomisë private në qarkin Korçë-Pogradec” i cili punoi për përgatitjen e Vizionit të Biznesit;
- Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së Korçës;
- bizneset e qytetit.

Me synimin përmbushjen e të gjitha qëllimeve të përcaktuara në këtë Strategji, qyteti i Korçës, duke marrë parasysh burimet modeste, ka nevojë për ndihmën financiare dhe politike të qeverisë qendrore si dhe ndihmën teknike, ekspertizën dhe burimet financiare të organizatave ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri.

Robert Damo

Kryetari i Bashkisë së Qytetit Korçë



I. Parathënie

Në kuadër të programit Drejtimi i Ekonomisë Vendore nëpërmjet Teknikave dhe Aleancave (DELTA) është hartuar një strategji për Zhvillimin Ekonomik Vendor (ZhEV) të bashkive të ndryshme në Shqipëri. Programi u zbatua në Shqipëri gjatë periudhës 2004–2005 dhe u mbështet financiarisht e teknikisht nga Banka Botërore (BB; Departamenti i Zhvillimit Ekonomik Vendor) dhe Instituti për Shoqëri të Hapur (SOROS), nëpërmjet Iniciativa për Qeverinë Vendore dhe Reformën në Shërbimet Publike (LGI), Hungari. Në bashkëpunim me organizatën shqiptare Fondacioni për Autonomi Vendore dhe Qeverisje (FLAG) u përgatit një strategji për, dhe në bashkëpunim me secilën nga bashkitë e Beratit, Durrësit, Korçës, Lezhës dhe Shkodrës. Qëllimi i këtij programi ishte dhe vazhdon të jetë të zhvillojë plane strategjike të veprimit që do ndikojnë në reformimin e politikave të zhvillimit ekonomik vendor në nivel bashkiak, veçanërisht të sektorit privat.

Metodologjia e zbatuar nga DELTA promovon përmirësimin e mjedisit që mbështet dhe lehtëson zhvillimin e biznesit, si dhe forcimin e kapaciteteve dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve vendore me grupet e komunitetit në përgjithësi dhe atij të bizneseve vendore në veçanti, në krijimin e vizionit të përbashkët dhe hartimin e Planit Strategjik të Zhvillimit Ekonomik Vendor (PSZhEV).

Plani Strategjik, hartuar nga secila bashki, do t' i shërbejë institucionalizimit të bashkëpunimeve private-publike dhe zhvillimit të programeve e projekteve vendore, që do të çojnë në përgatitjen e axhendës për një zhvillim të qëndrueshëm të bashkisë. Nëpërmjet forcimit të institucioneve, infrastrukturës dhe politikave që mbështetin ndërmarrjet private, projektet e përvijuara në PSZhEV do të ndihmojnë në zhvillimin dhe fuqizimin e Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme (NVM), rritjen e mundësive vendase për punësim në të njëjtën kohë edhe rritjen e të ardhurave për buxhetin bashkiak.

Korniza e DELTA-s i dha mundësinë kapaciteteve vendore të zhvillohen nëpërmjet rishikimit periodik të procesit të planifikimit ZhEV në mënyrë që të ketë një institucionalizim të qëndrueshëm të këtij procesi pranë qeverive bashkiake.

II. Hyrje

Ndryshimi i sistemit politik në Shqipëri, transformimi i ekonomisë vendase nga shumë e centralizuar në një variant të tregut të lirë, si dhe hapja e tregjeve dhe burimeve shqiptare ndaj atyre botërore e veçanërisht atyre evropiane, komunitetet, e veçanërisht ai i biznesit, dhe qeveritë vendore u gjetën para sfidës së ndërtimit të një ekonomie të re vendore dhe një strukture biznesi të aftë për t'ju përshtatur tregut dhe konkurrencës botërore.

Gjatë periudhës së tranzicionit të Shqipërisë, struktura e biznesit ndryshoi dhe vazhdon të ndryshojë si në nivel kombëtar dhe atë vendor. Para periudhës së tranzicionit, ndërmarrjet e mëdha publike dominuan tregun, ndërsa tani ai dominohet nga NVM. Fillimi i procesit të decentralizimit, duke lejuar qeveritë vendore të kenë një influencë më të madhe në klimën e biznesit, në mënyrë të natyrshme afruan interesat e këtyre bizneseve me politikatat e qeverisë bashkiake. Çdo ditë e më shumë përgjegjësitë kryesore për ofrimin e shërbimeve dhe krijimin e rregullave lidhur me mjedisin e biznesit po transferohen nga qeveria qendrore në atë vendore.

Ky transformim i ekonomisë ka sjellë në tavolinën e punës së bashkisë një rol të ri: të udhëheqë procesin e stimulimit të rigjenerimit dhe rritjes ekonomike, duke siguruar përmirësimin në vazhdimësi të cilësisë së jetës së komunitetit nëpërmjet përmirësimit të mjedisit të biznesit vendas nga pikëpamja ekonomike dhe konkurruese.

Duke marrë parasysh këtë situatë, komunitetit po i bëhet gjithnjë e më e qartë nevoja për të bërë përpjekje më të madhe për të përcaktuar drejtimit më të rëndësishme të zhvillimit dhe të marketingut të suksesshëm të burimeve tona në mënyrë që të krijohen avantazhe konkurruese që do mbështesin bizneset ekzistuese dhe do të tërheqin biznese të reja. Kjo është e vetmja mënyrë që komuniteti ynë të mund të përdorë në mënyrë inteligjente burimet e tij me qëllim që ta bëjë sistemin e tij ekonomik të suksesshëm dhe të qëndrueshëm.

Me rëndësi në zhvillimin e tërë këtij procesi ka qenë përfshirja e drejtpërdrejtë e bashkisë në planifikimin e ZhEV në të cilin ajo ka luajtur një rol drejtues, koordinativ dhe nxitës. Procesi u mbështet më tej nga institucionet publike të qytetit, komuniteti i biznesit, shoqëria civile dhe partnerët e tjerë nëpërmjet një pune të përbashkët e cila mundësoi krijimin e një vizioni të përbashkët dhe drejtimit më të rëndësishme të përcaktuara për garantimin e një mjedisi të përshtatshëm për ZhEV dhe që përkrah bizneset dhe shton punësimin.



III. Rëndësia e PSZhEV për komunitetin tonë

Iniciativa që mori bashkia jonë për hartimin e PSZhEV është në kuadër të përpjekjeve për ushtrimin e funksionit të saj ligjor përkrahëse dhe mbështetëse e zhvillimit ekonomik brenda juridiksionit të territorit të saj duke synuar përdorimin në mënyrë sa më efektive dhe efçente të burimeve njerezore, natyrore, sociale, institucionale, financiare dhe fizike me qëllim krijimin e një mjedisi miqësor për banorët, bizneset e vizitorët.

Procesi i tranzicionit kërkon ndryshime rrënjësore që duhen bërë për të përshtatur qytetin ndaj tendencave dhe kërkesave të një ZhEV të suksesshëm. Ndërkohë shumëllojshmëria e ekonomisë vendase për t'ju përshtatur kërkesave të tregut të lirë dhe dinamikat e zhvillimit të saj kërkojnë përshtatjen dhe rivlerësimin e marrëdhënieve ekzistuese mes bashkisë dhe komunitetit për të krijuar sisteme pune dhe struktura bashkëpunimi të cilat do t'i shërbejnë rehabilitimit gradual dhe konsolidimit të vazhdueshëm të një ekonomie të shëndetshme dhe të qëndrueshme në qytetin tonë.

Në këtë situatë të re ku bashkia jonë është e hapur ndaj konkurrencës kombëtare dhe ndërkombëtare për tërheqjen e bizneseve dhe krijimin e vendeve të punës, bëhet e domosdoshme përpjekja për të përcaktuar drejtimit që duhen ndjekur në të ardhmen duke u fokusuar dhe përdorur mirë burimet ekzistuese.

Qeveria vendore ka bërë edhe më parë përpjekje për të gjetur dhe bindur investues që të vinë në komunitetin tonë, por ato kanë qenë shpesh sporadike dhe të pakoordinuara mirë me faktorët e tjerë vendas apo ndonjëherë edhe ato më të largët. Përveç kësaj, përmirësimi i mjedisit vendor nga pikëpamja fizike, e cilësisë së shërbimeve, dhe stimuluesve financiarë që kërkohen për të siguruar që bizneset ekzistuese të vazhdojnë të operojnë dhe bizneset e reja që kërkojnë të operojnë ka qenë i papërshtatshëm për shkak të autoritetit të kufizuar ligjor dhe të kapaciteteve financiare të kufizuara të bashkisë.

Pavarësisht nga këto vështirësi, roli që ajo po luan ka ardhur gjithnjë duke u fuqizuar fillimisht si një vëzhgues i zhvillimeve ekonomike dhe ecurisë së biznesit në një aktor të përfshirë aktivisht në krijimin e hapësirave dhe lehtësirave në mbështetjen direkte të biznesit dhe si gjeneruesi kryesor i rritjes ekonomike dhe punësimit. Eksperienca në zhvillimin e Planit Strategjik tregoi se vetëm qeveria vendore, si autoriteti ku kulmojnë interesat politike dhe jopolitike të grupeve të ndryshme të shoqërisë, mund ta luajnë këtë rol të rëndësishëm në nxitjen e zhvillimit ekonomik duke përvetësuar një mentalitet dhe praktika pune të reja, si dhe me anë të ruajtjes së marrëdhënieve me aktorët dhe organizatat që veprojnë në komunitetin e vet.

Komuniteti ynë ka nevojë për një qeverisje vendore të zgjuar, partneritete që funksionojnë dhe një krenari civile dhe ne besojmë se strategjia aktuale ka hedhur themelet për këtë.

IV. Plani Strategjik

Ky është i pari Plan Strategjik për ZhEV që është hartuar për bashkinë tonë dhe ai përfaqëson një përpjekje për të sjellë një ndryshim në mënyrën dhe cilësinë e qeverisjes, si dhe në procesin e vendimmarrjes.

Shfrytëzimi efektiv i avantazheve ekonomike që zotëron komuniteti ynë, si dhe nxitja e tërheqja e investuesve privatë varet shumë edhe nga cilësia e qeverisjes, shërbimeve që ofrohen, si edhe nga cilësia e politikave vendore që zhvillohen dhe zbatohen. Ato ndikojnë në infrastrukturën e shërbimeve të disponueshme për biznesin si: furnizimi me energji elektrike dhe me ujë, transport, telekomunikacion, menaxhimi i mbetjeve dhe planifikimi urban. Fakti që pjesa më e madhe e bizneseve që operojnë në bashkinë tonë janë mikro, të vogla dhe të mesme, që varen shumë nga cilësia e shërbimeve të ofruara nga qeveria vendore, e bën rolin e mëtejshëm të bashkisë edhe më të rëndësishëm në krijimin e një mjedisi miqësor që përkrah zhvillimin e biznesit.

Ky Plan Strategjik synon të korrigjojë faktorët që kanë pasur deri tani një ndikim negativ në zhvillimin ekonomik të bashkisë dhe në cilësinë e qeverisjes vendore, dhe kështu për të reduktuar pengesat dhe uljen e rreziqeve të të bërit biznes këtu. Procesi i planifikimit ndihmoi në vlerësimin e këtyre faktorëve dhe nëpërmjet kësaj procedure u realizua rishikimi aktiv i bazës ekonomike dhe faktorëve të zhvillimit të bashkisë për të krijuar një kuptim më i mirë mbi mundësitë dhe pengesat për rritjen ekonomike dhe tërheqjen e investuesve. Gjatë këtij procesi, partnerët tanë vlerësuan pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe kërcënimet (analiza SWOT), faktorët kyç që nevojiten të adresohen me qëllim që të koordinohet zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik.

Në formulimin e Planit Strategjik, Komisioni i Planifikimit ka rishikuar burimet njerezore dhe natyrore të disponueshme, gjendjen ekonomike të qytetit dhe zonës përreth saj, trashëgiminë kulturore dhe historike, avantazhet krahasuese, si dhe atë që komuniteti dëshiron dhe i nevojitet.

Ligji “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Qeverive Vendore”, Nr 8652, datë 31.07.2000, Neni 10/III, thotë se “... bashkitë do të marrin përgjegjësitë për funksionet e mëposhtme ekskluzive të Zhvillimit Ekonomik Vendor ... atë të përgatitjes së programeve për zhvillimin ekonomik lokal” duke e bërë zhvillimin e një plani strategjik një detyrim ligjor të bashkisë.

Plani aktual u përgatit për një periudhë 16 mujore. Ne e kuptojmë se ndryshimet dhe përmirësimet e dëshiruara nuk mund të bëhen brenda një kohe të shkurtër. Megjithatë, drejtuesit e bashkisë, së bashku me aktorët publik dhe privatë, do të përkushtohen në zbatimin e këtij plani afatmesëm dhe duke siguruar burimet e mjaftueshme, që ai të realizohet sa më shpejt që të jetë e mundur, sepse ky plan ka shumë të ngjarë të ketë sukses në arritjen e qëllimeve të tij. Plani u miratua nga këshilli bashkiak nëpërmjet Aktit Nr. 31 të datës 16 Maj, 2005.



Struktura e Planit Strategjik

Elementët kryesore të PSZhEV janë vizioni, qëllimet, objektivat, programet dhe projektet individuale të cilat mund të strukturohen si më poshtë:



Korça, për shkak të pozitës së saj gjeografike, traditës dhe kulturës, etj. është një nga qytetet më të rëndësishme të Shqipërisë. Plani Strategjik që ka zhvilluar është ambicioz dhe përqendrohet në pozicionimin e qytetit si:

*një qendër e rëndësishme urbane dhe arsimore;
një nxitës i zhvillimit ekonomik vendor dhe euro-rajonat;
një mjedis konkurrues për bizneset.*

Nëpërmjet krijimit të partneritetit midis qeverisë vendore dhe bizneseve, përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese ose ndërtimit të infrastrukturës së re dhe zhvillimit të burimeve njerezore, bashkia ka për qëllim të përkrahë një mjedis të përshtatshëm për lindjen e bizneseve të reja dhe rritjen e bizneseve ekzistuese. Kjo do të çojë në krijimin e vendeve të punës, rritjen e ekonomisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë banorët e qarkit.

Filozofia që qëndron pas Planit Strategjik

PSZhEV i bashkisë tonë synon të ka si qëllim të nxjerrë në pah vizionin dhe qëllimet strategjike për zhvillimin e qytetit, të orientojë dhe konsolidojë përpjekjet e bashkisë dhe komunitetit që të zhvillojë një mjedis mbështetës dhe favorizues për zhvillimin e biznesit në vend.

PSZhEV ynë është krijuar për të adresuar si nevojat e drejtuesve tanë ashtu dhe ato të komunitetit tonë të përmirësojë cilësinë e jetës për qytetarët tanë dhe të mjedisit për zhvillimin e biznesit

Bashkia dhe të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e zhvillimit filloi të zbatonte vizionin duke u përqendruar në qëllimet parësore filozofike që shtrihen pas zhvillimit të PSZhEV-it tonë:

- T'i sigurojë komunitetit dhe qeverisë vendore një dokument orientues në përcaktimin e drejtimeve të ardhshme të rritjes ekonomike;
- Të krijojë një shembull të një procesi strategjik vendimmarrës që përfshin bashkëpunimin mes politikanëve vendas dhe komunitetit të biznesit;

- Të lehtësojë përpjekjet për bashkëpunim mes partnerëve publikë dhe privat për një zhvillim të koordinuar të bashkisë;
- Të krijojë një kornizë vendimmarrëse për çështje të tilla si shërbimet publike, infrastruktura, bashkëpunimi me biznesin;
- Të krijojë një eksperiencë të re dhe vendosjen e një kulture të planifikimit të zhvillimit ekonomik;
- Të krijojë një mjedis të favorshëm për zhvillimin dhe zgjerimin e bizneseve ekzistuese, sepse ne besojmë se në një komunitet ku bizneset ekzistuese nuk janë të kënaqura, ka pak shanse që të mund të krijohen biznese të reja;
- Të ndikojë në politikat e financimit dhe mbështetjes teknike të qeverisë qendrore dhe agjencive donatorë;
- T'i japë bashkisë sonë autoritetin e duhur drejtues që kërkohet në planifikimin e zhvillimit ekonomik;
- Të mundësojë një qeverisje vendore transparente, efektive dhe që i përgjigjet me profesionalizëm nevojave dhe kërkesave të banorëve dhe vizitorëve.




V. Zhvillimi i Planit Strategjik

Zhvillimi i Planit Strategjik u përfundua sipas metodologjisë së përdorur nga Banka Botërore. Kur përdoret procesi gjithëpërfshirës i planifikimit strategjik është e rëndësishme të arrihet një marrëveshje përfshirëse ku të ekuilibrohen nevojat ekonomike, sociale dhe mjedisore.

Katër grupe, secili i përqendruar në një fushë të ndryshme, punuan për zhvillimin e një analize të përbashkët SWOT për bashkinë e cila do të bashkonte secilën nga analizat e veçanta. Pas mbledhjes dhe përpunimit të informacionit paraprak statistikor lidhur me situatën aktuale ekonomike të Korçës, u bë një studim i 70 NVM që operojnë në qytet. Çdo biznes plotësoi një pyetësor të hartuar për të mbledhur opinionet mbi një numër çështjesh. Analiza SWOT siguroi një përmbledhje të këtyre opinionëve për sa i përket zhvillimit ekonomik të qarkit.

Analiza e përgjithshme identifikoi një numër dobësish që do të paraqitnin pengesa për një zhvillim të shpejtë të qytetit të Korçës. Megjithatë, u identifikuan një numër avantazhesh që do të ndihmojnë në zhvillimin e bizneseve vendase. Nëpërmjet shfrytëzimit dhe zhvillimit të mundësive, pjesa më e madhe e pikave të dobëta dhe kërcënimeve mund të zvogëlohet ose eliminohet duke e bërë bashkinë e Korçës më tërheqëse si për investues vendas dhe të huaj.

Strategjia e ZhEV është e lidhur ngushtë me zhvillimin e bizneseve, sepse ato përbëjnë bazën e zhvillimit ekonomik. Përgatitja dhe zbatimi i strategjisë së ZhEV ishte një proces me pesë hapa, në të cilin bashkia mori pjesë dhe vazhdon të jetë e përfshirë. Këto hapa janë:



Vizioni në të cilin ka arritur qyteti i Korçës pasqyron të gjitha mundësitë e pranueshme për zhvillimin nëpërmjet përshkrimit të së ardhmes ekonomike dhe avantazheve të saj. Vizioni paraqet një drejtim të qartë për zhvillimin e ekonomisë deri në 2010 dhe më tej.

Materiali i paraqitur këtu përshkruan situatën në fonde të fazës së tretë të planifikimit të ZhEV dhe pasqyron pikëpamjet e komunitetit të Korçës nëpërmjet të cilit ka përcaktuar dhe ka rënë dakord mbi vizionin për zhvillimin e qytetit.

Parimet orientuese

Parimet që orientuan bashkinë dhe Komisionin e Planifikimit në formulimin e Planit Strategjik përfshijnë si më poshtë:

- Suksesi ekonomik balancohet me cilësinë e jetës;
- Rritja ekonomike balancohet me kërkesat sociale dhe mjedisore;
- Bashkia është një faktor kyç në përmirësimin e klimës vendore për investime;
- Bashkëpunimi midis qeverisë bashkiake, bizneseve dhe shoqërisë civile është një element kyç në progresin e qëndrueshëm ekonomik;
- Planifikim strategjik është një proces gjithëpërfshirës, i integruar dhe i institucionalizuar në bashki;
- PSZhEV përcakton drejtimit kryesore për zhvillimin ekonomik, por nuk e kontrollon atë;
- Synohet përmirësimi i të gjithë mjedisit të biznesit, dhe jo thjeshtë mbështetja e bizneseve individuale;
- Ruajtja dhe mbështetja e bizneseve ekzistuese është po aq e rëndësishme sa tërheqja e bizneseve të reja, sepse ata sillen si një mjet shumë i mirë marketingu për të përkrahur klimën e biznesit;
- Zhvillimi i punësimit duke përdorur burimet e brendshme është më i rëndësishëm se krijimi i punësimit duke përdorur faktorët e jashtëm;
- Është e rëndësishme vendosja e partneriteteve publike–private në vendimmarrje dhe në përmirësimin e ekonomisë vendore;
- Sektorit privat është gjeneruesi kryesor i zhvillimit ekonomik.

Metodologjia

Qeveria jonë bashkiake e konsideron PSZhEV si metoda më e mirë dhe sistematike e dobishme për të menaxhuar ndryshimin, për të siguruar konsensusin e komunitetit dhe për të krijuar një vizion të përbashkët për një të ardhme ekonomike më të mirë. Procesi i planifikimit strategjik mundësoi



kombinimin e përpjekjeve dhe burimet që do të çojnë në përmirësimin e situatës ekonomike dhe si rezultat, në krijimin e një kornize që synon krijimin e një mjedisi të shëndetshëm, të balancuar mirë për ekonominë dhe një cilësi të përmirësuar të jetës për qytetarët. Edhe pse përvijuar këtu kaq thjeshtë, kjo metodologji rezultoi të ishte shumë komplekse duke pasur parasysh sasinë e përpjekjeve dhe vendimmarrjen e kërkuar.

Procesi i planifikimit strategjik u shoqërua me aktivitete të ngritjes së kapaciteteve dhe të lehtësimit të procesit. Në funksion të ngritjes së kapaciteteve, DELTA organizoi një udhëtim studimor në Hungari ku u mbajtën tre seminare të shkurtra mbi çështjet e mëposhtme:

- Etapat dhe teknikat për zhvillimin e PSZhEV;
- Strukturat institucionale për zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e PSZhEV në partneritet me komunitetin;
- Njohja me praktikat më të mira rajonale në PSZhEV;
- Metodologjia e zhvillimit dhe prioritarizimit të projekteve.

Procesi i planifikimit

Baza e një procesi efektiv të planifikimit strategjik qëndron në të kuptuarit e çështjeve më të rëndësishme me të cilat përballohet komuniteti. Çështja e zhvillimit ekonomik duhet të paraqitet si një nga problemet për t'u zgjidhur, një nga nevojat për t'u adresuar dhe një nga mundësitë për t'u përdorur. Procesi që u aplikua këtu mundësoi njësimin e opinioneve dhe zgjedhjeve të qeverisë vendore me ato të biznesit dhe agjencive të tjera përfaqësuese.

Procesi i planifikimit u strukturua të kryhej në 5 faza:

1. Organizimi i përpjekjeve;
2. Vlerësimi i konkurrencës së ekonomisë vendore;
3. Zhvillimi i strategjisë;
4. Zbatimi i strategjisë;
5. Rishqyrtimi i strategjisë.

Gjatë periudhës së procesit të planifikimit ishin konsideruar një numër konsultimesh, vlerësimesh dhe vendimmarrjesh të përbashkëta lidhur me prezantimin dhe prioritetin e çështjeve kyçe për zhvillimin ekonomik.

Aktualisht bashkia ka përfunduar tre fazat e para dhe ka filluar fazën e katërt.

Qasja organizative për zhvillimin e Planit

Qasja organizative ishte e tillë që mundësoi një vendimmarrje direkte dhe të institucionalizuar të një grupi të gjerë personash ku bënë pjesë përfaqësues të komunitetit së bashku me kryetarin e bashkisë, anëtarë të këshillit bashkiak dhe staf i qeverisë bashkiake.

Pjesëmarrja u institucionalizua dhe strukturua me anë të Komisionit të Planifikimit të ZhEV të ngritur dhe kryesuar nga kryetari i bashkisë. Roli i Komisionit ishte të hartonte draftin dhe të rishikonte Planin Strategjik, dhe kjo përgjegjësi vazhdon me mbikëqyrjen dhe vlerësimin e zbatimit të planit. Struktura e Komisionit u ndërtua në mënyrë të tillë që lejoi grupimin e anëtarësisë sipas fushave të zhvillimit dhe të interesit.

Element kyç në këtë strukturë ishte dhe mbetet Grupi Kryesor i drejtuar nga Departamenti i Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë (DZhEB) dhe ku komuniteti i biznesit ka një përfaqësues. Grupi Kryesor luante një rol kyç në koordinimin e punës midis anëtarëve të komisionit me partnerët e DELTA dhe me agjencitë dhe organizatat në nivel vendor e qendror, të interesuara dhe të angazhuara në zhvillimin e bashkisë.

Forumi DELTA i Kryetarëve të Bashkisë

Gjatë zbatimit të programit DELTA, krijimi dhe funksionimi i Forumit DELTA i Kryetarëve të Bashkive ka shërbyer si katalizator në procesin e zbatimit të programit dhe si një forum ku kryetarët e bashkive dhe drejtuesit e grupit të Zhvillimit Ekonomik Vendor (ZhEV) mund të shkëmbenin eksperiencat dhe të hartonin planet e punës. Pesë forume u mbajtën gjatë procesit të planifikimit të ZhEV. Me qëllim lehtësimin e shkëmbimit të informacionit, kryetarët e bashkive ranë dakord se një mjet shumë i rëndësishëm do të ishte krijimi dhe mirëmbajtja e një faqeje interneti për secilën nga pesë bashkitë e përfshira në programin DELTA.

Pjesëmarrja dhe konsultimi

Formulimi i dokumentit të Planit Strategjik ishte synimi kryesor i bashkisë, por ajo pati si qëllim të përfshinte në procesin e planifikimit aktorë të tjerë të cilët do të kishin një rol vendimtar në zhvillimin e strategjisë. Do të ishte e pamundur për qeverinë tonë vendore të realizonte procesin e vetme. Kështu që, ishte e nevojshme që të përfshihej edhe ekspertiza e personave të tjerë nga komuniteti që mund t'i sillnin procesit një gamë të gjerë eksperiencash duke siguruar që individëve më të aftë në komunitet t'u ofrohej mundësia për të paraqitur opinionet dhe preferencat e tyre për të adresuar çështjet më kritike që kanë të bëjnë me rritjen dhe zhvillimin ekonomik vendor

Gjithsej, në procesin e planifikimit morën pjesë 40 persona nga komuniteti përfshirë përfaqësues




të qeverisë vendore, komuniteti i biznesit, bankat, institucionet arsimore, përfshirë universitetet, ndërmarrjet publike, OJQ, si dhe qytetarë të tjerë të njohur në komunitet për nivelin e tyre të ekspertizës dhe kontributin në shoqëri.

Qeveria bashkiake bëri një përpjekje të madhe për të mbajtur të angazhuar dhe të fokusuar këtë grup të gjerë aktorësh gjatë gjithë procesit të planifikimit strategjik të cilët dhanë ndihmë të paçmuar në formulimin e draft Planit Strategjik.

Si rezultati i kësaj përfshirjeje, pjesëmarrja direkte e personave jashtë qeverisë vendore të cilët kontribuan në proces i dha Planit Strategjik një pronësi të plotë vendore.

Lista e pjesëmarrësve:

Mikel Dishnica	Drejtorja e Zhvillimit, Sektori i Informacionit, Bashkia
Albana Çule	Sektori i Koordinim–Zhvillimit, Bashkia
Bjanka Llogori	Sektori i Koordinim–Zhvillimit, Bashkia
Erjola Stermoll	Sektori i Koordinim–Zhvillimit, Bashkia
Leonard Gjançi	Drejtorja e Punëve Publike, Bashkia
Valbona Ziko	Drejtorja e Financës, Bashkia
Kristaq Orgocka	Drejtorja e Financës, Bashkia
Zhaneta Lubonja	Drejtorja e Planifikimit Urban, Bashkia
Ermal Gjermani	Drejtorja e Planifikimit Urban, Bashkia
Irma Themeli	Drejtorja e Planifikimit Urban, Bashkia
Spartak Babo	Drejtorja e të Ardhurave, Bashkia
Liljana Beta	Drejtorja Juridike, Bashkia
Pandi Miholli	Drejtorja e Punëve Publike, Bashkia
Vangjush Dishnica	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike
Roland Karanxha	Teatri “Andon Z. Çajupi”
Vladimir Topi	Qendra kulturore “Vangjush Mio”
Skender Rusi	Biblioteka “Thimi Mitko”
Ylli Mustafai	Drejtor, Drejtorja Arsimore Rajonale
Besnik Skënderasi	Drejtor, Drejtorja Bujqësore Rajonale
Bardhi Naçi	Drejtor, Drejtorja e Korporatës Energjitike Shqiptare
Niko Peleshi	Kryetar, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë
Gjergji Dako	Drejtor, Banka “Tirana”
Sotiraq Filo	Drejtor, Banka Raiffeisen”
Tomi Bixho	Drejtor, Banka Greke
Andrea Mano	Biznes
Thanas Kote	Biznes Ndërtimi
Gjergji Sllavi	Biznes Ndërtimi





Lida Kushe	Biznes Ndërtimi
Servet Feka	Biznes Ndërtimi
Gjergji Pendavinji	Rektor, Universiteti i Korçës
Arben Belba	Lektor, Universiteti
Dhimiter Bello	Lektor, Universiteti
Elena Qirici	Lektor, Universiteti
Gjergji Çikopani	Drejtor, Kolegji “Raqi Qirinxi”
Lorenc Glozheni	Drejtor, Muzeu i Mesjetës
Skender Aliu	Drejtor, Muzeu Arkeologjik
Aleko Papakozma	Arkitekt
Aurel Grabocka	Drejtor, Agjencia Rajonale e Zhvillimit
Robert Stratobërda	Përfaqësues i Shoqërisë Civile

Përmbledhje e vlerësimit të gjendjes së ekonomisë vendore

Gjendja aktuale e ekonomisë vendore të Korçës ishte baza e një analize SWOT (Pikat e Forta, Pikat e Dobëta, Mundësitë dhe Rreziqet) e cila mori parasysh të dhënat bazë ekonomike dhe sociale, si dhe pikëpamjet vendase të shprehura në një sondazh biznesi si dhe ato të Komisionit të Planifikimit.

Të dhënat e mbledhura përmbanin statistikën dhe informacionet në lidhje me burimet vendase natyrore, njerezore dhe financiare, strukturën e ekonomisë dhe bizneset, nivelin dhe strukturën e punësimit, si dhe arsimin dhe kualifikimet e fuqisë punëtore.

Gjatë zhvillimit të analizës SWOT, Komisioni i Planifikimit përfshiu një analizë sektoriale të zhvilluar nga ekipet e punës. Analiza SWOT u përdor si platforma bazë për zhvillimin e Planit Strategjik. Analiza e situatës vendase u vazhduar nga anëtarët e Komisionit të Planifikimit të cilët identifikuan avantazhet dhe vështirësitë kryesore të rritjes ekonomike me të cilat përballlet komuniteti ynë.

Perceptimi i bizneseve

Qeveritë vendore kanë mandatin e promovimit të zhvillimit të NVM në qytet. Megjithatë ky mandat konsiderohet nga sektori privat si i kufizuar ligjërisht sidomos përse i përket sigurimit i burimeve për ndërmarrjen e aktiviteteve të bizneseve.

Për të hyrë pak më thellë në këtë çështje dhe për të kuptuar shqetësimet e biznesit vendas më në detaje, një sondazh u zhvillua në qytet. Qëllimi i sondazhit ishte mbledhja e informacionit dhe e mendimeve të komunitetit të biznesit mbi situatën ekonomike në vend, perspektivën e të bërit biznes këtu, kushtet dhe rregullat që ndikojnë në zhvillimin e bizneseve vendore, politikën dhe praktikën që pengojnë zhvillimin e bizneseve ekzistuese si dhe kërkesat dhe nevojat e komunitetit për përmirësimin e klimës së biznesit.

Sondazhi mbi “Klimën e Biznesit” u zhvillua në mars–prill 2004 dhe **70 biznese** nga kategori të ndryshme morën pjesë në të.

Perceptimi kryesor i bizneseve është se qeveritë vendore nuk kanë mjetet e duhura ose autoritetin e duhur për të ndihmuar në zhvillimin e NVM. Ky perceptim bëhet më i dukshëm nga mungesa e komunitetit dhe dialogu i varfër midis qeverisë vendore dhe biznesit.

Përfshirja e mendimit të biznesit në formulimin e Planit Strategjik ishte një etapë e rëndësishme në hapjen e procesit të vendim-marrjes. Nëpërmjet këtij hapi, mendimet e një grupi personash që kanë influencën më të madhe mbi zhvillimin ekonomik të bashkisë u morën.

Shtatëdhjetë (3.9%) nga 1,800 bizneset e regjistruara në bashkinë e Korçës ishin në qendër të sondazhit, nga të cilët: 24 ishin biznese prodhimi, 25 merreshin me tregti, 15 me sigurimin e shërbimeve dhe 6 me ndërtim. Këto biznese kishin qenë aktive për një periudhë nga 1 në 10 vjet dhe shumë prej tyre për një periudhë nga 6 në 10 vjet. Nga këto bizneset, 46 kishin një pronar, 19 kishin më shumë se një pronar edhe 5 ishin kooperativa. Më tepër se gjysma, 37, nga bizneset, kishin më pak se 5 punonjës (më shumë se një), 10 kishin nga 6 në 10 punonjës, 16 kishin 11 deri në 50 punonjës dhe 7 kishin më tepër se 50 punonjës.

Vizioni dhe Qëllimet

Vizioni

Qëllimi i përcaktimit të vizionit për zhvillimin tonë ekonomik vendor ishte që t’i mundësonte komunitetit tonë të artikulojë se ku ai dëshiron të jetë në të ardhmen dhe çfarë rruge do të ndjekë për të arritur atje. Vizioni do t’u japë qytetareve dhe qeverisë vendore një ide të qartë se çfarë duhet bërë dhe ku duhen përqendruar energjitë dhe burimet e tyre.

Vizioni u zhvillua nga Komisioni i Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë (KZhEB) pas konsultimeve me segmente të ndryshme të komunitetit dhe pasi u prezantua publikisht nëpërmjet mediave lokale. Synimi ishte të krijohet një vizion i cili të mund të zhvillohet dhe të pranohet nga sa më shumë aktorë dhe grupe interesi të mundshëm dhe që do të sigurojë një përshkrim të hollësishëm të ardhmes së preferuar ekonomike të qytetit tonë.

Një vizion në këtë kontekst, është një ideal i cili i ka rrënjët në realitetin natyror, gjeografik, ekonomik, historik e kulturor të qytetit. Ai synon të përmbushë pritshmëritë dhe aspiratat e komunitetit dhe të përcaktojë një drejtim të qartë për zhvillimin e qytetit. Ne besojmë se në rastin tonë ai përmbledh në mënyrë realiste dëshirat dhe kapacitetet e komunitetit tonë. Ne synojmë që këtë vizion ta ndajmë në vazhdimësi me grupe të komunitetit tonë në mënyrë që ai të njihet dhe të pranohet më gjerë dhe kështu, të kthehet në një udhërrëfyes për ta bërë realitet këtë ideal.




Vizioni ynë do të rivlerësohet nga komuniteti, duke përfshirë vendimmarrësit në qeverinë vendore për të reflektuar ndonjë ndryshim të nevojshëm, dëshirat dhe rrethanat e reja, si dhe vlerësimet fondet.

Qëllimet

Përcaktimi i qëllimeve të ZhEV na ndihmon të marrim vendime lidhur me rrugët dhe mënyrat për të arritur ndryshimet që nevojiten. Megjithëse disa nga qëllimet dhe veprimet për arritjen e tyre nuk lidhen direkt me krijimin e vendeve të punës dhe me zhvillimin dhe tërheqjen e bizneseve, e ardhmja e komunitetit tonë bazohet mbi themele të shëndosha si niveli i arsimimit dhe cilësia e jetës, infrastruktura dhe shërbimet bashkiake. Në konceptin tonë, bizneset nuk zhvillohen, nuk lulëzojnë dhe nuk mund të tërhiqen në komunitete ku nuk ofrohen nivele dhe cilësi e përshtatshme e infrastrukturës dhe shërbimeve që kërkon një mjedis i mirë për zhvillimin e biznesit.

Për të arritur qëllimet e ZhEV, qyteti ynë është përqendruar në përdorimin e burimeve të veta natyrore dhe njerëzore. Për zhvillimin e qëllimeve, Komisioni i Planifikimit mori parasysh mundësitë dhe sfidat me të cilat ballafaqohet bashkia, historinë e vet të zhvillimit ekonomik dhe të qarkut.



Qëllimet e ZhEV shprehin drejtimet kryesore që do të ndjekë zhvillimi i bashkisë. Këto janë renditur në faqen tjetër sipas rëndësisë për ZhEV dhe krijimit të një mjedisi të favorshëm. Ato janë zhvilluar me anën e një analize logjike të kujdesshme të vizionit dhe trajtojnë çështje thelbësore për zhvillimin e qytetit.

Përfitimet e pritshme

Përfitimet që priten si rezultat i zbatimit të Planit tonë Strategjik janë të shumfishta, por më kryesoret janë si më poshtë:

- Orientimi i këshillit bashkiak dhe administratës së bashkisë në procesin e buxhetimit vjetor dhe afatmesëm duke u fokusuar në zbatimin e projekteve të përfshirë në PSZhEV;
- Fokusimi tek burimet njerezore dhe financiare në fushat e identifikuara duke rritur maksimalisht përfitimet dhe mundësuar arritjen e qëllimeve dhe objektivave të PSZhEV;
- Fuqizimi i partneritetit të qëndrueshëm në vendimmarrje me bashkëfinancim të qeverisë vendore dhe komunitetit të biznesit;
- Rritja e kapaciteteve të administratës së bashkisë dhe veçanërisht të DZhEB;
- Koordinimin e aktiviteteve të organizatave dhe agjencive të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e pjesëve të ndryshme të PSZhEV;
- Përcaktimi i një kalendari realist për zbatimin e PSZhEV;
- Identifikimi i rezultateve të pritshme;
- Zhvillimin e një sistemi eficient komunikimi mes bashkisë dhe partnerëve të saj;
- Lehtësimin e marketingut të potencialeve dhe të mundësive që të bëhet biznes në qytet;
- Krijimin e një sistemi monitorues në bashkëpunim me komunitetin me qëllim ndjekjen e aktiviteteve dhe vlerësimin të rezultateve të parashikuara nga PSZhEV;
- Përmirësimin e sistemit të menaxhimit në bashki në funksion të zbatimit të programeve të përfshira në matricën e Planit;
- Orientimin e grupimit dhe të negocimit me aktorët vendorë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë që janë të interesuar ose që janë përfshirë në projekte në PSZhEV;
- Orientimin e qeverisë vendore dhe donatorëve në dhënien e fondeve dhe në përqendrimin tek burimet ekzistuese të disponueshme.



Zbatimi i Planit

Një PSZhEV është plani zyrtar për administrimin e qeverisë vendore, institucioneve dhe ndërmarrjeve që ka nën kontroll dhe si i tillë, është një plan që zhvillohet vazhdimisht. PSZhEV për qytetin tonë ka filluar dhe do të ndjekë katër faza:

1. Aktivizimi i burimeve të financimit dhe dhënia e fondeve;
2. Realizimi i partneriteteve publiko-private;
3. Monitorimi dhe vlerësimi i Planit;
4. Rivlerësimi dhe përmirësimi i Planit.

Duke qenë se afati i zbatimit të PSZhEV është më i gjatë se mandati politik, sukcesi i zbatimit të strategjisë do të varet shumë nga angazhimi i vazhdueshëm i qeverisë vendore dhe shoqërisë civile në arritjen e objektivave dhe zbatimin e projekteve të përvijuara.

Këshilli bashkiak, si faktori kyç në mbështetjen e PSZhEV, do të garantojë dhënien e fondeve bashkiake për financimin e projekteve. Përveç kësaj, ai do të ofrojë këshilla efektive për miratimin e përmirësimeve që do të sugjerohen nga Komisioni i Planifikimit dhe autoriteti ekzekutiv i qeverisë bashkiake.

Kryetari i bashkisë dhe Shefi i DZhEB do të koordinojnë programet, projektet dhe financimet e qeverisë qendrore, donatorëve dhe organizatat vendase dhe të huaja në mënyrë që ato të ndjekin dhe mbështesin PSZhEV. Përveç kësaj, ata do të iniciojnë dhe do të realizojnë përmirësimet e mjaftueshme në menaxhimin e procesit dhe do të ristrukturojnë stafin në funksion të zbatimit të PSZhEV. Sukcesi i zbatimit të Planit do të varet më së shumti nga mënyra se si organizatat dhe agjencitë e përfshira në Planin Strategjik do të menaxhojnë elementët veçantë për të cilat ata janë përgjegjës.

Ndërkohë që komuniteti do të njohë progres me zbatimin e PSZhEV, vetë plani do të ketë nevojë të rishikohet, vlerësohet dhe përmirësohet për të adresuar situatat dhe kushtet e reja. Komisioni i Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë (KZhEB) do të monitorojë dhe vlerësojë zbatimin e Planit duke mbajtur në mendje faktin se edhe komuniteti duhet të marrë pjesë në procesin e monitorimit.

Qasja organizative për zbatimin e Planit

Bashkia caktoi KZhEB si institucionin kryesor që do të rishikojë dhe vlerësojë procesin e zbatimit të Planit Strategjik. Çdo katër muaj KZhEB do të mbledhet për të diskutuar ecurinë e zbatimit të Planit bazuar në raportet e përgatitura nga DZhEB. Ai, çdo vit në muajin gusht, do të diskutojë dhe miratojë

gjetjet, vlerësimet dhe do të shtojë sugjerimet për përmirësime të cilat do t'i paraqiten kryetarit të bashkisë e më pas këshillit bashkiak për diskutim e miratim.

Përbërja e komisionit mund të ndryshojë. Megjithatë, funksionet e tij do të mbeten të njëjta: mbështetje, monitorim dhe rishikim i zbatimit të Planit. Ndërkohë, kryetari i bashkisë në konsultim me KZhEB, mund të emërojë grupe pune për të ndihmuar këtë të fondet në zbatimin e pjesëve të veçanta.

KZhEB do të zhvillojë dhe miratojë një plan pune vjetor për rishikimin e Planit Strategjik. Fondet për veprimtarinë e saj do të miratohen nga këshilli bashkiak mbi bazën e kërkesës së kryetarit të bashkisë.

DZhEB është struktura direkt përgjegjëse për të ndjekur procesin e zbatimit të planit, dhe kryesisht:

- do të sigurojë logjistikën e nevojshme administrative për aktivitetin e Komisionit të Planifikimit,
- do të koordinojë aktivitetet e aktorëve të identifikuar në Plan dhe të atyre që do të përfshihen më vonë;
- do të sigurojë personel për grupet e punës që do të punojnë pranë Komisionit të Planifikimit;
- do të përgatisë dhe paraqesë para kryetarit të bashkisë dhe Komisionit të Planifikimit raportet mbi përmbushjen e procesit të zbatimit të planit;
- do të sigurojë të dhëna dhe informacione që kërkohen nga kryetari i bashkisë dhe Komisioni i Planifikimit.

Financimi i Planit Strategjik

Financimi i zbatimit të Planit Strategjik përbën një përpjekje të madhe për bashkinë po aq sa edhe hartimi i tij. Matrica e Zbatimit të Planit (Kapitulli IXc) identifikon kostot e përllogaritura dhe paraqet partnerët aktualë potencialë. Aktualisht kostoja e zbatimit të Planit llogaritet në 7,720,750,000 Lekë, baraz me 61,766,000 Euro.

Qeveria bashkiake do të financojë Planin Strategjik nga buxheti i saj dhe ky ka filluar tashmë në vitin 2005. Këshilli bashkiak do të vazhdojë të përfshijë zbatimin e programeve dhe projekteve të Planit në buxhetet vjetore dhe afatmesme të bashkisë.

Plani Strategjik do të bashkëfinancohet nga qeveria qendrore, komuniteti i biznesit dhe grupe të tjera të komunitetit, donatorë e organizata vendase dhe të huaja. Angazhimi me investime direkte të komunitetit të biznesit ofron një garanci financiare më shumë në zbatimin dhe suksesin e tij.



VI. Pamje e përgjithshme e komunitetit të Korçës

Vendndodhja

Qarku i Korçës ndodhet në juglindje të vendit dhe kufizohet më dy vende të tjera, Greqi dhe Maqedoni. Qarku përfshin katër bashki: të Korçës (qendra e prefekturës), Pogradecit, Bilishtit dhe Ersekës.

Klima

Klima e qarkut klasifikohet si kontinentale, me dimër të ftohtë dhe verë relativisht të nxehtë ndryshe nga qarket malore të ulëta mesdhetare dhe alpine të vendit.

Sipërfaqja:

3,697 km² (rreth 12 për qind të sipërfaqes së përgjithshme të vendit)

Popullsia:

360,000 banorë (10 për qind e popullsisë së Shqipërisë)

Numri i bizneseve të regjistruara:

4,000

Largësia nga qytetet e tjera në Ballkan:


Tirana, Shqipëri	180 km
Porti i Durrësit, Shqipëri	200 km
Porti i Selanikut, Greqi	250 km
Shkup, Maqedoni	280 km
Shkodra, Shqipëri	300 km
Prishtina, Kosova	430 km
Sofia, Bullgari	500 km
Bukuresht, Rumani	900 km

Arsimi

Qyteti ka një numër shkollash fillore dhe të mesme, si dhe një universitet, një institucion i rëndësishëm në qark dhe vend. Çdo vit, një numër i madh studentësh diplomohen në një sërë degësh përfshirë ato që kanë lidhje me biznesin dhe bujqësinë.

Qeveria bashkiake

Struktura organizative e qeverisë bashkiake paraqitet në faqen tjetër.





VII. Profili ekonomik i Korçës

Më poshtë jepet një përshkrim i shkurtër i sektorëve kryesorë të biznesit në qarkin e Korçës.

Bujqësia

Fakti që Korça zë vendin e dytë për nga sipërfaqja e tokës bujqësore në vend, e bën bujqësinë sektorin më të rëndësishëm në ekonominë e qarkut duke zënë rreth 32 për qind të të ardhurave të përgjithshme. Megjithatë, në Shqipëri ndarja e tokës midis fermave të vogla të drejtuara nga familjet ka çuar në ulje të prodhimit dhe krijimin e pengesave në specializim, në kultivim të produkteve të orientuara nga tregu, si dhe në prezantimin e teknologjisë bujqësore moderne. Kostoja e lartë e përdorimit të plehrave kimike bujqësore dhe pesticideve do të thotë se fermerët e qarkut ashtu si edhe në pjesën tjetër të vendit, janë të paafte të plotësojnë kërkesat e zonës për prodhime bujqësore që do të thotë se prodhimi i ulët dhe kostot e larta janë karakteristika tipike të këtij sektori në ekonominë shqiptare.

Kjo pamje bëhet më dëshpëruese kur merret në konsideratë edhe natyra jashtëzakonisht sezonale e tregut. Prodhimi vendas nuk mund t'i përmbushë kërkesat vendase dhe mund të plotësojë nevojat e tregut vetëm për disa muaj gjatë vitit, duke lënë shumë hapësira për importimin e prodhimeve të huaja. Sektori thjesht nuk konkurren me një treg më të gjerë.

Megjithatë, prodhimet shqiptare kanë disa avantazhe të caktuara kundrejt importeve. Në sajë të klimës së favorshme rendimentet janë shumë të larta edhe në sajë të përdorimit të kufizuar të plehrave kimike dhe pesticideve prodhimet bujqësore janë më së shumti organike megjithëse nuk etiketohen apo certifikohen si të tillë. Fatkeqësisht, për arsyet e dhëna më lart, këto produkte mjaft të kërkuara nuk arrijnë të depërtojnë nëpër tregje të tjera brenda dhe jashtë vendit. Fermat nuk janë të orientuara nga tregu dhe në përgjithësi, nuk janë të organizuara mirë në shoqata apo kooperativa.

Perspektiva afatmesme e këtij sektori

Unifikimi i fermave të vogla të këtij qarku në më të mëdha do të krijojë mundësinë për modernizimin dhe mekanizimin e sektorit bujqësor në Korçë. Kjo do të rrisë prodhimin dhe konkurrencën e prodhimeve shqiptare në qark. Marrëveshjet e tregtisë së lirë janë firmosur midis vendeve të Ballkanit dhe zbatimi i tyre do të inkurajojë fermerët shqiptarë të gjejnë rrugë të reja për të mbijetuar në kushtet e reja të tregut nëpërmjet zvogëlimit të kostove dhe identifikimit të prodhimeve që ofrohen me pakicë (manaferrat, manatoket, etj.) Programet mbështetëse të vëna në dispozicion nga institucionet e ndryshme ndërkombëtare dhe OJQ që operojnë në qark kanë siguruar të dhëna të rëndësishme duke dhënë këshilla mbi drejtimet që mund të marrë bujqësia shqiptare në të ardhmen.

Lëvizja demografike e fshatarëve në qytet dhe kalimi së fundmi i një ligji mbi shitjen dhe blerjen e tokës bujqësore janë faktorë të rëndësishëm që do të promovojnë krijimin e fermave të mëdha. Si një

nga burimet më të rëndësishme, bujqësia do të vazhdojë të mbajë një pozicion dominues në ekonominë e rrethit të Korçës.

Veshmbathja

Ky sektor përbën 31 për qind të ekonomisë së qarkut, një shifër pothuajse e njëjtë me sektorin bujqësor. Megjithatë, prodhimi i veshmbathjeve është sektori më i madh përse i përket numrit të ndërmarrjeve dhe punonjësve (midis 4,500 dhe 5,000 punonjës, kryesisht gra). Në më të shumtën e rasteve, ndërmarrjet janë sipërmarrje të përbashkëta (joint ventures) të realizuara nga biznesmenë shqiptarë dhe grekë. Lënda e parë për bizneset shqiptare importohet që të prodhohen artikujt përfundimtarë.

Perspektiva afatmesme e këtij sektori

Në sajë të rritjes së kostove të punës në Shqipëri, ky sektor nuk do të jetë tërheqës edhe për shumë kohë. Kompanitë e huaja që importojnë veshje në vendet e tyre janë të drejtuara nga tregjet që ofrojnë kosto pune më të ulët. Kështu, në Shqipëri porositë ulen çdo vit dhe vetëm ato kompani që kanë vendosur lidhje të drejtpërdrejta biznesi me klientë të mëdhenj të huaj të cilët arrijnë të shmangin agjentët e huaj, do të kenë mundësinë të mbijetojnë.

Një mundësi për këtë sektor mbetet prodhimi i artikujve për tregun vendas. Në Shqipëri, ky treg është relativisht i vogël dhe siguron mundësi vetëm për një numër të kufizuar kompanish ndërsa konkurrenca është e ashpër, gjithsesi është një treg që ekziston.

Agrobiznesi

Qarku i Korçës është streha e njërit prej grupeve më të mëdha të bizneseve të përpunimit ushqimor në vend: prodhimi i mishit, sallame, produkte bulmeti, pije alkoolike dhe joalkoolike, si edhe rritja e kërmijve, etj. Gjatë viteve të fundit, numri i bizneseve agro-përpunuese është rritur vazhdimisht dhe ky sektor është bërë një punëmarrës shumë i rëndësishëm në bashki. Bizneset e rinj përpunojnë fruta, perime, produkte bulmeti, verë, vaj, lule, etj, dhe pjesa më e madhe e këtyre kompanive janë NVM. Raporti i kompanive që operojnë në këtë sektor tani qëndron në 87 për qind të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve në qarku, ndërkohë që numri i bizneseve që punësojnë ndërmjet gjashtë dhe dhjetë personave po rritet vazhdimisht.

Perspektiva afatmesme për sektorin

Për shkak të burimeve të favorshme të qarku për përpunimin bujqësor ky sektor është tani një nga prioritetet në strategjinë afatmesme për zhvillimin e ekonomisë vendore. Me zhvillimin e sektorit të vet bujqësor, biznesi i Korçës ka një mundësi të garantuar për t'u bërë një lojtar si në skenat kombëtare ashtu dhe në ato ndër-rajonale ballkanike.



Ndërtimi

Në qarkun e Korçës ka 53 kompani ndërtimi që veprojnë aktualisht. Këto kompani ndërtojnë shtëpi private, qendra tregtare private dhe publike dhe ndërtime të tjera, si edhe prodhojnë materiale ndërtimi. Disa ndërmarrje kanë ngritur struktura kompanie të mirëorganizuar dhe po përpiqen të bashkëpunojnë dhe ndërtojnë marrëdhënie me kompanitë ndërkombëtare. Kjo industri ka zhvilluar një dinamizëm të lartë ekonomik dhe ka potencial të madh për rritjen e mëtejshme që do të përmirësojë ekonominë dhe do të rrisë punësimin në qytet.

Perspektiva afatmesme për sektorin

Në bazë të kërkesave në rritje të emigrantëve që kthehen, perspektiva e tregut për ndërtime rezidenciale do të mbetet e qëndrueshme në një afat të mesëm kohor. Përpjekjet për të reduktuar ekonominë informale do të reduktojnë numrin relativisht të lartë të ndërmarrjeve të ndërtimit dhe do të nxitin një zhvillim të shëndetshëm të sektorit.

Disa projekte kombëtare dhe ndërkombëtare që kanë influencë në këtë sektor, veçanërisht në lidhje me infrastrukturën, janë miratuar tashmë. Zbatim i disa projekteve ka qenë planifikuar për periudhën 2004 deri 2008 dhe këto përfshijnë një rrugë të re nga Korça deri në Qafë Thanë për të lehtësuar hyrjen në rrugët e qarkut të Korçës që janë pjesë e Korridorit të 8-të Ndërkombëtar. Kompanitë vendase të ndërtimit që janë të afta për të rinovuar teknologjinë e tyre, për të përmirësuar standardet e tyre të cilësisë dhe burimet personaore, dhe për të ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi me kompani të huaja me eksperiencë do të kenë një mundësi të mirë për të qenë të suksesshëm në tenderat për projektet e ardhshme.

Turizmi

Për shkak të potencialit turistik dhe infrastrukturës në zhvillim të qarkut, në vitet e fundit është përmirësuar cilësia dhe kapaciteti i hoteleve. Aktualisht, në bashki janë 10 hotele, që ofrojnë gati 400 shtretër. Tani për tani, të ardhurat nga turizmi kontribuojnë vetëm pak në ekonominë e përgjithshme të Korçës.

Perspektiva afatmesme për sektorin

Përmirësimi në infrastrukturë dhe rritja e investimeve në tërheqjet e turizmit do të gjenerojnë një rritje në të ardhurat nga ky sektor. Në vendet fqinje të Greqisë dhe Maqedonisë, industria e turizmit është e zhvilluar mirë dhe shumë konkurruese. Qarku i Korçës mund të përdorë burimet e tij historike, kulturore dhe natyrore që të përmirësojë të ardhurat afatmesme dhe afatgjata nga ky sektor.

Investimet e huaja

Në qarkun e Korçës ka 81 kompani të huaja që operojnë aktualisht. Kjo përbën pak më shumë se tre për qind të numrit të përgjithshëm të kompanive të huaja që operojnë në Shqipëri. Totali i investimeve të huaja në qark është 30.3 milion euro, gati 3.7 për qind e të gjithë shumës të investuar në vend.

Infrastruktura

Rrugët

Krahasuar me qarket e tjera të vendit, qarku i Korçës ka një rrjet rrugor me cilësi të mirë. Për më tepër, ka gjithashtu edhe investime që po bëhen në rrugë e sipër për të përmirësuar rrugët që lidhin Korçën me perëndimin e vendit, d.m.th. me kryeqytetin, Tiranën, si edhe me qytetin detar-portual të Durrësit, përgjatë Korridorit të 8-të.

Energjia elektrike

Furnizimi me energji elektrike për e qarkun e Korçës u përmirësua shumë kohët e fundit, në Shkurt 2004. Tani është e mundur të furnizohet me energji elektrike në voltazhin e standardit evropian, edhe pse numri i orëve të furnizimit është ende i kufizuar për shkak të procedurave të dobëta operacionale të kompanisë shtetërore, që është e paaftë për të shpërndarë energji elektrike 24 orë në ditë. Në vitin 2005, një tjetër projekt filloi të zbatohet dhe ky do të përshtijë rikonstruksionin e stacionit kryesor energjistik të qytetit.

Sistemet e ujërave të zeza dhe furnizimit me ujë të pijshëm

Qeveria gjermane ka bërë disa investime të rëndësishme në sistemet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe të ujërave të zeza të qarkut të Korçës. Projektet e mëposhtme të ndërtimit e kanë përmirësuar në veçanti ose do të përmirësojnë situatën në qytet:

- Rrjet i ri për furnizimin dhe shpërndarjen e ujit për Korçën, uje 24 ore;
- Sistem i ri kullues për ujin në Korçë;



Sektori financiar dhe sistemi bankar

Përveç bankave shqiptare, ka gjashtë banka të huaja që operojnë në qytetin e Korçës:

Banka Kombëtare e Greqisë (NBG, greke); Banka e Tiranës (greke); Banka Procredit (gjermane); Banka Kombëtare Tregtare (BKT, turke); Banka Raiffeisen (austriake); Banka Amerikane e Shqipërisë (amerikane).

Dy banka të tjera të huaja janë në fazën përgatitore për të hapur degët tyre në qytet dhe do të ofrojnë pothuajse të gjitha shërbimet normale bankare. Konsolidimi i stabilitetit politik si në Shqipëri dhe në rajonin e Ballkanit do të reduktojë nivelin e riskut me të cilin përballen bankat, duke pasur një ndikim pozitiv në normat e interesit. Ndërkohë, depozitimet e bëra nga banorët e Korçës shkojnë rreth 100 milion dollarë amerikanë dhe kjo është parë e cila mund të investohet nga bankat. Njohja me shërbimet e plota bankare si për individët dhe për bizneset, veçanërisht për NVM, është një punë dhe proces në vazhdimësi që ka nevojë për zhvillim të qëndrueshëm.

Programet e zhvillimit të qarkut

Siç u përmend më lart, ka shumë programe dhe projekte zhvillimi në rrugë e sipër në qarkun e Korçës, dhe këto janë përmbledhur më poshtë:

- Qeveria gjermane, me anë të KfW dhe GTZ, ka investuar dhe është në procesin e investimit të një sasive për rreth 50 milion euro në zhvillimin e qarkut të Korçës.
- SIDA, Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar, është duke investuar në ndërtimin dhe vënien në veprim të tregjeve rurale vendase, si edhe në çështjet migrimit, demokratizimit dhe zhvillimit të sektorit privat. Ajo po zbaton 15 projekte lidhur me zhvillimin rural.
- Instituti “East-West” është duke koordinuar një rrjet trekëndor të përbërë nga Korça, Bitola (Maqedoni) dhe Kozani (Greqi), të quajtur “Euro-Qarki”, i cili mbështetur në një strategji të përbashkët, do të tërheqë investime të rëndësishme në zonë.
- FZhSh, Fondi i Zhvillimit Shqiptar, financohet nga qeveritë e disa vendeve, veçanërisht nga qeveria Franceze. Fondet përdoren këtu për investime në infrastrukturën bujqësore, sistemet e ujitjes, etj
- Banka Islamike po investon në rehabilitimin e sistemeve të ujitjes dhe të kullimit, si edhe rezervuareve ujore të qarkut.
- PNUD po zbaton një projekt të quajtur “Pastrim dhe Gjelbërim” (Clean and Green) në komunat e qarkut.

- ShPZh (APD), Shoqata për Pjesëmarrje në Zhvillim, po ofron mundësi investimi në prodhim dhe infrastrukturë në zonat malore rurale të qarkut.
- SNV, Agjencia Hollandeze e Zhvillimit, është aktive në rehabilitimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit, rezervuareve dhe rrugëve të qarkut.
- MADA, Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore, po ndihmon fermerët në zonat e largëta të Shqipërisë, p.sh. me anë të ofrimit të kredive.
- Land O'Lakes, ndihmuar nga USAID, po ofron asistencë për zhvillimin e industrisë së përpunimit të qumështit vendas.
- Agrinas, agjencia për investime në pyje, ka zbatuar dhe po zbaton projekte në qarkun e Korçës.

Përveç kësaj, janë edhe një numër projektesh dhe aktiviteteve të realizuara nga organizata të tjera në qark, si për shembull NEHEMIA, Dorcas Aid.

Përgatitja e një plani për zhvillimin ekonomik të qarkut është bërë e domosdoshme me qëllim koordinimin e gjithë këtyre aktiviteteve. Meqënëse më parë nuk është krijuar një terren i përbashkët për zhvillimin e një plani të tillë është e rëndësishme që të përgatitet Plani Strategjik i cili sjell përpara bashkisë dhe bizneseve vendase mjetet për të lehtësuar koordinimin e aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë të përfshirë në zhvillim



VIII. Zhvillimi i një vizioni për ZhEV

Ashtu siç u përmend më lart, zhvillimi i biznesit agrar është shumë i rëndësishëm për Korçën dhe si i tillë bëhet prioritet për zhvillimin ekonomik të qarkut. Bizneset agrare moderne (tipike në përpunimin ushqimor) në Korçë do të mbështeten nga bujqësia moderne si dhe do të jenë konkurruese e të mirë-orientuara në treg.

Industrializimi i përpunimit ushqimor ka arritur relativisht vonë në Shqipëri. Deri në mesin e viteve '50 biznesi agrar i vendit përbëhej vetëm nga një numër mullinjsh, furra buke dhe baxhosh. Një industri vendase më moderne e biznesit agrar u zhvillua gjatë viteve '70, ndërsa në fillim të viteve '90, industria u zgjerua duke përfshijë rreth 200 ndërmarrje të mëdha, 600 fabrika të vogla të përpunimit ushqimor dhe 60 furra të vogla buke. Gjithsesi, sasia dhe larmia e produkteve, asnjëherë nuk përkon me kërkesat e fermerëve për një bujqësi më të zhvilluar dhe të popullsisë për një gamë më të gjerë prodhimi.

Gjatë transformimeve që ndodhën në Shqipëri pas 1991, industria e përpunimit agrar u ndikua, duke kaluar nëpër transformime thelbësore dhe duke u bërë industri tërësisht private. Biznesi agrar është një nga komponentët më të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të qarkut dhe statistikat e fundit tregojnë një ndryshim cilësor dhe sasior në furnizimin me ushqim si rezultat i arritjeve të industrisë

Arritjet që janë bërë demonstrojnë se një zhvillim i shpejtë i biznesit agrar është një komponent thelbësor në zhvillimin e tanishëm dhe të ardhshëm ekonomik të qarkut të Korçës. Megjithatë, mbeten një numër problemesh dhe këto kanë të bëjnë me kënaqjen e kërkesës së konsumatorit për produkte ushqimore, përmirësimin e ekuilibrit import-eksport, inkurajimin e biznesit që të jetë i orientuar nga tregu, shtimin e vlerës me përpunimin e produkteve bujqësore, përmirësimin e konkurrencës së produkteve vendase në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare, shtimin e punësimit, etj

Me qëllim zhvillimin e këtij sektori, nuk kërkohen burime natyrore të mëdha lëndësh të para për bizneset, por edhe një fuqi punëtore e kualifikuar me kosto pune relativisht të ulët. Shqipëria ende ka një avantazh në këto drejtime kur krahasohet me vendet tjera evropiane. Një tjetër avantazh për këtë sektor është preferenca konsumatore dhe imazhi pozitiv për produktet vendase. Kjo preferencë bazohet në një numër karakteristikash shumë të rëndësishme, si freskia, shija dhe të qenurit organike. Analizat e mëtejshme mund të identifikojnë një tjetër numër, ndonëse aktualisht i dobët, mundësish për zhvillim

Ndryshimet që kërkohen në aktivitetet e marketingut dhe prodhimit në Shqipëri për zhvillimin e shpejtë të ekonomive vendase nuk mund të ndodhin sa hap e mbyll sytë. Do të duhet ende pak kohë derisa marrëveshjet e tregëtisë së lirë të zbatohen tërësisht, tregu shqiptar do të ofrojë mundësi të mira për bizneset shqiptare. Megjithatë, me zbatimin e këtyre marrëveshjeve tregjet shqiptare do të ekspozohen ndaj produkteve të huaja me cilësi të lartë. Por atëherë, prodhuesit shqiptarë, do të kenë mundësi në tregjet e reja të huaja që janë pjesë e marrëveshjeve.

Krijimi i një tregu të liberalizuar në Ballkan paraqet jo vetëm një vështirësi, por edhe një mundësi për biznesin vendas. Vendet fqinje kanë më shumë eksperiencë në biznesin privat dhe prodhojnë një gamë të gjerë produktesh. Cilësia e këtyre produkteve është shpesh, por jo gjithmonë, më e lartë se ajo e produkteve shqiptare dhe strategjitë e marketingut që ata përdorin janë shpesh të sofistikuar (p.sh. për verën). Për më tepër, në kundërshtim me industrinë e përpunimit agrar në Shqipëri, bizneset e huaja duke qenë të hapura ndaj konkurrencës për një periudhë të gjatë, janë shumë të përqendruara në përmirësimin e vazhdueshëm të strategjive të produkteve dhe marketingut të tyre

Përveç kësaj, disa industri shqiptare varen shumë nga lëndët e para të importuara nga vendet fqinje (si për prodhimin e verës dhe konjakut). Kostot e transportit që duhen për importimin e lëndëve të para, detyrimet doganore dhe prodhimtaria e ulët vendase i detyrojnë më pas prodhimet shqiptare të shiten me një çmim jashtëzakonisht të larta dhe ato përballen me konkurrencë të fortë nga produkte të ngjashme të importuara nga të njëjtat vende fqinje

Si përmbledhje, produktet nga qarku i Korçës kanë disa disavantazhe krahasuar me konkurrentët e huaj dhe këto, për arsytet e mëposhtme:

- Ekonomitë fqinje kanë përjetuar një shkallë më të madhe hapjeje në ekonomitë e tyre dhe presion më të madh nga konkurrenca, duke e përmirësuar vazhdimisht aftësinë konkurruese.
- Kompanitë e huaja kanë më shumë ekspertizë në marketingun e produkteve të tyre, duke prodhuar një prani më të lartë komerciale, ndërsa produktet janë pakëtuar dhe etiketuar shumë më mirë se produktet përkatëse shqiptare.
- Bizneset shqiptare shpesh përdorin teknologji të vjetruar.
- Ndërmarrjet e huaja shpesh kanë kapacitet prodhimi të lartë, duke i dhënë mundësi prodhuesit të ketë avantazhin e ekonomisë së shkallës. Një avantazh i tillë rezulton të jetë me kosto të ulët prodhimi dhe për rrjedhojë çmime të ulëta.
- Kompanitë e huaja shpesh kanë mundësi për të përdorur materiale vendase me kosto të ulët. Industria shqiptare e përpunimit agrar shpesh përdor lëndët e para të importuara nga të njëjtat këto vende dhe kështu çmimet e tyre janë zakonisht të lartë.

Ekzistenca e një industrie konkurruese për përpunimin agrar kërkon krijimin e avantazheve dhe këto mund të arrihen me anë të përkrahjes së grupeve të produkteve, dhe me anë të inkurajimit të investimeve të huaja.



Përkrahja e grupeve brenda sektorit të përpunimit bujqësor

Përkrahja e grupeve ka dhënë rezultate pozitive në vendet ku kjo metodologji është zbatuar. Krijimi i marrëdhënieve ndërmjet bizneseve të përfshira në zinxhirin e vlerave të shtuara për produktet ka patur një ndikim pozitiv në lidhje me avantazhet konkurruese të një qarku apo vendi në veçanti. Prania e furnizuesve vendas, teknologjia moderne, institucionet kërkimore dhe infrastruktura efektive institucionale dhe ligjore lehtëson një reduktim në kostot operacionale për bizneset dhe për rrjedhojë, rrit nivelin e konkurrencës.

Në Shqipëri, grupe të tilla mund të krijohen veçanërisht në dy zona të rëndësishme ekonomike vendase: përpunimi i mishit dhe përpunimi i frutave e perimeve.

Industria e përpunimit të mishit

Ndërmjet ofruesve vendas të mishit, bimë mjekësore dhe erëzave, përpunuesve të mishit, kompanive të paketimit dhe një instituti kërkimor mund të krijohet një zinxhir i vlerës së shtuar. Nëse janë bërë investime të mëdha për të ndërtuar ferma të mëdha ky zinxhir mund të përmirësohet dhe koncepti i grupit mund të zbatohet nëpërmjet një procesi të mirëorganizuar, i mbështetur nga institucionet përkatëse të biznesit.

Industria e përpunimit të frutave dhe perimeve

Prodhuesit vendas të frutave dhe perimeve janë ende të dobët në treg, dhe pjesa më e madhe e lëndë e parë për sektorin e përpunimit të frutave dhe perimeve importohet. Megjithatë, ka disa prodhime vendase (si fasule e madhe “pllaqi”) që konkurrojnë mirë me produktet e importuara dhe madje eksportohen. Orientimi i fermerëve drejt produkteve të tilla konkurruese, duke përfshirë edhe luleshtrydhet dhe fruta të pyllit, mund të krijojë mundësinë që bizneset përpunuese të zhvillohen. Ekzistojnë pak kompani përpunuese të frutave në qark dhe disa nga produktet e tyre kanë një imazh të mirë në treg. Ndërkohë, janë disa organizata ndërkombëtare aktive në vend duke mbështetur projektet në këtë sektor. Në qark është aktiv edhe një institut kërkimor. Kështu, duke prezantuar një grup në këtë industri dhe duke fuqizuar disa pjesë të saj, pozicioni aktual i dobët në treg i produkteve vendase do të forcohet shumë.

Si përmbledhje, me qëllim rritjen e konkurrencës të produkteve vendase, është e nevojshme të përvetësohen strategjitë e mëposhtme

- Përmirësimi i efikasitetit operacionale të bizneseve vendase dhe rritja e kapaciteteve të tyre do të vjelin përfitime në ekonomitë e shkallës. Kjo do të reduktojë kostot për njësi dhe do t'u japë mundësi bizneseve të vendosin çmime të ulëta. Kjo do të rrisë kuotën për produktet agrare

vendase në tregun vendas dhe me përfshirjen e investuesve të huaj do të rrisë mundësinë e depërtimit e tregjeve të huaja.

- Caktimi i strategjive të zhvillimit të produktit sipas tipit të produktit do të përmirësojë pozicionin e tij të tregut. Kjo kërkon të bëhen përpjekje për të rritur numrin e produkteve që janë të disponueshme. Situata aktuale në sektorin vendas të përpunimit agrar demonstroi se kjo industri është në hapat e parë të zhvillimit, reflektuar në mungesën e llojshmërisë në secilën kategori produkti, një vakum që mbushet nga importi. Rritja e gamës së llojshmërisë do të reduktojë hapësirën e disponueshme për produktet e importuara.
- Stimulimi i një imazhi të mirë për produktet vendase për konsumatorin shqiptar me anë të përmirësimit të proceseve të prodhimit dhe marketingut mund të përmirësojë pozicionin e tij të tregut. Kjo kërkon përmirësimin e standardeve higjienike dhe prezantimin e paketimit modern dhe tërheqës, si edhe etiketimin informues, me ofrimin e markave origjinale të qarkut dhe certifikatave të cilësisë.
- Përdorimi i teknikave moderne të reklamimit dhe materiale të tjera promovionale do të përmirësonin pozicionin e tregut të produkteve shqiptare.

Kështu, strategjitë më konkurruese të shitjes, rinovimi i metodologjive dhe teknikave të marketingut, eficienta e përmirësuar operacionale dhe prezantimi i produkteve dhe shërbimeve të reja që do të vlerësoheshin nga konsumatori, do të forconin pozicionin e prodhimit vendas bujqësor si në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe do të ndihmojnë në zhvillimin ekonomik vendas ndërkohë do të reduktojë deficitin tregtar të vendit

Tërheqja e investimeve të huaja në sektorin e përpunimit ushqimor

Investimet e huaja mund të jenë të shumanshme dhe mund të marrin forma të ndryshme. Mund të jetë si ofrim ekspertize, kapitali, tregu apo teknologji dhe duhet detyrimisht të prodhojë standarde të larta të cilësisë së produkteve. Institucionet dhe specialistët privat duhet të përfshihen në këtë proces si një mjet për të përkrahur aftësitë e bizneseve vendase dhe avantazhet krahasuese të qarkut. Me qëllim krijimin e një situatë të favorshme që stimulon rrjedhën e investimeve të huaja në qarku, duhet të përdoret sinergjia ndërmjet të gjithë aktorëve.

Ndërkohë, marketingu sistematik i qarkut duhet të organizohet dhe zbatohet me qëllim stimulimin e imazhit të qarkut dhe të tërheqë investues. Në këtë kohë, komuniteti i biznesit duhet të informohet vazhdimisht në lidhje me vizionin e zhvillimit të biznesit dhe rreth vështirësive të reja që dalin në treg. Bizneset duhet të reflektojnë në nivelin e tyre të zhvillimit ekonomik dhe nivelin që ata do të donin të



arrinin dhe dokumentet e studimit lidhur me zhvillimin e qarkut ndërsa i përqendrojnë përpjekjet e tyre në prodhimin e produkteve më konkurruese.

Duke ndjekur këtë shteg, investimet e huaja mund të tërhiqen në qarkun e Korçës. Vëmendja duhet treguar në pika të veçanta. Duhet të ketë.:

- Përmirësim të vazhdueshëm të burimeve njerëzore, kapitale dhe materiale;
- Rinovim të vazhdueshëm të teknologjisë dhe stimulimin e novacioneve;
- Njohje dhe zbatim të standardeve të cilësisë;
- Modifikim të strukturave organizative;
- Krijim dhe inkurajim të rrjeteve intra- dhe inter-sektoriale dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Integrimi në komunitetin e BE është një aspiratë për popullin shqiptar dhe është një proces që ka filluar tashmë në nivelet zyrtare. Megjithatë, hapat e procesit varen shumë nga qëndrimi i personave të vendit, ndërkohë që koha është një faktor kritik për komunitetin e biznesit. Marrja pjesë në ekonominë e tregut të lirë evropian do të sjellë një peshë të madhe për t'u mbajtur nga bizneset për të rinovuar strukturat dhe teknologjitë e tyre, në të kundërt ata nuk do të jenë në gjendje të konkurrojnë dhe do të përballen me falimentimin. Kështu, përmirësimi i konkurrencës së ekonomisë si e tërë dhe ajo e biznesit në veçanti duhet të jetë një pikë e rëndësishme për politikëbërësit e vendit, dhe për të gjithë aktorët e përfshirë në proces.

Padyshim, ka aspekte të tjera të zhvillimit ekonomik vendor që nevojiten të kryhen në lidhje me ato që u thanë më lart. Një parakusht virtual për ZhEV është një zhvillim paralel i infrastrukturës fizike, e cila është kaq e rëndësishme për qarkun, ashtu siç është në të gjitha pjesët e Shqipërisë. Duke konsideruar që ky parakusht është përmbushur, të tjera fusha do të përparojnë në zhvillimin e tyre, si turizmi, investimet e bëra në infrastrukturën për turizmin, nxitja e shërbimeve të reja për turistët, marketingun rajonal dhe infrastrukturën e përmirësuar të trafikut në zonat malore. Ndërkohë, është një tjetër parakusht për ZhEV që disponojë një forcë punë të trajnuar dhe vëmendja i duhet kushtuar në zhvillimin e burimeve njerëzore. Në këtë këndvështrim, universiteti i Korçës do të luajë një rol kryesor, me përmirësimin e programit të tij akademik dhe duke krijuar mundësi punësimi për studentët e tij.

Konkluzionet

Të gjithë aktorët e përfshirë në zhvillimin e biznesit vendas, d.m.th. komuniteti i biznesit, institucionet e lidhura me bizneset, organizatat ndërkombëtare që mbështetin zhvillimin e biznesit dhe autoritetet vendase, duhet të pranojnë një vizion të përbashkët në lidhje me zhvillimin e biznesit dhe shfrytëzimin e sinergjisë për të punuar së bashku me qëllim që vizioni i tyre të zbatohet me sukses.

Mbështetur në karakteristikat e gjendjes aktuale të zhvillimit ekonomik të qarkut të Korçës dhe prania e NVM që po ngrihen, vëmendja duhet të përqendrohet në inkurajimin e zhvillimit të tyre si më poshtë:

- Zgjerimi i shërbimeve të gatshme për bizneset;
- Ofrimi i mbështetjes për krijimin e SMEs dhe zhvillimin e tyre të qëndrueshëm;
- Ofrimi i asistencës së vazhdueshme për SMEs;
- Identifikimi i metodave për t'u përdorur për zhvillimin e grupeve;
- Zbatimi i projekteve kërkimore dhe aktiviteteve të lidhura me SMEs;
- Transferimi i teknologjive;
- Zhvillimi i një parku industrial;
- Krijimi i një rrjeti për furnizimin me informacion të vazhdueshëm mbi qëndrueshmërinë e bizneseve.



IX. Dokumentet përbërëse të Planit Strategjik

Plani Strategjik përfshin dokumentet e mëposhtme:

- a. SWOT, analiza e konsoliduar
- b. Matricat e qëllimeve, objektivave, programeve dhe projekteve të Planit
- c. Matricat e zbatimit të Planit
- d. Matricat e prioriteteve të projekteve
- e. Fishat e projektit

a. **SWOT, analiza e konsoliduar**

	Të brendshme	Të jashtme
Pozitive	<u>Pikat e forta</u>	<u>Mundësitë</u>
	1. Pozita gjeografike: fqinje me dy vende të tjera	1. Zhvillimi i turizmit
	2. Infrastrukturë rajonale e arsyeshme	2. Emigrantët e kthyer: potencial i burimeve njerëzore
	3. Burime njerëzore të mjaftueshme	3. Zhvillimi i bizneseve agro-përpunuese
	4. Qytet universitar	4. Prania e donatorëve potencialë
	5. Qeveri vendore mirëfunktionale	5. Bashkëpunimi ndërkufitar
	6. Sistemi bankar	6. Të ardhura të larta për frymë
	7. Burime të mjaftueshme natyrale	7. Bashkëpunimi midis bashkisë, bizneseve dhe pjesës tjetër të komunitetit
	8. Shumëllojshmëria e bizneseve	8. Zhvillimi i turizmit familjar
	9. Funksionimi i sistemeve të kanaleve ujërave të zeza dhe kanaleve kulluese	9. Përkrahja e traditave dhe kulturës
	10. Ekzistenca e vlerave të traditës dhe kulturës	
	11. Emigrantët e kthyer me aftësi të reja	
	12. Besimi i donatorëve në komunitet	



Negative	<u>Pikat e dobëta</u>	<u>Rreziqet</u>
	1. Profesionistët po largohen nga qyteti	1. Konkurrencë e pandershme
	2. Emigracioni	2. Mungesa e bashkëpunimit midis forcave politike
	3. Toka bujqësore po ndahet në parcela të vogla	3. Ndikimi i politikës në biznes
	4. Norma të larta interesi	4. Hapja e tregjeve rajonale
	5. Mungesa e iniciativave për fillimin e bizneseve të reja	5. Ndryshime të shpeshta në legjislacion
	6. Shkalla e lartë e informalitetit në biznese	6. Përqindje e ulët rritjes së normës së zhvillimit të popullsisë
	7. Mungesa e marketingut profesional	7. Nuk ekziston një informacion i saktë
	8. Infrastruktura e dëmtuar e qytetit	8. Numër i pakët investuesish të huaj nga vendet fqinje
	9. Komuniteti është indiferent ndaj përfshirjes së tij në procesin e vendimmarrjes	
	10. Mungesa e ndërmarrjeve të mëdha	
	11. Ekzistenca e monopoleve	
	12. Mungesa e politika stimuluese për bizneset	
	13. Mungesa e një plani urban	
14. Mundësi e pakët për përdorimin e informacionit		

b. Matrica e qëllimeve, objektivave, programeve dhe projekteve të Planit

VIZIONI:				
Korça do të jetë një qendër e rëndësishme urbane dhe universitare që përkrah zhvillimin ekonomik vendor dhe rajonal duke i dhënë hov zhvillimit të infrastrukturës nëpërmjet bashkëpunimit institucional me komunitetin e biznesit dhe qytetarët, duke ndërtuar mbi potencialet e tij, si edhe duke mbështetur traditat e saj kulturore dhe historike				
Qëllimi	Objektivat	Programet	Projektet	
Qëllimi 1: Sigurimi i qëndrueshmërisë dhe rritjes së biznesit vendas duke mbështetur dhe koordinuar tërheqjen e bizneseve të reja		Q1:O1:PG1: Sigurimi i kushteve, stimujve dhe hapësirave për zhvillimin e NVM	Q1:O1:PG1:p1: Ndërtimi i një qendre shumëfunktionale për të organizuar panairë vendase dhe rajonale si dhe aktiviteteve të tjera Q1:O1:PG1:p2: Krijimi i një Partneriteti Publik Privat (PPP), si një qendër kërkimore koordinuese në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor	
		Q1:O1: Rritja e numrit dhe kapaciteteve të bizneseve në bashkinë e Korçës dhe rritja me 20 % e numrit të vendeve të punës në fund të 2010	Q1:O1:PG2:p1: Krijimi i një “Qendre me një ndalesë” (One-Stop-Shop) në bashkinë e Korçës për të lehtësuar procedurat për bizneset Q1:O1:PG2:p2: Hartimi dhe miratimi i udhëzimeve instruksioneve për vendosjen e njoftimeve dhe shenjave të bizneseve dhe menaxhimi i fasadave në zonat tregtare	
		Q1:O1:PG3: Zhvillimi i partneriteteve midis bashkisë, bizneseve dhe komunitetit në tërësi	Q1:O1:PG3:p1: Realizimi i investimeve të përbashkëta nga bashkia, bizneset dhe komuniteti me qëllim përmirësimin e infrastrukturës në zonat ndërmjet ndërtesave të banimit dhe qendrave të argëtimit Q1:O1:PG3:p2: Krijimi i një baze të dhënash me emrat e specialistëve në fusha të ndryshme me qëllim lehtësimin e identifikimit të tyre nga bizneset dhe punëmarrësit e mundshëm	
		Q1:O1:PG4: Krijimi i mundësive për trajnimin e bizneseve	Q1:O1:PG4:p1: Krijimi i një qendre trajnimit për zhvillimin profesional	
				Nr. 1 2 3 4 5 6 7



Qëllimi	Objektivat	Programet	Projektet	Nr.	
<p>Qëllimi 2: Krijimi i zhvillimit urban të qëndrueshëm të bashkisë në harmoni me vlerat urbane tradicionale dhe bashkëkohore</p>		<p>Q2:O1:PG1: Hartimi i një kuadri rregullues për zhvillimin territorial të bashkisë</p>	<p>Q2:O1:PG1:p1: Hartimi i një plani të kuptueshëm urban të qytetit duke respektuar traditat urbane dhe duke i bashkuar konceptet e reja ekonomike</p>	8	
	<p>Q2:O1: Urbanizimi i integruar i territorit të qytetit në përputhje me kriteret ligjore dhe bashkëkohore</p>	<p>Q2:O1:PG2: Ndërtimi dhe rehabilitimi urban, koordinuar nga bashkia dhe institucionet vendore</p>	<p>Q2:O1:PG2:p1: Zhvillimi i zonës rreth “Varrezave Franceze” në një zonë të banueshme</p>	9	
			<p>Q2:O1:PG2:p2: Hapja ndaj zhvillimit urban e zonës nga hyrja e qytetit përgjatë rrugës së Ersekës në klinikën kryesore shëndetësore</p>	10	
			<p>Q2:O1:PG2:p3: Zbatimi i planit të pjeshëm urban për zonën midis unazës së qytetit pranë ish-zonës së depozitimit dhe rrugës kryesore automobilistike</p>	11	
			<p>Q2:O1:PG2:p4: Ndërtimi i rrjetit dhe sistemit të ri të ujërave të zeza</p>	12	
			<p>Q2:O1:PG2:p5: Rehabilitimi i sistemit shpërndarës elektrik duke përfshirë edhe atë të zonës industriale (Nënstacioni i Zemblakut)</p>	13	
			<p>Q2:O1:PG3:p1: Kompjuterizimi i menaxhimit të të dhënave dhe procedurave të punës së qeverisë vendore</p>	14	
			<p>Q2:O1:PG3:p2: Kompjuterizimi i zyrës së gjendjes civile</p>	15	
			<p>Q2:O1:PG3:p3: Hartimi i një baze të dhënash dhe i programit përkatës kompjuterik me të gjithë adresat në Korçë</p>	16	
			<p>Q2:O1:PG4: Shkëmbimi i informacionit midis bashkisë dhe institucioneve vendore</p>	<p>Q2:O1:PG4:p1: Krijimi i hartave dixhitale për rrjetet inxhinierike të institucioneve vendore</p>	17
			<p>Q2:O2:PG1: Përmirësimi i rrugëve të qytetit dhe shërbimeve publike në bashkëpunim me komunitetin</p>	<p>Q2:O2:PG1:p1: Rekonstrukcioni i rrugëve kryesore të qytetit</p>	18
			<p>Q2:O2:PG1:p2: Rehabilitimi i rrugëve me kalldrëm dhe trotuareve në zonën e vjetër të qytetit</p>	19	
			<p>Q2:O2:PG1:p3: Vendosja e sistemit të ndriçimit në të gjitha hapësirat publike të qytetit</p>	20	

Qëllimi	Objektivat	Programet	Projektet	Nr.
Qëllimi 3: Transformimi i Korçës në një qendër arsimore për të gjithë rajonin e Shqipërisë juglindore duke përmirësuar arsimin në të gjitha nivelet dhe duke siguruar një force pune të kualifikuar	Q3:O1: Funksionimi i universitetit të Korçës sipas parimeve dhe kritereve të Deklaratës së Bolonjës	Q3:O1:PG1: Rritja e cilësisë së standardeve dhe të mjediseve të mësimdhënies	Q3:O1:PG1:p1: Ndërtimi i mjediseve të reja me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe strehimit të studentëve të Universitetit të Korçës	21
	Q3:O2: Përmirësimi i cilësisë të mjediseve dhe mjeteve të shkollës	Q3:O2:PG1: Krijimi i kushteve për cilësinë e arsimit para-universitar	Q3:O2:PG1:p1: Rehabilitimi fizik i shkollave të mesme të qytetit	Q3:O2:PG1:p2: Ngritja e një kompleksi modern për sportet në zonën midis shkollave “Demokracia” dhe “Naum Veqilharxhi”
Qëllimi 4: Ruajtja dhe zhvillimi i traditave historike, artistike dhe kulturore të qytetit në lidhje me zhvillimin e turizmit	Q4:O1: Promovimi intensiv dhe profesional i potencialit turistik të zonës së Korçës	Q4:O1:PG1: Ndërtimi, në bashkëpunim me bizneset, i sistemeve të promovimit të potencialeve turistike të Korçës dhe zonave përreth	Q4:O1:PG1:p1: Ngritja e një qendre të informacionit turistik	24
	Q4:O2: Rritja e numrit të ambienteve që promovojnë cilësisht historinë dhe kulturën e Korçës	Q4:O2:PG1: Promovimi cilësor i historisë dhe kulturës së qytetit nëpërmjet institucioneve publike	Q4:O1:PG1:p2: Publikimi i kalendarëve vjetorë të aktiviteteve sportive dhe kulturore	25
			Q4:O2:PG1:p1: Rehabilitimi i mjediseve të teatrit “Andon Zako Çajupi”	26
			Q4:O2:PG1:p2: Rindërtimi i Pazarit të Vjetër	27
			Q4:O2:PG1:p3: Ndërtimi në qytet i një muzeu historik	28



BASHKIA e KORÇËS

Qëllimi	Objektivat	Programet	Projektet	Nr.	
Qëllimi 5: Krijimi i një mjedisi të shëndetshëm që garanton një cilësi të përmirësuar të jetesës për qytetarët e Korçës	Q5:01: Reduktimi i ndotjes nga mbeturinat urbane në nivelet minimale	Q5:01:PG1: Trajtimi i mbetjeve urbane sipas standardeve ligjore	Q5:01:PG1:p1: Rehabilitimi i vendit aktual për hedhjen e mbeturinave urbane	29	
			Q5:01:PG1:p2: Ndërtimi i një vendi të ri për depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të qytetit	30	
		Q5:01:PG2: Zvogëlimi i ndotjes së ajrit në qytet		Q5:01:PG2:p1: Ngritja e një sistemi për monitorimin e cilësisë së ajrit të qytetit	31
		Q5:02: Shtimi i sipërfaqeve të gjelbërta në qytet dhe përreth tij	Q5:02:PG1: Përmirësimi në nivelin e gjelbërimit të rrugëve dhe shesheve të qytetit	Q5:02:PG1:p1: Rehabilitimi i zonave të gjelbërta përgjatë rrugëve dhe shesheve kryesore të qytetit	32

c. Matrica e zbatimit të Planit Strategjik

A, Artistët; B, Bizneset; Ba, Bashkia; D, Donatorë; DSh, Drejtorja e Shëndetit Publik; H, Historianët; I, Institucionet; K, Komuniteti; P, Pedagogët; Q, Qytetarët; QQ, Qeveria qendrore; KESh, KESh rajonal; S, Specialistët; St, Studentët; T, Turizmi.

Nr. i projektit	Titulli i projektit	Vera (Lekë)	Vera (€)*	Burimet e financimit										Zbatimi			Grupet e synuara
				Bashkia		Komunitetet		Qeveria qendrore		Donorë të tjerë		Partnerët	Fillim	Fonde	Statusi		
				%	Lekë	%	Lekë	%	Lekë	%	Lekë						
1	Q1:O1:PG1:pl: Ndërtimi i një qendre shumëfunktionale për të organizuar panairë vendase dhe rajonale si dhe aktivitetet e tjera	15,000,000	120,000	33	5,000,000	33	5,000,000	0	0	33	5,000,000	B	Qer. 2006	2006	KF	B	
2	Q1:O1:PG1:p2: Krijimi i një Partneriteti Publik Privat (PPP), si një qendër kërkimore koordinuese në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor	1,875,000	15,000	33	625,000	33	625,000	0	0	33	625,000	Ba, B	Tet. 2005	2005	KF	Ba, Q	
3	Q1:O1:PG2:pl: Krijimi i një "Qendre me një ndalesë" (One-Stop-Shop) në bashkinë e Korçës për të lehtësuar procedurat për bizneset	1,875,000	15,000	33	625,000	0	0	0	0	67	1,250,000	B	Sht. 2005	2005	KF	B, Ba	
4	Q1:O1:PG2:p2: Hartimi dhe miratimi i udhëzimeve instruksioneve për vendosjen e njoftimeve dhe shenjave të bizneseve dhe menaxhimi i fasadave në zonat tregtare	125,000	1,000	100	125,000	0	0	0	0	0	0	Ba, B	Mars 2005	2005	M	B, Q, Ba	



BASHKIA e KORÇËS

Nr. i projektit	Titulli i projektit	Vlera (Lekë)	Vlera (*)	Burimet e financimit								Zbatimi			Grupet e synuara	Statusi
				Bashkia		Komunitetet		Qeveria qendrore		Donorë të tjerë		Partnerët	Fillim	Fonde		
		%	Lekë	%	Lekë	%	Lekë	%	Lekë	%	Lekë					
5	Q1:O1:PG3:pl: Realizimi i investimeve të përbashkëta nga bashkia, bizneset dhe komuniteti me qëllim përmirësimin e infrastrukturës në zonat ndërmjet ndërtesave të banimit dhe qendrave të argëtimit	25	6,250,000	25	6,250,000	25	6,250,000	25	6,250,000	25	6,250,000	Ba, B	Qer 2006	2007	KF	Ba, B, K
6	Q1:O1:PG3:p2: Krijimi i një baze të dhënash me emrat e specialistëve në fusha të ndryshme me qëllim lehtësimin e identifikimit të tyre nga bizneset dhe punëmarrësit e mundshëm	25	625,000	10	250,000	65	1,625,000	0	0	0	0	S, D	Jan. 2006	2006	KF	S, Q
7	Q1:O1:PG4:pl: Krijimi i një qendre trajnimi për zhvillimin profesional	0	0	0	0	0	0	100	8,750,000	0	0	QQ, B, D	Qer 2005	2005	M	S, Q
8	Q2:O1:PG1:pl: Hartimi i një plani të kuptueshëm urban të qytetit duke respektuar traditat urbane dhe duke i bashkuar konceptet e reja ekonomike	38	3,750,000	0	0	0	0	63	6,250,000	0	0	Ba, B	Qer 2005	2006	KF	B, Q
9	Q2:O1:PG2:pl: Zhvillimi i zonës rreth “Varrave Franceze” në një zonë të banueshme	17	6,250,000	17	6,250,000	33	12,500,000	33	12,500,000	0	0	Ba, B, K, D	Qer 2006	2007	KF	Q, B

Nr. i projektit	Titulli i projektit	Vlera (Lekë)	Vlera (€)*	Burimet e financimit								Zbatimi			Grupet e synuara	
				Bashkia		Komunitetet		Qeveria qendrore		Donorë të tjerë		Partnerët	Fillim	Fonde		Statusit
		%	Lekë	%	Lekë	%	Lekë	%	Lekë	%	Lekë					
10	Q2:O1:PG2:p2: Hapja ndaj zhvillimit urban e zonës nga hyrja e qytetit përgjatë rrugës së Ersekës në klimikën kryesore shëndetësore	20	1,000,000	25,000,000	10	12,500,000	50	62,500,000	20	25,000,000	Ba, B, K, D	Oer 2006	2010	KF	Q, Ba	
11	Q2:O1:PG2:p3: Zbatimi i planit të pjeshëm urban për zonën midis unazës së qytetit pranë ish-zonës së depozitimit dhe rrugës kryesore automobilistike	0	400,000	0	0	0	0	0	0	0	Ba, B, D	Jan. 2007	2010	KF	Q, B	
12	Q2:O1:PG2:p4: Ndërtimi i rrjetit dhe sistemit të ri të ujërave të zeza	0	25,000,000	0	0	0	20	625,000,000	80	2,500,000,000	I, D	Maj 2005	2006	M	I, Q	
13	Q2:O1:PG2:p5: Rehabilitimi i sistemit shpërndarës elektrik duke përfshirë edhe atë të zonës industriale (Nënstacioni i Zemblakut)	0	5,000,000	0	0	0	40	250,000,000	60	375,000,000	KESH, Ba, D	Tet. 2005	2006	M	Q	
14	Q2:O1:PG3:p1: Komputerizimi i menaxhimit të të dhënave dhe procedurave të punës së qeverisë vendore	33	150,000	6,250,000	0	0	0	0	67	12,500,000	Ba, D	Oer 2005	2005	M, KF	Q, Ba	
15	Q2:O1:PG3:p2: Komputerizimi i zyrës së gjendjes civile	63	8,000	625,000	0	0	0	0	38	375,000	Ba, D	Mars 2005	2006	M, KF	Q	



BASHKIA e KORÇËS

Nr. i projektit	Titulli i projektit	Vlera (Lekë)	Vlera (€)	Burimet e financimit						Zbatimi				Statusi*	Grupet e synuara	
				Bashkia		Komunitetet		Qeveria qendrore		Donorë të tjerë		Partnerët	Fillim			Fonde
				%	Lekë	%	Lekë	%	Lekë	%	Lekë					
16	Q2:O1:PG3:p3: Hartimi i një baze të dhënash dhe i programit përkatës kompjuterik me të gjithë adresat në Korçë	3,125,000	25,000	28	875,000	12	375,000	0	0	60	1,875,000	Ba, D	Tet. 2005	2006	KF	Q, I
17	Q2:O1:PG4:p1: Krijimi i hartave dixhitale për rrjetet inxhinierike të institucioneve vendore	3,125,000	25,000	32	1,000,000	0	0	0	68	2,125,000	Ba, I, Q	Tet. 2005	2006	KF	I, Q	
18	Q2:O2:PG1:p1: Rekonstrukcioni i rrugëve kryesore të qytetit	315,000,000	2,520,000	20	61,500,000	8	25,000,000	52	162,507,875	20	62,500,000	Ba, B	Maj 2005	2010	F, M, KF	Q
19	Q2:O2:PG1:p2: Rehabilitimi i rrugëve me kalldrëm dhe trotuareve në zonën e vjetër të qytetit	375,000,000	3,000,000	23	87,500,000	7	25,000,000	37	137,500,000	33	125,000,000	Ba, Q, D	Qer 2007	2010	KF	Q, Ba
20	Q2:O2:PG1:p3: Vendosja e sistemit të ndriçimit në të gjitha hapësirat publike të qytetit	6,250,000	50,000	40	2,500,000	0	0	10	625,000	50	3,125,000	Ba, Q	Jan. 2006	2007	KF	Q, Ba, B
21	Q3:O1:PG1:p1: Ndërtimi i mjediseve të reja me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe strehimit të studentëve të Universitetit të Korçës	112,500,000	900,000	0	0	0	0	0	0	100	112,500,000	Ba, B, D	Qer 2007	2008	KF	St, P
22	Q3:O2:PG1:p1: Rehabilitimi fizik i shkollave të mesme të qytetit	5,000,000	40,000	0	0	0	0	0	0	0	0					

Nr. i projektit	Titulli i projektit	Vlera (Lekë)	Vlera (€)*	Burimet e financimit										Zbatimi			Grupet e synuara	
				Bashkia		Komunitetet		Qeveria qendrore		Donorë të tjerë		Partnerët	Fillim	Fonde	Statusi†			
		%	Lekë	%	Lekë	%	Lekë	%	Lekë	%	Lekë							
23	Q3:O2:PG1:p2: Ngritja e një kompleksi modern për sportet në zonën midis shkollave “Demokracia” dhe “Naum Veqilharxhi”	18,750,000	150,000	33	6,250,000	0	0	33	6,250,000	0	0	33	6,250,000	Ba, D, Q	Qer 2006	2007	KF	Q
24	Q4:O1:PG1:p1: Ngritja e një qendre të informacionit turistik	2,500,000	20,000	25	625,000	0	0	50	1,250,000	0	0	25	625,000	Ba, T, B	Tet. 2005	2006	KF	T
25	Q4:O1:PG1:p2: Publikimi i kalendarëve vjetorë të aktiviteteve sportive dhe kulturore	250,000	2,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Ba, S	Jan. 2005	2005	M	Q, I
26	Q4:O2:PG1:p1: Rehabilitimi i mjediseve të teatrit “Andon Zako Çajupi”	12,500,000	100,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Ba, B	Tet. 2005	2006	KF	Q, A
27	Q4:O2:PG1:p2: Rindërtimi i Pazarit të Vjetër	125,000,000	1,000,000	20	25,000,000	20	25,000,000	20	25,000,000	40	50,000,000	40	50,000,000	Q, B	Jan. 2007	2010	KF	Q, B
28	Q4:O2:PG1:p3: Ndërtimi në qytet i një muzeu historik	31,250,000	250,000	20	6,250,000	40	12,500,000	40	12,500,000	0	0	0	0	H, Ba, D	Jan. 2007	2007	KF	Q
29	Q5:O1:PG1:p2: Ndërtimi i një vendi të ri për depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të qytetit	125,000,000	1,000,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Ba, D	Qer 2007	2008	KF	Q
30	Q5:O1:PG2:p1: Ngritja e një sistemi për monitorimin e cilësisë së ajrit të qytetit	2,500,000,000	20,000,000	0	0	0	0	0	0	0	100	2,500,000,000	0	Ba, D	Qer 2007	2010	M	Q, Ba



Nr. i projektit	Titulli i projektit	Vlera (Lekë)		Vlera (*)	Burimet e financimit						Zbatimi			Grupet e synuara		
		Vlera (Lekë)			Komunitetet		Qeveria qendrore		Donorë të tjerë		Partnerët	Fillim	Fonde		Statusit	
		%	Lekë	%	Lekë	%	Lekë	%	Lekë	%	Lekë					
31	Q5:O2:PGI:pl: Rehabilitimi i zonave të gjelbërta përgjatë rrugëve dhe shesheve kryesore të qytetit	0	0	5,000	0	0	0	0	0	0	0	DSh	Jan. 2006	2006	M	Q
32	Q5:O1:PGI:pl: Rehabilitimi i vendit aktual për hedhjen e mbeturinave urbane	33	12,500,000	300,000	10	3,750,000	0	0	0	33	12,500,000	Q, Ba, B	Jan. 2005	2010	F, M, KF	Q
	Totali		259,125,000	61,766,000		117,500,000		1,296,007,875			5,776,875,000					
	Përqindje		3.36	100.00		1.52		16.79			74.82					

*, 1 Euro = 125 Lekë

†, F, Filluar zbatimi; M, Miratuar fondi; KF, Kërkim fondi

d. Matrica e prioriteteve të projekteve

Plani Strategjik i Zhvillimit Ekonomik të bashkisë së Korçës		Qëllimi					Numri i pikëve
		Sigurimi i qëndrueshmërisë dhe rritjes së biznesit vendas duke mbështetur dhe koordinuar tërheqjen e bizneseve të reja	Krijimi i zhvillimit urban të qëndrueshëm të bashkisë në harmoni me vlerat urbane tradicionale dhe bashkëkohore	Transformimi i Korçës në një qendër arsimore për të gjithë rajoni e Shqipërisë juglindore duke përmirësuar arsimin në të gjitha nivelet dhe duke siguruar një force pune të kualifikuar	Ruajtja dhe zhvillimi i traditave historike, artistike dhe kulturore të qytetit në lidhje me zhvillimin e turizmit	Krijimi i një mjedisi të shëndetshëm që garanton një cilësi të përmirësuar të jetesës për qytetarët e Korçës	
Nr	Projekt	1	2	3	4	5	
1	Q1:O1:PG1:p1: Ndërtimi i një qendre shumëfunktionale për të organizuar panairë vendase dhe rajonale si dhe aktiviteteve të tjera	3					3
2	Q1:O1:PG1:p2: Krijimi i një Partneriteti Publik Privat (PPP), si një qendër kërkimore koordinuese në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor	2					2
3	Q1:O1:PG2:p1: Krijimi i një “Qendre me një ndalesë” (One-Stop-Shop) në bashkinë e Korçës për të lehtësuar procedurat për bizneset	3					3
4	Q1:O1:PG2:p2: Hartimi dhe miratimi i udhëzimeve instruksioneve për vendosjen e njoftimeve dhe shenjave të bizneseve dhe menaxhimi i fasadave në zonat tregtare	2					2
5	Q1:O1:PG3:p1: Realizimi i investimeve të përbashkëta nga bashkia, bizneset dhe komuniteti me qëllim përmirësimin e infrastrukturës në zonat ndërmjet ndërtesave të banimit dhe qendrave të argëtimit	3					3
6	Q1:O1:PG3:p2: Krijimi i një baze të dhënash me emrat e specialistëve në fusha të ndryshme me qëllim lehtësimin e identifikimit të tyre nga bizneset dhe punëmarrësit e mundshëm	2					2



No.	Projekt	1	2	3	4	5	Pik
7	Q1:O1:PG4:p1: Krijimi i një qendre trajnimit për zhvillimin profesional	3					3
8	Q2:O1:PG1:p1: Hartimi i një plani të kuptueshëm urban të qytetit duke respektuar traditat urbane dhe duke i bashkuar konceptet e reja ekonomike		3				3
9	Q2:O1:PG2:p1: Zhvillimi i zonës rreth “Varrezave Franceze” në një zonë të banueshme		3				3
10	Q2:O1:PG2:p2: Hapja ndaj zhvillimit urban e zonës nga hyrja e qytetit përgjatë rrugës së Ersekës në klinikën kryesore shëndetësore		3				3
11	Q2:O1:PG2:p3: Zbatimi i planit të pjesshëm urban për zonën midis unazës së qytetit pranë ish-zonës së depozitimit dhe rrugës kryesore automobilistike		3				3
12	Q2:O1:PG2:p4: Ndërtimi i rrjetit dhe sistemit të ri të ujërave të zeza		4				4
13	Q2:O1:PG2:p5: Rehabilitimi i sistemit shpërndarës elektrik duke përfshirë edhe atë të zonës industriale (Nënstacioni i Zemblakut)		4				4
14	Q2:O1:PG3:p1: Kompjuterizimi i menaxhimit të të dhënave dhe procedurave të punës së qeverisë vendore		3				3
15	Q2:O1:PG3:p2: Kompjuterizimi i zyrës së gjendjes civile		3				3
16	Q2:O1:PG3:p3: Hartimi i një baze të dhënash dhe i programit përkatës kompjuterik me të gjithë adresat në Korçë		3				3
17	Q2:O1:PG4:p1: Krijimi i hartave dixhitale për rrjetet inxhinierike të institucioneve vendore		3				3
18	Q2:O2:PG1:p1: Rekonstruksioni i rrugëve kryesore të qytetit		3				3
19	Q2:O2:PG1:p2: Rehabilitimi i rrugëve me kalldrëm dhe trotuareve në zonën e vjetër të qytetit		3				3
20	Q2:O2:PG1:p3: Vendosja e sistemit të ndriçimit në të gjitha hapësirat publike të qytetit		3				3

No.	Projekt	1	2	3	4	5	Pik
21	Q3:O1:PG1:p1: Ndërtimi i mjediseve të reja me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe strehimit të studentëve të Universitetit të Korçës			3			3
22	Q3:O2:PG1:p1: Rehabilitimi fizik i shkollave të mesme të qytetit			3			3
23	Q3:O2:PG1:p2: Ngritja e një kompleksi modern për sportet në zonën midis shkollave “Demokracia” dhe “Naum Veqilharxhi”			3			3
24	Q4:O1:PG1:p1: Ngritja e një qendre të informacionit turistik				2		2
25	Q4:O1:PG1:p2: Publikimi i kalendarëve vjetorë të aktiviteteve sportive dhe kulturore				2		2
26	Q4:O2:PG1:p1: Rehabilitimi i mjediseve të teatrit “Andon Zako Çajupi”				4		4
27	Q4:O2:PG1:p2: Rindërtimi i Pazarit të Vjetër				2		2
28	Q4:O2:PG1:p3: Ndërtimi në qytet i një muzeu historik				3		3
29	Q5:O1:PG1:p1: Rehabilitimi i vendit aktual për hedhjen e mbeturinave urbane					4	4
30	Q5:O1:PG1:p2: Ndërtimi i një vendi të ri për depozitim dhe trajtimin e mbetjeve të qytetit					4	4
31	Q5:O1:PG2:p1: Ngritja e një sistemi për monitorimin e cilësisë së ajrit të qytetit					2	2
32	Q5:O2:PG1:p1: Rehabilitimi i zonave të gjelbërta përgjatë rrugëve dhe shesheve kryesore të qytetit					3	3



e. Fishat e projekteve

<i>Nr 1</i>	Projekti Q1:O1:PG1:p1: Ndërtimi i një qendre shumëfunktionale për të organizuar panaire vendase dhe rajonale si dhe aktiviteteve të tjera	Lloji i programit Q1:O1:PG1: Sigurimi i kushteve, stimujve dhe hapësirave për zhvillimin e NVM
<p>Përshkrim i shkurtër i projektit</p> <p>Periudha e tranzicionit ka sjellë për Shqipërinë jo vetëm zhvillime përfutuese, por edhe aspekte negative. Zvogëlimi i numrit të popullsisë së vendit tregon për një përkeqësim të cilësisë dhe standardeve të jetës dhe aktivitetit ekonomik. Këto zhvillime kanë ndikuar në Korçë po aq shumë sa edhe në qytetet e tjera të Shqipërisë. Aktiviteti i saj privat ka nevojë për një imazh të ri dhe marketing të përmirësuar me qëllim që ai të bëhet konkurrues në rajon. Ky projekt synon të menaxhojë ndërtimin në qytet të një qendre shumëfunktionale për të organizuar panaire vendase dhe rajonale.</p> <p>Panaire të veçanta mund të organizohen në mënyrë periodike për të nxitur prodhimet, kërkimet studimore, teknologjinë ekzistuese dhe të re. Qendra do të shërbejë si një vend bashkëpunimi për të gjitha bizneset dhe do të jetë si një mjet publiciteti në duart e bizneseve të qytetit dhe qarkut duke i dhënë Korçës privilegjin e të qenurit një qendër të panaireve rajonale. Një tregues i suksesit do të jetë krijimi i një tradite për organizimin e panaireve.</p>		
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p>Krijimi i një tradite të organizimit të panaireve periodike Krijimi i një marketingu profesional Kthimi i Korçës në qendër rajonale të biznesit</p>		<p>Përfituesit</p> <p>Bizneset e qytetit dhe prefekturës Bizneset e tjera të Shqipërisë</p>
<p>Aktorët e mundshëm</p> <p>Bashkia dhe DhTI Bizneset e zonës Pronaret e tokës</p>		<p>Kontributet e mundshme në projekt</p> <p>Mbështetja financiare dhe teknike</p>
<p>Para kushtet</p> <p>Interesi i qeverisë vendore, institucioneve, komunitetit të biznesit për të mbështetur idenë Dëshira e donatorëve dhe bizneseve për të ofruar mbështetje financiare dhe asistencë Projekt me cilësi të lartë Truall toke në dispozicion për ndërtimin e ndërtesës</p>		<p>Faktorë rrezikues</p> <p>Buxhet i kufizuar Mungesa e donatoreve potenciale Gjetja e vendit ku do të ngrihet qendra</p>
<p>Shpenzimet e llogaritura</p> <p>Totali 120,000 euro</p>		
<p>Personi i kontaktit për projektin</p> <p>Bashkia</p>		
<p>Koha e zbatimit</p> <p>Një vit 2005–2010</p>		<p>Periudha e pritjes së rezultatit</p> <p>Pas vitit 2005</p>

<p>Nr 2</p>	<p>Projekti Q1:O1:PG1:p2: Krijimi i një Partneriteti Publik Privat (PPP), si një qendër kërkimore koordinuese në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor</p>	<p>Lloji i programit Q1:O1:PG1: Sigurimi i kushteve, stimujve dhe hapësirave për zhvillimin e NVM</p>
<p>Përshkrim i shkurtër i projektit</p> <p>Gjatë fazës përgatitore të projekteve të ndryshme zhvillimore, personel i bashkisë bashkëpunon me përfaqësues të grupeve të ndryshme të komunitetit. Procesi i aplikimit për financim dhe i monitorimit të projekteve është po aq i rëndësishëm sa edhe ai i përcaktimit të problemit dhe i hartimit të projektit. Shumë prej draftprojekte kanë fushë veprimi të gjerë dhe përfshijnë interesa të disa grupeve të komunitetit, institucioneve, organizatave, bizneseve, etj.</p> <p>Bashkëpunimi midis këtyre grupeve do t'i bëjë projektet të suksesshme. Kështu, ky projekt synon të krijojë një Partneritet Publik Privat (PPP) me qëllim identifikimin e problemeve të ndryshme me të cilat përballlet komuniteti, koordinimin e përpjekjeve të aktorëve të ndryshëm për të hartuar draftprojekt-plane dhe aplikimin për financim. Së fundmi, PPP do të monitorojë zbatimin e projekteve.</p> <p>Kjo një qendër do të presë kërkues nga një gamë e gjerë fushash për t'i paraprirë zhvillimi të strategjive apo planeve dhe projekteve konkrete. Ngritja e qendrës do të ndihmojë në materializimin e bashkëpunimit midis qeverisë vendore, bizneseve dhe komunitetit dhe do të ndihmojë në përmbushjen e nevojave të të gjithë palëve të përfshira.</p>		
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p>Krijimi i partneritetit midis të interesuarve Identifikimi i nevojave reale të zhvillimit ekonomik Hartimi i projekt-propozimeve në një mënyrë sa më profesionale Gjetja e fondeve të mundshme për zbatimin e projekteve</p>		<p>Përfituesit</p> <p>Komuniteti Biznesi Bashkia Institucionet</p>
<p>Aktorët e mundshëm</p> <p>Bashkia Biznesi vendas Institucionet shtetërore Donatorë Ekspertë</p>		<p>Kontributet e mundshme në projekt</p> <p>Miratimi nga Këshilli Bashkiak Identifikimi i të interesuarve Bashkëpunimi i qeverisë vendore me bizneset vendase dhe institucionet</p>
<p>Para kushtet</p> <p>Interesi i qeveria vendore, biznesit dhe institucioneve për të mbështetur idenë</p>		<p>Faktorë rrezikues</p> <p>Buxheti i pamjaftueshëm Mungesa e interesit nga ndonjë aktor për të bashkëpunuar</p>
<p>Shpenzimet e llogaritura</p> <p>Totali 15,000 euro</p>		
<p>Personi i kontaktit për projektin</p> <p>Bashkia</p>		
<p>Koha e zbatimit</p> <p>Viti 2005</p>		<p>Periudha e pritjes së rezultatit</p> <p>Nga viti 2005 në vazhdim</p>



Nr 3	Projekti Q1:O1:PG2: Përmirësimi i shërbimeve bashkiake që iu ofrohen bizneseve	Lloji i programit Q1:O1:PG2: Krijimi i një “Qendre me një ndalesë” (One-Stop-Shop) në bashkinë e Korçës për të lehtësuar procedurat për bizneset
<p>Përshkrim i shkurtër i projektit</p> <p>Realizimi i këtij projekti ka për qëllim të përmirësojë shërbimet e Bashkisë ndaj biznesit duke krijuar në bashki “Zyrën me një Ndalesë (One-Stop-Shop). Kjo zyrë do të thjeshtonte procedurat për zgjidhjen e kërkesave të biznesit në një kohë sa më të shkurtër dhe do të ofrojë informacion mbi shërbimet e ofruara nga bashkia, mbi detyrimet e bizneseve ndaj bashkisë, mbi kuadrin ligjor nën të cilin ata veprojnë dhe për t’i ndihmuar në kompletimin e dokumentacionit, etj.</p> <p>Suksesi i kësaj zyre do të varet shumë nga ekzistenca e një baze të dhënash informacioni që mund të jetë i dobishëm si për bizneset e reja ashtu edhe për ato ekzistuese. Për të zbatuar këtë projekt me sukses nevojiten të ndërmerren disa hapa të nevojshme që përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> Ngritja e zyrës “One Stop Shop”, pajisja me pajisjet e nevojshme (kompjuter, rrjet, fotokopje, printera, etj.); Përzgjedhja dhe trajnimi i personelit; Përgatitja dhe miratimi i paketës ligjore vendore për të siguruar zhvillimin dhe nxitjen e bizneseve vendase, qartësimi i marrëdhënieve dhe detyrimeve specifike të secilës palë, si dhe përgatitja e terrenit për bashkëpunim konkret; Identifikimi i paketave informuese të kërkuara nga bizneset dhe krijimi i klimës së favorshme për investime. <p>Zbatimi i këtij projekti do të përparojë paralelisht me kompjuterizimin e të gjithë departamenteve të bashkisë.</p>		
Rezultatet e pritshme Krijimi i zyrës “One Stop Shop” dhe pajisja me të gjitha materialet e nevojshme Sigurimi i një klime të favorshme për ofrimin me efikasitet të shërbimeve për bizneset Vendosja e bashkëpunimit konkret midis bashkisë dhe bizneseve		Përfituesit NVM ekzistuese Bizneset e reja Qeveria vendore
Aktorët e mundshëm Qeveria vendore Komuniteti i biznesit Donatorët		Kontributet e mundshme në projekt Bashkia Donatorët
Para kushtet Interesi i qeverisë vendore, institucioneve dhe komunitetit të biznesit për idenë Cilësi e lartë që përfshin të gjithë parametrat e nevojshëm		Faktorë rrezikues Buxhet i kufizuar Mungesa e personelit të kualifikuar
Shpenzimet e llogaritura Totali 15,000 euro		
Personi i kontaktit për projektin Bashkia		
Koha e zbatimit Një vit 2005–2006		Periodha e pritjes së rezultatit Pas vitit 2005

Nr 4	Projekti Q1:O1:PG2:p2: Hartimi dhe miratimi i instruksioneve për vendosjen e afisheve të bizneseve dhe realizimi i pamjes së jashtme të zonave ku tregtohet	Lloji i programit Q1:O1:PG2: Hartimi dhe miratimi i udhëzimeve instruksioneve për vendosjen e njoftimeve dhe shenjave të bizneseve dhe menaxhimi i fasadave në zonat tregtare
Përshkrim i shkurtër i projektit Për shkak të mungesës së udhëzimeve për vendosjen e reklamave dhe tabelave të bizneseve, si dhe për menaxhimin e fasadave në zonat tregtare, shumë probleme krijohen ndërmjet bizneseve dhe punonjësve të qeverisë vendore mbi pagesën e detyrimeve. Kështu, është me rëndësi që për këto çështje të krijohet transparencë dhe korrektësi. Udhëzimet e parashtruara në këtë projekt do të përmirësojnë shumë këtë situatë duke përcaktuar qartësisht detyrimet e sakta të bizneseve dhe bashkisë për sa i përket reklamimit dhe çështjeve të tjera përkatëse. Çdo pikë në udhëzim do të jetë konform me kërkesat e bizneseve dhe do të jenë të miratuara nga këshilli bashkiak. Si rezultat, çdo detyrim do të respektohet sipas konsensusit.		
Rezultatet e pritshme Krijimi dhe zbatimi i udhëzimeve për vendosjen dhe pagesën e reklamave Pagimi i taksave dhe detyrimeve me efikasitet dhe efektivitet për reklamat dhe tabelave të biznesit Rritja e sensibilizimit të bizneseve dhe qeverisë vendore mbi transparencën		Përfituesit Bizneset Qeveria vendore
Aktorët e mundshëm Qeveria vendore Bizneset Këshilli Bashkiak		Kontributet e mundshme në projekt Bashkia Bizneset
Para kushtet Hartimi i rregullores në përputhje me kërkesat e biznesit Miratimi nga këshilli bashkiak Hartimi i udhëzimeve në përputhje me kërkesat e bizneseve		Faktorë rrezikues Asnjë i identifikuar
Shpenzimet e llogaritura Totali 1,000 euro		
Personi i kontaktit për projektin Bashkia		
Koha e zbatimit 2005		Periudha e pritjes së rezultatit Pas janar 2005



Nr 5	Projekti Q1:O1:PG3:p1: Realizimi i investimeve të përbashkëta nga bashkia, bizneset dhe komuniteti me qëllim përmirësimin e infrastrukturës në zonat ndërmjet ndërtesave të banimit dhe qendrave të argëtimit	Lloji i programit Q1:O1:PG3: Zhvillimi i partneriteteve midis bashkisë, bizneseve dhe komunitetit në tërësi
Përshkrim i shkurtër i projektit Buxhet i kufizuar i bashkisë është shpesh një pengesë për zhvillimin e qytetit dhe si rrjedhim edhe në përmirësimin jetës së qytetarëve. Bashkëpunimi mes bashkisë, bizneseve dhe komunitetit është i rëndësishëm për zbatimin e shumë projekteve dhe për zgjidhjen e shumë problemeve. Komuniteti i biznesit shpesh ka ide dhe eksperiencë të mira për zgjidhjen e këtyre problemeve, por bashkëpunimi me komunitetin e biznesit shpesh ka qenë i pakët. Megjithatë, bashkia ka krijuar tani marrëdhënie shumë të mira me komunitetin e biznesit, duke hartuar së bashku draft projekte për zbatim. Mungesa e mjediseve të argëtimit në qytet është një nga problemet e mëdha. Bashkëpunimi mes bashkisë dhe bizneseve, do të ofrojë mundësinë e ndërtimit të një mjedisi modern argëtimi. Në këtë projekt, bashkia do të vërë në dispozicion një zonë për, p.sh. një pishinë dhe do të zbatojë projektin, kurse bizneset do të përgatitin planin e biznesit dhe financimin për një pjesë të projektit. Edhe komuniteti mund të kontribuojë financiarisht. Kjo praktikë mund të ndiqet nga ide të tjera të ndryshme të propozuara nga bashkia dhe bizneset.		
Rezultatet e pritshme Krijimi i një bashkëpunimi konkret, bashki-biznese-komunitet Përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve Zgjidhja e interesit të komunitetit të biznesit për të zgjidhur problemet e qytetit		Përfituesit Komuniteti Qeveria vendore Bizneset
Aktorët e mundshëm Komuniteti Qeveria vendore Bizneset		Kontributet e mundshme në projekt Bashkia Komuniteti i biznesit Donatorët
Para kushtet Interesi i qeverisë vendore, bizneseve dhe komunitetit për të mbështetur idenë Mundësia e shfrytëzimit të mjediseve nga ana e bashkisë Angazhim serioz për të përgatitur projekt cilësor		Faktorë rrezikues Vonesa në regjistrimin e pronave të qytetit Buxhet i kufizuar Dëshirë e pakët e bizneseve, komuniteti për të qenë partnerë
Shpenzimet e llogaritura		
Totali		200,000 euro
Personi i kontaktit për projektin Bashkia		
Koha e zbatimit 2005–2010		Periudha e pritjes së rezultatit 2005 e në vazhdim

<p>Nr 6</p>	<p>Projekti Q1:O1:PG3:p2: Krijimi i një baze të dhënash me emrat e specialistëve në fusha të ndryshme me qëllim lehtësimin e identifikimit të tyre nga bizneset dhe punëmarrësit e mundshëm</p>	<p>Lloji i programit Q1:O1:PG3: Zhvillimi i partneriteteve midis bashkisë, bizneseve dhe komunitetit në tërësi</p>
<p>Përshkrim i shkurtër i projektit Në themel të zhvillimit qëndron shkëmbimi i informacionit. Institucione dhe ekspertë të ndryshëm zotërojnë një gamë informacion që nuk është i lehtë për t'u gjetur dhe përdorur nga personat e interesuar dhe shpesh kjo vjen ngaqë ata thjesht nuk dinë se ku të kërkojnë. Aktualisht, personalitë i zgjidhin problemet nëpërmjet rrjetit të lidhjeve të tyre personal, miqësor, por edhe në këto raste ata nuk e gjejnë një zgjidhje optimale. Në shume raste problemet kërkojnë ndërhyrje profesionale. Një zgjidhje për këtë problem, për të lehtësuar gjetjen dhe përdorimin e informacionit të përshtatshëm, do të ishte krijimi i një rrjeti ekspertësh. Mund të krijohet një bazë e detajuar të dhënash për të gjithë specialistët sipas profesioneve. Për të gjetur personin e duhur dikush duhet vetëm të hyjë në rrjet, p.sh librat, për të cilat zgjidhja do të ishte krijimi i një rrjeti midis bibliotekave publike.</p>		
<p>Rezultatet e pritshme Krijimi i një baze të dhënash të detajuar që përmban informacione mbi fushat dhe specialistët Ofrimi i lehtësisë së përdorimit të rrjetit Mundësia e përdorimit të informacionit nga të gjithë Lehtësimi i zgjidhjes së problemeve të qytetarëve</p>		<p>Përfituesit Ekspertë nga fusha të ndryshme Qytetarët</p>
<p>Aktorët e mundshëm Ekspertët e interesuar për të qenë pjesë e rrjetit Qeveria vendore Donatorët</p>		<p>Kontributet e mundshme në projekt Bashkia Donatorët</p>
<p>Para kushtet Sigurimi i pjesëmarrjes së ekspertëve në këtë proces Tërheqja e interesit të donatorëve për të financuar këtë projekt</p>		<p>Faktorë rrezikues Buxheti i kufizuar</p>
<p>Shpenzimet e llogaritura Totali 20,000 euro</p>		
<p>Personi i kontaktit për projektin Bashkia</p>		
<p>Koha e zbatimit 2005–2007</p>		<p>Periudha e pritjes së rezultatit Pas 2005</p>



Nr 7	Projekti Q1:O1:PG4:p1: Krijimi një qendre trajnimi për zhvillimin profesional	Lloji i programit Q1:O1:PG4: Krijimi i mundësive për trajnimin e bizneseve
Përshkrim i shkurtër i projektit Kalimi në ekonominë e tregut të lirë kërkon përmirësimin e kualifikimeve të punonjësve në të gjitha institucionet shtetërore dhe ato private, si dhe e të gjithë individëve që duan të konkurrojnë në tregun e punës. Aktualisht, ka një kërkesë të lartë për trajnim në fusha të caktuara, për shembull bizneset kërkojnë operatorë kompjuteri që të kenë njohuri në përdorimin e një game programesh, në gjuhë të huaja, etj. Bashkia nxit dhe përkrah këto mundësi duke ofruar mbështetje institucionale. Fabrikat e dikurshme që zotëroheshin nga shteti, të cilat tani nuk janë funksionale dhe që janë degraduar, kanë filluar të ripërmirësohen për t'u përdorur për këtë iniciativë. Në një mjedis të tillë (fabrika e dikurshme e mjeteve të precizionit) do të ngrihet një zyrë dhe qendër formimi e financuar nga Ministria e Punës.		
Rezultatet e pritshme Ofrimi i trajnimeve profesionale Përmirësimi i profesionalizmit të të punësuarve dhe punëkërkuësve Nxitja e punonjësve Përmirësimi i cilësisë së punës		Përfituesit Studentët e universitetit Punonjësit e sektorit publik Punonjësit e sektorit privat
Aktorët e mundshëm Qeveria vendore Qeveria qendrore Bizneset Donatorët		Kontributet e mundshme në projekt Bashkia Donatorët
Para kushtet Miratim nga këshilli bashkiak i qëllimeve dhe funksioneve të pronave bashkiake Miratimi nga këshilli bashkiak i projektit Interesi i qeverisë qendrore Interesi i donatorëve		Faktorë rrezikues Buxhet i kufizuar
Shpenzimet e llogaritura Totali		70,000 euro
Personi i kontaktit për projektin Bashkia		
Koha e zbatimit 2005–2006		Periodha e pritjes së rezultatit Pas 2006

Nr 8	Projekti Q2:O1:PG1:p1: Hartimi i një plani të kuptueshëm urban të qytetit duke respektuar traditat urbane dhe duke i bashkuar konceptet e reja ekonomike	Lloji i programit Q2:O1:PG1: Hartimi i një kuadri rregullues për zhvillimin territorial të bashkisë
<p>Përshkrim i shkurtër i projektit</p> <p>Duke u nisur nga ndryshimet drastike demografike dhe ekonomike të ndodhura në qytet, ashtu si në të gjithë Shqipërinë, zhvillimi i një plani të ri urban është me rëndësi të veçantë. Ky projekt synon të zgjidhë probleme të ndryshme duke hartuar dhe zbatuar një plan të ri urban. Problemet e tij janë tani kritike dhe përfshijnë përmirësimin e infrastrukturës vendore dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik, zbutjen e varfërisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së të gjithë banorëve, si edhe mirëqenien e tyre.</p> <p>Ky projekt mund të realizohet duke ndërmarrë studimeve të planeve të pjesshme urbane. Projekti do të përfshijë hartimin e kushteve të parashtruara (termat e referencës) dhe kryerjen e studimeve urbane të qendrës së qytetit, të zonës kodrinore rrethuese, të zonës industriale të qytetit, etj.</p> <p>Zgjerimi demografik i qytetit, është një fenomen pozitiv, por ai mund të jetë edhe shkatërrimtar, ashtu si dëshmojnë qartësisht qytetet shqiptare në qoftë se nuk është hartuar një plan urban që t'i paraprijë zhvillimit urban. Planet duhet të jenë në përputhje me standardet bashkëkohore, duke përfshirë zhvillimin e qytetit në të ardhmen dhe do të lejojë bashkinë t'i menaxhojë mirë burimet e veta.</p>		
Rezultatet e pritshme Hartimi i planeve të pjesshme ekzekutive urbane Përcaktimi i zonës së ardhshme industriale Përmirësimi i mjedisit urban Përmirësimi i infrastrukturës vendore		Përfituesit Komuniteti Biznesi Qeveria vendore
Aktorët e mundshëm Qeveria vendore Biznesi vendas Donatorët Ekspertët Shoqëria civile		Kontributet e mundshme në projekt Bashkia Donatorët Bizneset vendase
Para kushtet Interesimi i qeverisë vendore dhe biznesit për të mbështetur idenë Dëshira e donatorëve për të mbështetur projektin me asistencë dhe financiarisht projektet tona		Faktorë rrezikues Buxheti i pamjaftueshëm Mungesë e donatorëve të mundshëm
Shpenzimet e llogaritura Totali 80,000 euro		
Personi i kontaktit për projektin Bashkia		
Koha e zbatimit Tre vjet 2005–2008		Periudha e pritjes së rezultatit Duke filluar nga 2008



Nr 9	Projekti Q2:O1:PG2:p1: Zhvillimi i zonës rreth “Varrezave Franceze” në një zonë të banueshme	Lloji i programit Q2:O1:PG2: Ndërtimi dhe rehabilitimi urban, koordinuar nga bashkia dhe institucionet vendore
Përshkrim i shkurtër i projektit Gjatë viteve të fundit, janë kryer një sërë studime urbanistike të pjesshme për zonat e reja të banimit në qytet. Për zonën e njohur si “Varreza e francezëve” ekziston një studim cilësor që është prezantuar publikisht dhe është mirëpritur si nga specialistë ashtu edhe nga qytetarët. Fatkeqësisht, zbatimi i këtij studimi është vonuar nga një numër pengesash të ndryshme ligjore dhe teknike. Zbatimi me sukses i këtij projekti, kërkon një bashkëpunim të ngushtë mes bashkisë dhe bizneseve të ndërtimit. Krijimi i partneritetit do të jetë e mundur që të diskutohen detajet e ndarjes së kostos dhe përfitimeve nga projekti. Bashkia dëshiron të arrijë disa qëllime duke zbatuar këtë projekt. Ajo synon ta zhvillojë këtë zonë si një zonë banimi me shërbim të mirë, si edhe të ofrojë strehim për familjet e pastreha në apartamentet që bashkia zotëron, në marrëveshje me bizneset. Rritja e numri të banorëve në këtë zonë do të nxitë edhe krijimin e bizneseve të reja, duke siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.		
Rezultatet e pritshme Krijimi i bashkëpunimit mes bashkisë dhe bizneseve të ndërtimit Krijimi i një zone banimi moderne Lehtësimin e situatës për familjet e pastreha Krijimi i bizneseve të reja	Përfituesit Bizneset e ndërtimit Familjet e pastreha Komuniteti vendas Qeveria vendore	
Aktorët e mundshëm Bashkia Bizneset e ndërtimit Donatorët	Kontributet e mundshme në projekt Bashkia Komuniteti i biznesit	
Para kushtet Përfundimi i procesit të privatizimit Krijimi i një bashkëpunimi publik-privat Miratimi i këshillit bashkiak	Faktorë rrezikues Vonesa në procesin e privatizimit Mungesë e burimeve financiare	
Shpenzimet e llogaritura Totali	300,000 euro	
Personi i kontaktit për projektin Bashkia		
Koha e zbatimit 2005–2010	Periudha e pritjes së rezultatit Pas 2005	

Nr 10	Projekti Q2:O1:PG2:p2: Hapja ndaj zhvillimit urban e zonës nga hyrja e qytetit përgjatë rrugës së Ersekës në klinikën kryesore shëndetësore	Lloji i programit Q2:O1:PG2: Ndërtimi dhe rehabilitimi urban, koordinuar nga bashkia dhe institucionet vendore
Përshkrim i shkurtër i projektit Zhvillimi dhe zgjerimi i qytetit të Korçës, kërkojnë jo vetëm ndërtimin e rrugëve të reja, por edhe rehabilitimin e zgjerimin e atyre ekzistuese. Shtimi i numrit të makinave në rrugë dhe i ndërtimeve të reja brenda dhe rrotull qytetit, ka dëmtuar rrugët ekzistuese, të cilat tani shpesh janë shumë të rënduara. Këto rrugë nuk kanë as cilësinë e duhur as nuk janë në vendin e duhur për të shërbyer si akset kryesore të qytetit. Hapja e zonës ndaj zhvillimit urban në hyrje të rrugës së Ersekës deri tek qendra kryesore shëndetësore, si edhe ndërtimi i rrugës do të ndihmojë në zgjidhjen e këtij problemi dhe do të lehtësojë rrjedhën e trafikut në qytet. Zbatimi i këtij projekti kërkon si ndërtimin e një rruge të re, ashtu edhe prishjen e disa shtëpive banimi, gjë që do të çojë në çështjen e shpronësimit të tokës dhe kompensimin e pronarëve të tokës. Zbatimi me sukses i projektit sipas standardeve bashkëkohore do të krijojë mundësi për hapjen e bizneseve të reja në zonë dhe do të ndihmojë në zhvillimin e zonës dhe atë të qytetit.		
Rezultatet e pritshme Përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve Përmirësimi i infrastrukturës urbane Krijimi i bizneseve të reja në zonë		Përfituesit Komuniteti Qeveria vendore Bizneset
Aktorët e mundshëm Qeveria vendore Bizneset Komuniteti Donatorët		Kontributet e mundshme në projekt Bashkia Donatorët Komuniteti
Para kushtet Shpronësimi nga toka dhe shpërblimi i mirë i pronarëve Interesi i qeverisë vendore, biznesit dhe komunitetit për të mbështetur idenë Fonde të mjaftueshme për të zbatuar projektin Angazhim serioz për të përgatitur projekt cilësor Gatishmëria e donatorëve		Faktorë rrezikues Probleme ngjate procesit të shpronësimit dhe kompensimit Buxhet i kufizuar Mungesa dëshirës së bizneseve ose komunitetit për të qenë partnerë Mungesa e donatorëve
Shpenzimet e llogaritura Totali 1,000,000 euro		
Personi i kontaktit për projektin Bashkia		
Koha e zbatimit 2005–2010		Periudha e pritjes së rezultatit Pas Zbatimit të projektit



Nr 11	Projekti G2:O1:PG2:p3: Zbatimi i planit të pjesshëm urban për zonën midis unazës së qytetit pranë ish-zonës së depozitimit dhe rrugës kryesore automobilistike	Lloji i programit Q2:O1:PG2: Ndërtimi dhe rehabilitimi urban, koordinuar nga bashkia dhe institucionet vendore
Përshkrim i shkurtër i projektit Për shkak të ndryshimeve demografike që kanë ndodhur në Korçë, rritja e qytetit kërkon studime të kujdesshme përpara zbatimit të projekteve në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm. Bashkia ka identifikuar zonat kryesore problematike lidhur me zhvillimin urban, por janë ndërmarrë edhe studime për disa pjesë të qytetit përfshirë këtu edhe zonën rreth mjediseve të ish-depos. Vonesat në zbatimin e projektit do të thonë që banorët vendas vazhdojnë të privohen nga infrastruktura e përshtatshme, ndërkohë që bizneset dështojnë të krijohen në zona të tilla. Zbatimi i këtij projekti të veçantë do të zgjerohet me anë të bashkëpunimit me komunitetin e biznesit, në veçanti me bizneset e ndërtimit, si dhe me institucionet përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të nevojshme ndaj komunitetit.		
Rezultatet e pritshme Sigurimi i një bashkëpunimi midis qeverisë vendore, bizneseve dhe institucioneve Zhvillimi normal dhe i qëndrueshëm i kësaj zone të qytetit Krijimi i hapësirave të reja për zhvillimin e bizneseve të reja Përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve	Përfituesit Komuniteti Institucione të ndryshme Bizneset Qeveria vendore	
Aktorët e mundshëm Qeveria vendore Institucionet Bizneset Donatorët	Kontributet e mundshme në projekt Bashkia Donatorët Komuniteti i biznesit	
Para kushtet Përcaktimi i kuadrit ligjor të projektit Interesimi i institucioneve, biznesit dhe donatorëve për të financuar projektin	Faktorë rrezikues Mungesa e bashkëpunimit institucional Buxhet i kufizuar	
Shpenzimet e llogaritura Totali 400,000 euro		
Personi i kontaktit për projektin Bashkia		
Koha e zbatimit Vite 2005–2010	Periudha e pritjes së rezultatit Pas 2005	

Nr 12	Projekti G2:O1:PG2:p4: Ndërtimi i rrjetit dhe sistemit të ri të ujërave të zeza	Lloji i programit Q2:O1:PG2: Ndërtimi dhe rehabilitimi urban, koordinuar nga bashkia dhe institucionet vendore
Përshkrim i shkurtër i projektit Në qytetin e Korçës janë zbatuar ose po zbatohen shumë projekte pilote të suksesshme. Në vijim të kësaj eksperience, është hartuar një projekt i madh për të ndërtuar një rrjet të ri të kanalizimit të ujërave të zeza. Rrjeti ekzistues është shumë i vjetër dhe i dëmtuar: ka shumë probleme me çarjen e tubave, etj. Shqetësim serioz përbën edhe derdhja e vazhdueshme e ujërave të zeza të patrajtuara në mjedis, në fusha, etj, duke ndotur kështu mjedisin e zonës ku ato derdhen. Me qëllim zgjidhjen e këtij problemi, projekti parashikon ndërtimin e një impianti dhe një sistemi të ri tubacionesh të përpunimit të ujërave të zeza. Ky është një projekt ambicioz, i cili ka tërhequr vëmendjen e disa donatorëve të mundshëm. Një pjesë shumë e rëndësishme e projektit është transparenca dhe ndërgjegjësimi i komunitetit për të mirat e projektit, të mira që do t'i vlejë në mënyrë të pashmangshme shqetësimeve të përkohshme, p.sh. ndërprerja e shërbimeve të ndryshme, si sistemi rrugor.		
Rezultatet e pritshme Ndërtimi i sistemit të ri të kanalizimeve të ujërave të zeza të qytetit Ndërtimi i impiantit të ri për trajtimin e ujërave të zeza të qytetit Përmirësimi i teknologjisë Përmirësimi i mjedisit		Përfituesit Komuniteti Qeveria vendore
Aktorët e mundshëm Institucionet Qeveria vendore Donatorët		Kontributet e mundshme në projekt Bashkia Donatorët
Para kushtet Interesi i qeverisë vendore, komunitetit dhe i institucioneve për të mbështetur këtë ide Ndërgjegjësimi dhe bindja e qytetarëve për të mirat e projektit Tërheqja e donatorëve		Faktorë rrezikues Mungesë e bashkëpunimit midis institucioneve Mungesë e bashkëpunimit të komunitetit Mungesa e donatorëve
Shpenzimet e llogaritura Totali 25,000,000 euro		
Personi i kontaktit për projektin Bashkia		
Koha e zbatimit Viti 2005–2006		Periudha e pritjes së rezultatit Pas 2006



Nr 13	Projekti G2:O1:PG2:p5: Rehabilitimi i sistemit shpërndarës elektrik duke përfshirë edhe atë të zonës industriale (Nënstacioni i Zemblakut)	Lloji i programit Q2:O1:PG2: Ndërtimi dhe rehabilitimi urban, koordinuar nga bashkia dhe institucionet vendore
Përshkrim i shkurtër i projektit Gjate periudhës së tranzicionit të Shqipërisë, shumë shërbime kanë pasur probleme të ndryshme. Një problem i tillë ka qenë edhe shpërndarja e energjisë elektrike për qytetarët. Një prioritet i madh për qeverinë vendore ishte instalimi i rrjetit të furnizimit me energji elektrike të tensionit të mesëm në parametrat optimale. Kështu në Zemblak, një fshat në rrethinat e Korçës, është ndërtuar një nënstation elektrik, kurse projekti që do të zbatohet këtë vit synon të ndërtojë një rrjet kabllor për 27 kabina të tensionit të lartë, që edhe këto duhet të rinovohen. Zonat që do të përfitojnë direkt nga projekti do të jenë zonat e banimit dhe industriale të qytetit të cilat do të kenë një shërbim të përmirësuar.		
Rezultatet e pritshme Përmirësimi i rrjetit shpërndarës të energjisë elektrik në qytet Sigurimi i energjisë elektrike në parametrat optimale Përmirësimi i kushteve për zhvillimin e biznesit në qytet Ofrimi i shërbimeve më të mira qytetarët		Përfituesit Qytetarët Bizneset
Aktorët e mundshëm KESH Qeveria vendore Donatorët		Kontributet e mundshme në projekt Bashkia Donatorët
Para kushtet Rinovimi i kabinave shpërndarëse Vendosja e bashkëpunimit midis qeverisë vendore, KESH dhe donatorëve		Faktorë rrezikues Mungesa e donatorëve
Shpenzimet e llogaritura Totali		5,000,000 euro
Personi i kontaktit për projektin Bashkia		
Koha e zbatimit Vitet 2005–2006		Periudha e pritjes së rezultatit Pas 2005

Nr 14	Projekti G2:O1:PG3:p1: Kompjuterizimi i menaxhimit të të dhënave dhe procedurave të punës së qeverisë vendore	Lloji i programit Q2:O1:PG3: Modernizimi i bashkisë dhe zyrës së gjendjes civile
Përshkrim i shkurtër i projektit Korça ka afërsisht 84.000 banorë, kurse stafi i bashkisë është prej 123 punonjësish. Edhe pse departamentet e ndryshme të bashkisë përpiqen shumë të koordinojnë aktivitetet e tyre në ofrimin e shërbimeve për komunitetin, sistemi është i tillë që e bën të pamundur evitimin e vonesave, ndërkohë që punonjësit e bashkisë janë të mbingarkuar. Qytetarët humbasin kohë duke shkuar sa nga njëri departament në tjetrin, ndërkohë që është e pamundur për punonjësit të kenë mundësi të menjëhershme për marrjen e informacionit të përshtatshëm. Qëllim i këtij projekti është të përmirësojë cilësinë e shërbimeve të ofruara nga bashkia, duke prezantuar një shërbim të shpejtë, modern, mbështetur në ligj dhe transparent. Kjo do të bëhet duke ngritur një sistem të ri për ofrimin e shërbimeve dhe një sistem modern. Për të arritur vizionin e tij, qyteti synon të: Konsolidojë në një sistem të unifikuar të kompjuterizuar të gjitha proceset që lidhen me kërkesat e qytetarëve; Ushtrrojë një proces monitorues të suksesshëm, transparent; Përmirësojë efikasitetin e procedurave me praktikatat më të mira dhe një sistem të përparuar të kompjuterizuar.		
Rezultatet e pritshme Përmirësimi i shpejtësisë dhe cilësisë në procesin e vendimmarrjes Monitorim më i mirë i proceseve Zbatim eficient i investimeve Përmirësim i planifikimit dhe kontrollit Standardizimi i informacionit Përmirësim i komunikimit Krijimin e kushteve më të mira të punës Rritja e përgjegjshmërisë së punonjësve		Përfituesit Punonjësit e bashkisë Qytetarët
Aktorët e mundshëm Qeveria vendore Dhoma e Tregtisë dhe e Industrisë Donatorët		Kontributet e mundshme në projekt Bashkia Donatorët
Para kushtet Interesi i qeverisë vendore dhe institucioneve për ta mbështetur idenë Dëshira e donatorëve për të dhënë mbështetje financiare dhe asistencë për projektin Projekt me cilësi të lartë		Faktorë rrezikues Buxhet i kufizuar Mungesa e donatorëve
Shpenzimet e llogaritura Totali		150,000 euro
Personi i kontaktit për projektin Bashkia		
Koha e zbatimit Një vit 2005		Periudha e pritjes së rezultatit Pas vitit 2005



Nr 15	Projekti G2:O1:PG3:p2: Kompjuterizimi i zyrës së gjendjes civile	Lloji i programit Q2:O1:PG3: Modernizimi i bashkisë dhe zyrës së gjendjes civile
Përshkrim i shkurtër i projektit Hapat e shpejtë të zhvillimit të qytetit kërkojnë ofrimin e shërbimeve për qytetarët me shpejtësi dhe cilësi. Përmirësimi i ofrimit të shërbimit është një problem konstant: praktika e përbashkët në të gjitha institucionet shqiptare është që qytetarët duhet të paraqitin një sërë certifikatash duke shkaktuar radha të panevojshme dhe duke krijuar pakënaqësira për shërbimet për të cilat ata kanë të drejtë që t'i marrin. Puna e punonjësve të gjendjes civile është shumë e komplikuar për shkak të përdorimit të një sistemi regjistrimi shumë të vjetër (të krijuar në vitin 1974) dhe numrit të madh të personave. Kompjuterizimi i zyrës së gjendjes civile është i rëndësishëm në riformimin e sistemit dhe në zgjidhjen e kërkesave të qytetarëve. Në të vërtetë, ekziston një ligj për kompjuerizimin e zyrave të gjendjes civile të vendit, por ai kërkon marrjen në punë ekspertëve të kompjuerit dhe punonjës regjistrimi, si edhe pajisjen e zyrës me kompjutera dhe pajisjeve ndihmëse. Ky projekt synon të vendosë pajisjet dhe të trajtojë punonjësit.		
Rezultatet e pritshme Transferimi i të gjitha të dhënave të regjistrit ekzistues në të dhënat bazë të kompjuerit Ofrimi i shpejtë i shërbimeve për qytetarët Lehtësimi i punës së punonjësve të zyrës së gjendjes civile	Përfituesit Komuniteti Qeveria vendore	
Aktorët e mundshëm Qeveria vendore Donatorët	Kontributet e mundshme në projekt Bashkia Donatorët	
Para kushtet Interesi i qeverisë vendore dhe i donatorëve për të mbështetur këtë ide Angazhim serioz për të përgatitur projekt cilësor	Faktorë rrezikues Buxhet i kufizuar Mungesa e donatorëve	
Shpenzimet e llogaritura Totali	8,000 euro	
Personi i kontaktit për projektin Bashkia		
Koha e zbatimit Një vit 2005	Periudha e pritjes së rezultatit Pas 2005	

Nr 16	Projekti G2:O1:PG3:p3: Hartimi i një baze të dhënash dhe i programit përkatës kompjuterik me të gjithë adresat në Korçë	Lloji i programit Q2:O1:PG3: Modernizimi i bashkisë dhe zyrës së gjendjes civile
<p>Përshkrim i shkurtër i projektit</p> <p>Qyteti i Korçës ka një arkitekturë karakteristike që e dallon nga qytetet e tjera të Shqipërisë dhe me interes për turistët. Megjithatë, shpesh është e vështirë për vizitorët të gjejnë vende me interes në qytet për shkak të sistemit të dobët të adresave dhe mungesës së emrave të rrugëve, shkaktuar pjesërisht nga rritja e ndërtimeve pa leje, por edhe nga dëshira e sistemit komunist për të mos e bërë të disponueshëm këtë informacion; ndoshta nga frika e pushtimit dhe ide e shkaktimit të konfuzionit tek pushtuesit. Shumë rrugë gjithashtu, në qytet kanë të njëjtin emër ose nuk kanë janë të ndara qartë. Për të gjitha këto arsye është e rëndësishme që rrugët të emërtohen dhe të pajisen me shenja, po ashtu edhe ndërtesat duhet të pajisen me numra ose emra</p> <p>Bashkia është në mes të procesit të emërtimit të të gjithë rrugëve dhe të numërimit të të gjitha ndërtesave; deri tani janë rregjistruar 300 rrugë dhe 20.000 shtëpi. Kryerja e këtij projekti është një element shumë i rëndësishëm i zhvillimit të qytetit. Edhe shërbimet e ofruara në qytet nga institucione të ndryshme, si: Telekom, KESH, etj, hasin vështirësi të shumta në identifikimin e adresave të klientëve. Përveç kësaj, zhvillimi i qytetit kërkon përgatitjen e materialeve të ndryshme promovionale, (p.sh harta, fletëpalosje, etj.). Turistë apo investues duhet të kenë mundësi për marrjen e këtij informacioni i cili jep me saktësi vendndodhjen e vendeve të ndryshme të interesit, kurse studimet e ardhme do të lehtësojnë ofrimin e informacionit të besueshëm.</p>		
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p>Krijimi një baze të qëndrueshme të dhënash Pajisja e çdo ndërtese në qytet me emrin ose numrin dhe e çdo rrugë me emrin specifik Përmirësimi i prezantimit të qytetit Drejtimi i zhvillimit sipas standardeve evropiane</p>		<p>Përfituesit</p> <p>Komuniteti Qeveria vendore Institucionet Bizneset Turistët dhe vizitorët</p>
<p>Aktorët e mundshëm</p> <p>Qeveria vendore Donatorët Bizneset vendase</p>		<p>Kontributet e mundshme në projekt</p> <p>Bashkia Donatorët</p>
<p>Para kushtet</p> <p>Interesi i qeverisë vendore dhe komunitetit të biznesit për të mbështetur këtë ide Studimi paraprak i situatës aktuale</p>		<p>Faktorë rrezikues</p> <p>Mungesë e burimeve financiare</p>
<p>Shpenzimet e llogaritura</p> <p>Totali 25,000 euro</p>		
<p>Personi i kontaktit për projektin</p> <p>Bashkia</p>		
<p>Koha e zbatimit</p> <p>Një vit 2005</p>		<p>Periudha e pritjes së rezultatit</p> <p>Pas vitit 2005</p>



Nr 17	Projekti Q2:O1:PG4:p1: Krijimi i hartave dixhitale për rrjetet inxhinierike të institucioneve vendore	Lloji i programit Q2:O1:PG4: Shkëmbimi i informacionit midis bashkisë dhe institucioneve vendore
Përshkrim i shkurtër i projektit Zhvillimi i qytetit është shumëplanesh. Frytet dhe të mirat e këtij zhvillimi janë të shumta dhe po kaq të shumta janë edhe problemet që sjell pas ai. Këto probleme kanë ardhur nga një mungesë bashkëpunimi i vazhdueshëm midis institucioneve të ndryshme dhe mungesë reagimi. Shembujt tipike përfshijnë gërmimet e herëpashershme të rrugëve nga institucione të ndryshme për qëllimet e tyre (energji elektrike, telefon, rrjetet e ujërave të pijshëm dhe të zeza). Gjithashtu, meqenëse këto institucione shpesh nuk kanë harta të sakta të rrjeteve të instalimeve, ka shumë dëmtime në kryerjen e instalimeve të reja duke shkatërruar kështu punën e bërë më parë dhe duke shkaktuar shqetësime të mëdha për qytetarët. Zgjerimi i qytetit dhe krijimi i lagjeve të reja kërkojnë shërbime që duhet të ndërmerren bazuar në hartografi të sakta. Në këtë projekt, do të mblidhen të dhënat nga të gjitha institucionet dhe do të futen në të dhënat bazë GIS për shtypjen e hartave dixhitale që përmbajnë rrjetet e shërbimit.		
Rezultatet e pritshme Mbledhja e vazhdueshme e të dhënave dhe vendosja e një bashkëpunimi të vazhdueshëm institucional Krijimi i hartave dixhitale të shërbimit Përmirësimi i cilësisë dhe sigurisë në shërbime	Përfituesit Institucionet Qeveria vendore	
Aktorët e mundshëm Komuniteti Qeveria vendore Bizneset Donatorët Institucionet	Kontributet e mundshme në projekt Bashkia Donatorët Institucionet dhe ndërmarrjet publike	
Para kushtet Interesi i qeverisë vendore dhe i institucioneve për të mbështetur idenë Vendosja e bashkëpunimit midis institucioneve Angazhim serioz në përgatitjen e projektit cilësor Tërheqja e donatorëve	Faktorë rrezikues Të dhëna të pamjaftueshme dhe të pasakta Mungesa e specialistëve për të zbatuar projektin Mungesa e donatorëve	
Shpenzimet e llogaritura Totali	25,000 euro	
Personi i kontaktit për projektin Bashkia		
Koha e zbatimit 2005–2007	Periudha e pritjes së rezultatit Pas 2007	

Nr 18	Projekti Q2:O2:PG1:p1: Rikonstruksioni i rrugëve kryesore të qytetit	Lloji i programit Q2:O2:PG1: Përmirësimi i rrugëve të qytetit dhe shërbimeve publike në bashkëpunim me komunitetin
Përshkrim i shkurtër i projektit		
<p>Përmirësimi i infrastrukturës së qytetit është një nga faktorët kryesorë që do të ketë një influencë të rëndësishme në zhvillimin e bizneseve të tij. Korça është duke u rritur në mënyrë të vazhdueshme dhe një numër më i madh projektsh zhvillimore nevojitet në veçanti për të përmirësuar infrastrukturën e qytetit. Lagje të reja po zhvillohen dhe ato kanë nevojë për shërbime bashkëkohore ndërsa pjesa më e madhe e rrugëve në lagjet e vjetra kane nevojë të rikonstruktohen.</p> <p>Përmirësimi i rrugëve të qytetit do të lehtësojë qarkullimin e rënduar të trafikut dhe do të reduktojë dëmtimin e makinave, autobuzëve dhe kamionëve. Përmirësimi i rrugëve është një pjesë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik të Korçës dhe e të gjitha strategjive që i shërbejnë qëllimeve të tij duke krijuar kushte të përshtatshme si për biznese të reja, ashtu edhe për ato ekzistueset.</p>		
Rezultatet e pritshme	Përfituesit	
Përmirësimi i infrastrukturës së transportit Krijimi i kushteve sa më të mira për krijimin e bizneseve të reja Krijimi i kushteve për zhvillimin e bizneseve ekzistuese	Komuniteti Bizneset Qeveria vendore	
Aktorët e mundshëm	Kontributet e mundshme në projekt	
Qeveria vendore Komuniteti Donatorët Komuniteti i biznesit	Bashkia Donatorët	
Para kushtet	Faktorë rrezikues	
Interesi i qeverisë vendore dhe komunitetit për të mbështetur këtë ide Dëshira e donatorëve për të ofruar mbështetje dhe financim Projekte cilësore	Buxheti i kufizuar Mungesa e donatorëve Mungesa e interesit të komunitetit për të bashkëpunuar	
Shpenzimet e llogaritura		
Totali	2,520,000 euro	
Personi i kontaktit për projektin		
Bashkia		
Koha e zbatimit	Periudha e pritjes së rezultatit	
Vitet 2005–2010	Nga viti 2005	



Nr 19	Projekti Q2:O2:PG1:p2: Rehabilitimi i rrugëve me kalldrëm dhe trotuareve në zonën e vjetër të qytetit	Lloji i programit Q2:O2:PG1: Përmirësimi i rrugëve të qytetit dhe shërbimeve publike në bashkëpunim me komunitetin
Përshkrim i shkurtër i projektit Qyteti i Korçës ka trashëguar nga e kaluara vlera të rëndësishme kulturore, artistike, historike etj. Periudha e vështirë e tranzicionit ka gjeneruar efekte negative të cilat rrezikojnë që artefaktet, gjurmët dhe traditat që shprehin këto vlera, të jenë dëmtuar ose mund të dëmtohen. Disa karakteristika që e diferencojnë qytetin e Korçës nga qytetet e tjera të Shqipërisë janë stili arkitekturor i shtëpive të qytetit dhe rrugët me kalldrëm. Ndërhyrjet e shumta për përmirësimin e rrjeteve të dobishme të qytetit, kanë dëmtuar seriozisht këto rrugë dhe më keq akoma, kanë shkaktuar tek familjet mosinteresim në traditën shumëvjeçare të mbajtjes pastër të rrugëve. Tani këto rrugë po prishen duke u mbushur gjatë verës me pluhur dhe gjatë dimrit me baltë. Një investim i konsiderueshëm prej 50 milion lekë bëri të mundur rehabilitimin e 15.000 m ² rrugë kalldrëm, por mbeten të pariparuara edhe 4.000 m ² të tjerë. Ruajtja e vlerave historike të tij, do të ndihmonte qytetin e Korçës për të ruajtur identitetin e vet dhe të rivendosë traditën e bukur për të mbajtur qytetin të pastër, që në mënyrë ultimative do të çonte në një numër më të madh të turistëve që do të vizitonin dhe do të qëndronin në qytet, dhe në të njëjtën kohë do të përmirësojë cilësinë e jetës për qytetarët e tij.		
Rezultatet e pritshme Ruajtja e traditave dhe vlerave kulturore dhe historike të qytetit Ruajtja e imazhit të Korçës si një qytet i veçantë Tërheqja e më shumë turistëve Përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve	Përfituesit Biznesi Komuniteti Qeveria vendore	
Aktorët e mundshëm Qeveria qendrore Donatorët Bizneset Komuniteti Qeveria vendore	Kontributet e mundshme në projekt Bashkia Donatorët	
Para kushtet Përcaktimi i zonave historike të mbrojtura të qytetit Interesi i donatorëve	Faktorë rrezikues Buxhet i kufizuar Mungesa e donatorëve	
Shpenzimet e llogaritura Totali 3,000,000 euro		
Personi i kontaktit për projektin Bashkia		
Koha e zbatimit Vite 2005–2010	Periudha e pritjes së rezultatit Pas 2005	

Nr 20	Projekti Q2:O2:PG1:p3: Vendosja e sistemit të ndriçimit në të gjitha hapësirat publike të qytetit	Lloji i programit Q2:O2:PG1: Përmirësimi i rrugëve të qytetit dhe shërbimeve publike në bashkëpunim me komunitetin
Përshkrim i shkurtër i projektit Stacioni i furnizimit me energji elektrike për shumë vite ka qenë një gjemb në këmbë për qytetin duke reduktuar cilësinë e jetës dhe duke penguar zhvillimin ekonomik. Ky problem është duke u zbutur pjesërisht nga një gamë projektesh që mbështeten nga donatorë të ndryshëm. Qyteti po rritet më shpejt se sa mundësia për mbështetje financiare nga bashkia. Megjithatë, vendosja e sistemit të ndriçimit rrugor në periferitë e qytetit jo vetëm që do të përmirësonte jetën e qytetarëve dhe do të ndihmonte zhvillimin e bizneseve, por do të rriste gjithashtu edhe sigurinë në këto zona. Aktualisht, rreth 60 për qind e rrugëve të qytetit kanë ndriçim duke përjashtuar zonat e reja të banimit dhe unazën. Për të zbutur problemin, nevojiten të instalohen edhe 500 ndriçues rrugorë.		
Rezultatet e pritshme Përmirësimi i cilësisë së jetës së komunitetit Krijimi i mundësive për qëndrimin e bizneseve të hapur edhe gjatë orëve të mbrëmjes Përmirësimi i sigurisë në zonat publike		Përfituesit Biznesi Komuniteti Qeveria vendore
Aktorët e mundshëm Qeveria vendore Bizneset vendase Komuniteti vendas Donatorët		Kontributet e mundshme në projekt Bashkia Donatorët
Para kushtet Krijimi i partneritetit midis qeverisë vendore, bizneseve dhe komunitetit Ndërgjegjësimi i qytetarëve për t'u kujdesur për investimin e bërë Interesi i donatorëve		Faktorë rrezikues Mungesa e bashkëpunimit midis palëve të interesuara dhe qeverisë vendore Buxheti i kufizuar Mungesa e donatorëve
Shpenzimet e llogaritura Totali		50,000 euro
Personi i kontaktit për projektin Bashkia		
Koha e zbatimit Vitet 2005–2006		Periudha e pritjes së rezultatit Pas 2006



Nr 21	<p>Projekti Q3:O1:PG1:p1: Ndërtimi i mjediseve të reja me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe strehimit të studentëve të Universitetit të Korçës</p>	<p>Lloji i programit Q3:O1:PG1: Rritja e cilësisë së standardeve dhe të mjediseve të mësimdhënies</p>
<p>Përshkrim i shkurtër i projektit Prania e universitetit është një aset për qytetin e Korçës dhe do të ndihmojë në zhvillimin ekonomik të tij, duke punësuar të diplomuarit në bizneset e qytetit. Të diplomuarit e shkolluar mirë dhe me cilësi do të krijojnë burimet e përmirësuara njerëzore të cilët do të mbështetin këtë zhvillim ekonomik. Aktualisht, funksionimi i mirë i universitetit është vënë në rrezik nga mungesa e mjediseve, ndërsa ato ekzistuese janë të shkatërruara. Ky projekt synon të përmirësojë këto mjedise duke krijuar hapësira të reja dhe duke vendosur infrastrukturën përkatëse, që do të jenë faktorë të rëndësishëm në përmirësimin e standardeve drejt atyre të universiteteve të tjera evropiane. Nga ana tjetër, shtimi i numrit të mjediseve të mësimdhënies, programeve dhe studentëve do të rritë pozitën e universitetit në qark, ndërsa bizneset do të përfitojnë nga një vërshim i madh i fluksit të të ardhurave në qytet si edhe me anë të rritjes së konkurrencës ndërmjet të diplomuarve.</p>		
<p>Rezultatet e pritshme Përmirësimi i mjediseve të mësimdhënies Shtimi i numrit të fakulteteve në universitet Përmirësimi cilësor i të diplomuarve Përmirësimi i burimeve personaore</p>		<p>Përfituesit Akademikët Studentët Bizneset Qeveria vendore</p>
<p>Aktorët e mundshëm Qeveria vendore Qeveria qendrore Bizneset Donatorët</p>		<p>Kontributet e mundshme në projekt Universiteti Ministria e Arsimit dhe e Shkencës Donatorët</p>
<p>Para kushtet Regjistrimi i pronave që zotëron qeveria vendore Miratimi nga këshilli bashkiak për vënien në dispozicion të universitetit të pronave të qytetit</p>		<p>Faktorë rrezikues Mosmiratim nga këshilli bashkiak i projektit Buxhet i kufizuar Mungesa e donatorëve</p>
<p>Shpenzimet e llogaritura Totali 900,000 euro</p>		
<p>Personi i kontaktit për projektin Bashkia</p>		
<p>Koha e zbatimit Vite 2005–2010</p>		<p>Periudha e pritjes së rezultatit Pas ndërtimit të ambienteve të reja</p>

Nr. 22	Projekti Q3:O2:PG1:p1: Rehabilitimi fizik i shkollave të mesme të qytetit	Lloji i programit: Q3:O2:PG1: Krijimi i kushteve për cilësinë e arsimit para-universitar
<p>Përshkrim i shkurtër i projekti</p> <p>Viti akademik 2005–2006 filloi mirë. Bashkia ka krijuar mundësi për rikonstruksionin e shkollave 9–vjeçare “Mësonjëtorja”, “Sevasti Qirjazi” dhe “Sotir Gura”, shkolla e re sportive, shkolla e mesme “Raqi Qirinxhi” dhe kopshti nr. 5. Megjithatë, ka shumë shkolla 9–vjeçare dhe të mesme që kanë nevojë të rikonstruktohen.</p> <p>Vitin tjetër bashkia do të rehabilitojë shkolla të tjera, duke u përqëndruar në veçanti në kushtet fizike të ndërtesave, mjediset sportive dhe muret rrethues, duke krijuar kështu kushte më të mira mësimdhënëse.</p> <p>Bashkia ka miratuar lejen e ndërtimit për rikonstruksionin e murit rrethues të kopshtit Nr.5 dhe shkollat në rrugën “Ajet Xhindole”, rikonstruksionin e shkollave 9–vjeçare “Stavri Themeli” dhe “Asdreni” si edhe të mjedisve sportive të shkollës “Raqi Qirinxhi”.</p>		
Rezultatet e pritshme Përmirësimi i mjedisit për mësimdhënien Shtimi i frekuentimit të shkollave publike		Grupet e synuara Qeveria vendore Fëmijët e shkollave Mësuesit
Aktorët e mundshëm Qeveria vendore Donatorët		Kontribuesit e mundshëm në projekt Bashkia Donatorët Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
Parakushtet Interesi i qeverisë vendore, mësuesve dhe nxënësve në mbështetjen e projektit		Faktorë rrezikues Buxhet i kufizuar Mungesa e donatorëve
Shpenzimet e llogaritura Gjithsej 40,000 euro		
Personi i kontaktit për projektin Bashkia		
Periudha e zbatimit Vite 2006–2007		Periudha e pritjes së rezultatit Pas 2006



Nr 23	<p>Projekti Q3:O2:PG1:p2: Ngritja e një kompleksi modern për sportet në zonën midis shkollave “Demokracia” dhe “Naum Veqilharxhi”</p>	<p>Lloji i programit: Q3:O2:PG1: Krijimi i kushteve për cilësinë e arsimit para-universitar</p>
<p>Përshkrim i shkurtër i projektit</p> <p>Zhvillimi i qytetit kërkon të shikohet me një këndvështrim afatgjatë. Megjithatë, duke pasur parasysh situatën aktuale ekonomike të vendit, ngritja e mjediseve argëtuese në zonat e reja urbane duket se i përket të ardhmes. Gjithsesi, zona pranë shkollave “Demokracia” dhe “Naum Veqilharxhi” strehon rreth 25,000 banorë shumë prej të cilëve janë të rinj ose fëmijë. Kompleksi sportiv që përdoret aktualisht ndodhet 4 km larg dhe nuk është e lehtë për t’u arritur, kurse fëmijët e vegjël nuk kanë asnjë vend për të luajtur të sigurtë.</p> <p>Ky projekt synon të ndërtojë një fushë voleybolli, dy fusha basketbolli, një fushë hendbolli, një kënd lojërash për fëmijët, dy gropa kërcimi se gjati dhe një kënd gjimnastike. Përveç këtyre, do të mbillen pemë dhe do të vendosë stola dekorativë.</p> <p>Mirëmbajtja dhe vazhdimësia e mjedisit do të varet nga përdoruesit. Për këtë arsye, gjatë ndërtimit të tij dhe më pas kur të mirëmbahet, do të ftohen të rinj që të kontribuojnë me punë vullnetare. Ata do të mësojnë mbi rëndësinë për t’u kujdesur mbi diçka që nevojitet.</p> <p>Paradite mjediset do të shfrytëzohen nga nxënësit e shkollës dhe pasdite, nga të rinj të tjerë të zonës, kundrejt një tarife të vogël që do të përdoret për mirëmbajtje.</p>		
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p>Përmirësimi i cilësisë së jetës Përmirësimi i shëndetit të të rinjve Krijimi i mjediseve argëtuese Krijimi i mjediseve për atletët</p>		<p>Përfituesit</p> <p>Të rinjtë vendas Fëmijët Komuniteti</p>
<p>Aktorët e mundshëm</p> <p>Qeveria vendore Bizneset vendase Komuniteti Donatorët</p>		<p>Kontributet e mundshme në projekt</p> <p>Bashkia Donatorët Komuniteti</p>
<p>Para kushtet</p> <p>Interesi i qeverisë vendore dhe komunitetit për të mbështetur këtë ide Dëshira e donatoreve për të mbështetur dhe ndihmuar financiarisht Projekt me cilësi të lartë</p>		<p>Faktorë rrezikues</p> <p>Buxhet i kufizuar Mungesa e donatorëve</p>
<p>Shpenzimet e llogaritura</p> <p>Totali</p>		<p>150,000 euro</p>
<p>Personi i kontaktit për projektin</p> <p>Bashkia</p>		
<p>Koha e zbatimit</p> <p>Vitet 2005–2010</p>		<p>Periudha e pritjes së rezultatit</p> <p>Pas ndërtimit të tij</p>

Nr 24	Projekti Q4:O1:PG1:p1: Ngritja e një qendre të informacionit turistik	Lloji i programit Q4:O1:PG1: Ndërtimi, në bashkëpunim me bizneset, i sistemeve të promovimit të potencialeve turistike të Korçës dhe zonave përreth
<p>Përshkrim i shkurtër i projektit</p> <p>Qyteti i Korçës ka trashëguar një pasuri të madhe me vlera historike dhe tradicionale. Shumë nga vizitorët dhe turistët largohen nga qyteti me përshtypje të mira dhe me dëshirën për t'u kthyer një herë tjetër në qytet. Përshtypjet janë të llojeve të ndryshme: natyrore, kulturore, historike, etj.</p> <p>Fatkeqësisht, qytetit i mungon expertiza për marketingun profesional. Për këtë arsye, ky projekt synon të krijojë një qendër rajonale të informacionit dhe një qendër për të ndihmuar në koordinimin e përpjekjeve të bizneseve që veprojnë në këtë sektor. Kjo zyrë do të sigurojë informacion rreth tërheqjeve dhe shërbimeve turistike, si hotelet, restorantet, çmimet, etj. Do të krijohen broshura sipas tipeve të biznesit dhe do të botohet një kalendar vjetor i aktiviteteve kulturore. Kjo gjë do të ndihmonte në shtimin e fluksit të turistëve në qark.</p>		
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p>Krijimi i një marketingu profesional mbi turizmin</p> <p>Tërheqja e më shumë turistëve</p> <p>Krijimi i kushteve për bashkëpunimin mes bashkisë dhe bizneseve për turizmin</p>		<p>Përfituesit</p> <p>Bizneset e turizmit</p> <p>Qytetarët</p>
<p>Aktorët e mundshëm</p> <p>Qeveria vendore</p> <p>Bizneset e turizmit të qarkut</p>		<p>Kontributet e mundshme në projekt</p> <p>Bashkia</p> <p>Donatorët</p> <p>Komuniteti i biznesit</p>
<p>Para kushtet</p> <p>Interesi i qeverisë vendore dhe biznesit për të mbështetur këtë ide</p> <p>Projekti cilësor dhe i realist</p>		<p>Faktorë rrezikues</p> <p>Mungesa e një bashkëpunimi konkret midis bashkisë dhe qytetit</p>
<p>Shpenzimet e llogaritura</p> <p>Totali 20,000 euro</p>		
<p>Personi i kontaktit për projektin</p> <p>Bashkia</p>		
<p>Koha e zbatimit</p> <p>Viti 2005</p>		<p>Periudha e pritjes së rezultatit</p> <p>Pas 2005</p>



Nr 25	Projekti Q4:O1:PG1:p2: Publikimi i kalendarëve vjetorë të aktiviteteve sportive dhe kulturore	Lloji i programit Q4:O1:PG1: Ndërtimi, në bashkëpunim me bizneset, i sistemeve të promovimit të potencialeve turistike të Korçës dhe zonave përreth
Përshkrim i shkurtër i projektit Zhvillimi i turizmit në qarkun e Korçës është një nga drejtimet e kryesore të parashikuara nga komuniteti i biznesit për zhvillimin e qytetit. Në bashkëpunim me bizneset e turizmit, bashkia ka ndërmarrë projekte të ndryshme për të promovuar dhe zhvilluar këtë sektor. Qendra e informacionit për turizmin (shih Q4:O1:PG1:p1:) dhe agjenci të tjera do të shpërndajnë guida, harta dhe materiale të ngjashme. Ky projekt synon të përgatisë hartimin i kalendarëve vjetorë të aktiviteteve kulturore dhe sportive, që do të ndihmojnë në tërheqjen e turistëve në qytet. Këto kalendarë do të përgatiten nga Departamenti i Kulturës dhe Sporteve pranë bashkisë në bashkëpunim me të gjitha institucionet e tjera që do të përfitojnë nga botimi i këtij materiali.		
Rezultatet e pritshme Nxitja e aktiviteteve kulturore të qytetit Rritja e numrit të turistëve vendas dhe të huaj që do të vizitojnë qytetin Përmirësimi i procesit të promovimit për bizneset Shtimi i numrit të aktiviteteve kulturore dhe sportive Stimulimi më i madh i mjedisit të qytetit		Përfituesit Turistët vendas dhe të huaj Bizneset e turizmit
Aktorët e mundshëm Institucionet e ndryshme kulturore dhe sportive Qeveria vendore Agjencitë turistike Donatorët		Kontributet e mundshme në projekt Bashkia
Para kushtet Mbledhja e të gjithë informacionit të duhur Krijimi i bashkëpunimit midis qeverisë vendore dhe bizneseve të turizmit		Faktorë rrezikues Mungesa e bashkëpunimit midis institucioneve që zotërojnë informacionin e duhur
Shpenzimet e llogaritura Totali		2,000 euro
Personi i kontaktit për projektin Bashkia		
Koha e zbatimit Vitet 2005–2006		Periudha e pritjes së rezultatit Pas 2005

Nr 26	Projekti Q4:O2:PG1:p1: Rehabilitimi i mjediseve të teatrit “Andon Zako Çajupi”	Lloji i programit Q4:O2:PG1: Promovimi cilësor i historisë dhe kulturës së qytetit nëpërmjet institucioneve publike
<p>Përshkrim i shkurtër i projektit</p> <p>Teatri “A.Z.Çajupi” është një institucion unik. Ai u inaugurua 40 vjet më parë, por ka një eksperience profesionale 50 vjeçare. Pas ndryshimeve që ndodhën në Shqipëri gjatë tranzicionit drejt demokracisë, teatri ka kapërcyer shumë vështirësi, por ka mbijetuar në sajë të punës, përkushtimit dhe pasionit të artistëve të tij. Duke qenë i vetmi institucion vendas, i cili ka një aktivitet profesional të përhershëm, është përgjegjësi e tij të plotësojë shumë nga nevojat artistike të komunitetit të zonës madje dhe më gjerë. Për shembull që në vitin 2000, ky institucion së bashku me bashkinë kanë organizuar festivalin e komedisë teatrale ndërkombëtare të njohur si “Ballkan 2000”.</p> <p>Fatkeqësisht, kushtet e ndërtesës dhe të mjediseve janë keqësuar dhe tani është një vend i papërshtatshëm për shfaqje, koncerte dhe drama, etj. Ndërtesa u ngrit në vitin 1953 dhe tani ka shumë nevojë të përtërihet. Rikonstruksioni i teatrit është i menjëhershëm dhe do të jetë një investim shumë i rëndësishëm në shërbim të zhvillimit kulturor të qytetit. Ky projekt synon të rehabilitojë teatrin dhe të mundësojë në të organizimin e shumë aktiviteteve dhe premierave në të ardhmen.</p>		
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p>Përmirësimi i mjediseve për artistët Përmirësimi i mjediseve për spektatorët Krijimi i kushteve për ringjalljen e jetës kulturore të qytetit</p>		<p>Përfituesit</p> <p>Artistët Qytetarët Turistët</p>
<p>Aktorët e mundshëm</p> <p>Qeveria vendore Komuniteti Donatorët</p>		<p>Kontributet e mundshme në projekt</p> <p>Bashkia Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Donatorët</p>
<p>Para kushtet</p> <p>Interesi i qeverisë vendore dhe komunitetit për të mbështetur këtë ide Interesi i donatoreve për të mbështetur këtë ide Projekti me cilësi të lartë</p>		<p>Faktorë rrezikues</p> <p>Mungesa e fondeve</p>
<p>Shpenzimet e llogaritura</p> <p>Totali 100,000 euro</p>		
<p>Personi i kontaktit për projektin</p> <p>Bashkia</p>		
<p>Koha e zbatimit</p> <p>Një vit 2005–2006</p>		<p>Periudha e pritjes së rezultatit</p> <p>Pas vitit 2005</p>



<p>Nr 27</p>	<p>Projekti Q4:O2:PG1:p2: Rindërtimi i Pazarit të Vjetër</p>	<p>Lloji i programit Q4:O2:PG1: Promovimi cilësor i historisë dhe kulturës së qytetit nëpërmjet institucioneve publike</p>
<p>Përshkrim i shkurtër i projektit</p> <p>Pazari i vjetër i Korçës është një nga monumentet e kulturës me të njohurat në qark. Si një faktor në zhvillimin ekonomik të qytetit gjatë shekullit XVII, ai paraqet interes të madh kulturor dhe historik. Pazari është rrënuar shumë dhe ka nevojë urgjente për t'u restauruar. Ndërtesat janë dëmtuar shumë dhe fasadat janë pothuajse të shkatërruara. Për shkak të tranzicionit drejt demokracisë dhe një ekonomie të hapur tregu, është e përshtatshme që pazari të silltet në kushtet e mëparshme, sepse me rëndësinë e tij ekonomike në historinë e qarkut ai edhe njëherë do të bëhet burim të ardhurash nëpërmjet tërheqjes së turistëve në qytet.</p> <p>Bashkia ka nisur përpjekjet për të bërë rikonstrukcionin e pazarit duke rehabilituar sistemin e kanalizimeve të ujërave të zeza dhe hyrjes tradicionale, por mbetet ende shumë për të bërë. Ky projekt synon rehabilitimin e plotë të pazarit, bazuar mbi një studim që është kryer ndërkohë.</p>		
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p>Kthimi në identitetin e Pazarit të Vjetër Zhvendosja e tregut ekzistues Krijimi i hapësirave të reja në Pazarin e Vjetër për veprimtarinë e bizneseve Ndërgjegjësimi i pronarëve të truallit mbi rëndësinë për të investuar si partnerë për rikonstruktimin e ndërtesave të tyre Shtimi i numrit të tërheqjeve turistike në Korçë</p>		<p>Përfituesit</p> <p>Qytetarët Qeveria bashkiake Bizneset</p>
<p>Aktorët e mundshëm</p> <p>Qeveria vendore Komuniteti Donatorët</p>	<p>Kontributet e mundshme në projekt</p> <p>Bashkia Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Donatorët</p>	
<p>Para kushtet</p> <p>Identifikimi i fondeve të nevojshme Identifikimi i donatorëve të nevojshëm</p>	<p>Faktorë rrezikues</p> <p>Mungesa e fondeve</p>	
<p>Shpenzimet e llogaritura</p> <p>Totali 1,000,000 euro</p>		
<p>Personi i kontaktit për projektin</p> <p>Bashkia</p>		
<p>Koha e zbatimit</p> <p>Vite 2005–2010</p>	<p>Periudha e pritjes së rezultatit</p> <p>Pas 2010</p>	

Nr 28	Projekti Q4:O2:PG1:p3: Ndërtimi në qytet i një muzeu historik	Lloji i programit Q4:O2:PG1: Promovimi cilësor i historisë dhe kulturës së qytetit nëpërmjet institucioneve publike
<p>Përshkrim i shkurtër i projektit</p> <p>Qyteti i Korçës ka një trashëgimi kulturore mjaft të madhe, e pasqyruar jo vetëm në traditat e popullit, por edhe në institucione të ndryshme kulturore. Qyteti ka disa muzeume, por ai nuk ka një Muzeum Historik.</p> <p>Ka shumë artefakte që zotërohen nga banorët dhe institucionet në qark për të cilat do të ishte më e përshtatshme të ekspozoheshin në një muzeum historik. Brezat e ardhshëm do të kenë mundësi të mësojnë më shumë për historinë e qarkut si edhe për episodet më të rëndësishme të zhvillimit të qytetit. Ky muzeum do të shërbejë si një shtysë për zhvillimin e ardhshëm, dhe në të njëjtën kohë do të tërheqë vizitorë në qytet.</p> <p>Realizimi i këtij projekti do të ishte mjaft i mundur nëse kapaciteti intelektual i qytetit koordinohet për të përgatitur materialet që duhet të ekspozohen në muzeum. Për këtë qëllim, bashkia do të vërë në dispozicion ose një truall të përshtatshëm ose një nga ndërtesat e saj.</p>		
Rezultatet e pritshme Zgjerimi i bazës kulturore të qytetit Krijimi i elementit të rëndësishëm në paraqitjen e historisë së vendit dhe popullit të tij Shtimi i interesit të rinjve për historinë e qytetit Shtimi i numrit të tërheqjeve turistike		Përfituesit Qytetarët Intelektualët Universiteti Historianët Qeveria vendore Bizneset e turizmit
Aktorët e mundshëm Historianët Qeveria vendore Donatorët		Kontributet e mundshme në projekt Bashkia Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Donatorët
Para kushtet Identifikimi i fondeve dhe i donatoreve Marrëveshja për sheshin e ndërtimit dhe miratimi i tij nga KRRt, <i>ose</i> identifikimi i ndërtesës dhe kthimi i saj në muzeum i aprovuar nga këshilli bashkiak Përfshirja në projekt e intelektualëve dhe historianëve		Faktorë rrezikues Mungesa e fondeve
Shpenzimet e llogaritura Totali 250,000 euro		
Personi i kontaktit për projektin Bashkia		
Koha e zbatimit Vitet 2005–2010	Periudha e pritjes së rezultatit Pas 2010	



Nr 29	Projekti Q5:O1:PG1:p2: Ndërtimi i një vendi të ri për depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të qytetit	Lloji i programit Q5:O1:PG1: Trajtimi i mbetjeve urbane sipas standardeve ligjore
Përshkrim i shkurtër i projektit Rehabilitimi i mjedisve aktuale të menaxhimit të mbetjeve në Korçë është një çështje urgjente. Në vijim të një studimi të fizibilitetit dhe përcaktimit të vendit të ri, vendi aktual nevojitet të mbyllet dhe të izolohet. Ai ndodhet mbi rezervuarin e qytetit dhe është i mbushur me të gjitha llojet e mbetjeve të hedhura pa kriter, duke ndotur mjedisin dhe duke vënë në rrezik ujin e pijshëm të qytetit. Problemi po bëhet edhe më i dukshëm rrotull zonave të banimit me gazrat e çliruara nga vendi duke u bërë edhe një problem më shumë për shëndetin. Ky projekt parashikon jo vetëm pastrimin e vendit aktual, por edhe kthimin e saj në një zonë të gjelbëruar, të tillë që të mund të përdoret në të ardhmen për qëllime argëtimi dhe që do të përmirësojë ndjeshëm cilësinë mjedisit rrethues.		
Rezultatet e pritshme Pastrimi i fushës ekzistuese nga mbeturinat Ruajtja e mjedisit nga ndotja Parandalimi i ndotjes së ujit të pijshëm Shtimi i zonave të gjelbëruara në qytet	Përfituesit Qytetarët Qeveria vendore	
Aktorët e mundshëm Qeveria vendore Komuniteti Donatorët OJQ	Kontributet e mundshme në projekt Bashkia Donatorët	
Para kushtet Identifikimi i fondeve dhe i donatoreve Përgatitja e projektit të detajuar për rehabilitimin e vendit të grumbullimit	Faktorë rrezikues Mungesa e fondeve	
Shpenzimet e llogaritura Totali 1,000,000 euro		
Personi i kontaktit për projektin Bashkia		
Koha e zbatimit Vite 2005–2010	Periudha e pritjes së rezultatit Pas 2010	

Nr 30	Projekti Q5:O1:PG1:p2: Ndërtimi i një vendi të ri për depozitim dhe trajtimin e mbetjeve të qytetit	Lloji i programit Q5:O1:PG1: Trajtimi i mbetjeve urbane sipas standardeve ligjore
<p>Përshkrim i shkurtër i projektit</p> <p>Në Shqipëri ruajtja e mjedisit po bëhet vazhdimisht prioritare në listën e prioritetëve. Përmirësimi i cilësisë së jetesës së qytetarëve është i lidhur ngushte me projekte të vazhdueshme që synojnë të promovuar një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.</p> <p>Një nga mënyrat më efektive në përmirësimin e mjedisit të qytetit është përmirësimi i teknikave të menaxhimit të mbetjeve urbane. Bashkia e Korçës po bashkëpunon me donatorë dhe ekspertë ndërkombëtarë për një projekt për të ndërtuar një vend të ri të grumbullimit dhe përpunimit të mbeturinave urbane, e cila do t'i shërbejë të gjithë komuniteteve të prefekturës. Ka përfunduar studimi i fizibilitetit dhe është miratuar nga Komisioni Shtetëror i Rregullimit të Territorit, sheshi, në Maliq disa kilometra në veri të Korçës, për ndërtimin e impiantit të trajtimit të mbeturinave. Ndërkohë, bashkitë dhe komunat e prefekturës kanë nënshkruar një memorandum mirëkuptimi në lidhje me përdorimin e këtij vendi.</p> <p>Zbatimi i këtij projekti do të zgjidhë shumë probleme të ndotjes të shkaktuara nga mbetjet urbane të qytetit dhe në të njëjtën kohë do t'i shërbejë të gjithë nevojave të prefekturës.</p>		
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p>Ndërtimi i vendit të grumbullimit me standarde bashkëkohore</p> <p>Përpunimi eficient i mbeturinave urbane</p> <p>Përmirësimi i teknikave për mbrojtjen e mjedisit</p> <p>Përdorimi i vendit nga të gjitha bashkitë dhe komunat e prefekturës</p>		<p>Përfituesit</p> <p>Komuniteti</p>
<p>Aktorët e mundshëm</p> <p>Donatorët</p> <p>Qeveria vendore</p>		<p>Kontributet e mundshme në projekt</p> <p>Bashkia</p> <p>Donatorët</p>
<p>Para kushtet</p> <p>Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit midis bashkive dhe komunave</p> <p>Interesi i donatorëve</p>		<p>Faktorë rrezikues</p> <p>Mungesa e donatorëve</p>
<p>Shpenzimet e llogaritura</p> <p>Totali 20,000,000 euro</p>		
<p>Personi i kontaktit për projektin</p> <p>Bashkia</p>		
<p>Koha e zbatimit</p> <p>Vite 2005–2007</p>		<p>Periudha e pritjes së rezultatit</p> <p>Pas 2005</p>



Nr 31	Projekti Q5:O1:PG2:p1: Ngritja e një sistemi për monitorimin e cilësisë së ajrit të qytetit	Lloji i programit Q5:O1:PG2: Zvogëlimi i ndotjes së ajrit në qytet
Përshkrim i shkurtër i projektit Studimi i cilësisë së ajrit të qytetit të Korçës realizuar nga Drejtoria e Rajonale e Kujdesit Shëndetësor Parësor në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik Tiranë zbuloi nivele të ndotjes shumë herë më të larta se sa nivelet e maksimumit të caktuara nga OBSH në lidhje me pluhurin. Kjo çështje e veçantë ka të bëjë me copëza të mëdha pluhuri të shpërndara nga gomat e makinave dhe të prodhuara nga punët e ndërtimit dhe nga automjetet e dëmtuara, si edhe nga rrugët e paasfaltuara. Rrugët ekzistuese me kalldrëm nuk pastrohen më nga autoritetet publike dhe as nuk riparohen shpejt duke shkaktuar probleme në rritje të ndotjes. Pjesët e shpërndara dëmtojnë pjesën e sipërme të sistemit të frymëmarrjes dhe sytë. Disa pjesë madje depërtojnë në indin mushkëror dhe p.sh plumbi, kadmiumi dhe hidrokarburet aromatike policiklike dëmtojnë alveolat duke shkaktuar bronkit kronik. Nivelet e larta të plumbit janë shkaktarë për deformimet e lindura dhe zhvillimin e vogël të sistemit nervor. Monitorimi i vazhdueshëm i këtyre parametrave do t'u japë informacion institucioneve përgjegjëse për t'i zgjidhur këto probleme.		
Rezultatet e pritshme Mirëmbajtja e mjedisit të pastër Sigurimi i informacionit të vazhdueshëm në komunitetin mbi nivelet e ndotjes Përmirësimi i shërbimeve për të ruajtur mjedisin	Përfituesit Komuniteti Qeveria vendore	
Aktorët e mundshëm Drejtoria e Kujdesit të Shëndetit Parësor në Korçë Bashkia Institutin e Shëndetit Publik, Tiranë Donatorët	Kontributet e mundshme në projekt Bashkia Ministria e Mjedisit Donatorët	
Para kushtet Krijimi i bazës së përshtatshme të të dhënave Krijimi i bashkëpunimit institucional Disponueshmëria e pajisjeve të përshtatshme	Faktorë rrezikues Mungesë bashkëpunimi midis institucioneve vendore dhe kombëtare Vonesa në shërbimet për zgjidhjen e problemeve të tilla	
Shpenzimet e llogaritura Totali 5,000 euro		
Personi i kontaktit për projektin Bashkia		
Koha e zbatimit Vite 2005–2010	Periudha e pritjes së rezultatit Pas 2005	

<p>Nr 32</p>	<p>Projekti Q5:O2:PG1:p1: Rehabilitimi i zonave të gjelbërta përgjatë rrugëve dhe shesheve kryesore të qytetit</p>	<p>Lloji i programit Q5:O2:PG1: Shtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara të qytetit, rrugëve dhe shesheve të tij</p>
<p>Përshkrim i shkurtër i projektit</p> <p>Ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm demokratik në Shqipëri, kërkon një qeverisje efçente dhe transparente. Është e rëndësishme përfshirja e qytetarëve në procesin e vendim-marrjes dhe në zbatimin e projekteve të përbashkëta.</p> <p>Drejtimesit e qytetit të Korçës dhe komunitetet përreth kanë vendosur të punojnë së bashku në projekte të cilat do t'i sjellin më afër qytetarët njërit-tjetrit dhe më pranë qeverisë dhe do t'i aftësojnë ata të marrin pjese në këtë proces, duke i ndërgjegjësuar për mënyrën e shpenzimit të fondeve dhe cilësinë e rezultatit. Zbatimi i këtij projekti do të promovuar partneritetin publik-privat në qark.</p> <p>Familjet në periferi janë shpesh shumë të varfra. Kushtet aktuale të zonave në të cilat ato jetojnë është e tmerrshme, kurse vendet e hapura dhe rrugët janë plot me plehra dhe gjatë verës mbulohen nga pluhuri, kurse gjatë dimrit nga balta. Shpesh qytetarët i përhapin plehrat duke rrezikuar kështu më shumë shëndetin e tyre.</p> <p>Kohët e fundit, kjo situatë është përmirësuar dhe me këtë zhvillim pozitiv projektet për mjedisin kanë marrë një status të veçantë. Ky projekt parashikon shndërrimin e këtyre hapësirave ekzistuese të lira në parqe dhe kënde lojërash për fëmijët.</p>		
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p>Nxitja e interesit për të ndryshuar ofrimin e shërbimit</p> <p>Përfshirja e komunitetit në vendim-marrje</p> <p>Zgjidhja e problemeve të komunitetit</p> <p>Ide dhe sugjerime mbi përdorimin efçent të një buxheti të kufizuar</p> <p>Rritja e sensibilizimit të komunitetit mbi arsyet dhe mënyrat e marrjes së vendimeve</p>		<p>Përfituesit</p> <p>Komuniteti</p> <p>Qeveria vendore</p> <p>Komuniteti i biznesit</p>
<p>Aktorët e mundshëm</p> <p>Qeveria vendore</p> <p>Komuniteti</p> <p>Donatorët</p>	<p>Kontributet e mundshme në projekt</p> <p>Bashkia</p> <p>Donatorët</p> <p>Komuniteti</p>	
<p>Para kushtet</p> <p>Interesi i qeverisë vendore dhe komunitetit për të mbështetur këtë ide</p> <p>Interesi i donatoreve për të mbështetur projektin</p> <p>Hapësirat e gjelbra konsiderohen si investim prioritar</p>	<p>Faktorë rrezikues</p> <p>Buxheti i kufizuar</p> <p>Mungesë e donatorëve të mundshëm</p> <p>Mungesa e interesit të komunitetit për të bashkëpunuar</p>	
<p>Shpenzimet e llogaritura</p> <p>Totali 300,000 euro</p>		
<p>Personi i kontaktit për projektin</p> <p>Bashkia</p>		
<p>Koha e zbatimit</p> <p>Dy vjet 2005–2007</p>	<p>Periudha e pritjes së rezultatit</p> <p>Pas 2005</p>	



Aneksi. Raporti mbi “Monitorimin i krijimit të klimës së biznesit në qytet”

Hyrje

Sondazhi mbi biznesin që përbën një pjesë të hartimit të Strategjisë u zhvillua gjatë periudhës Mars–Prill, 2004 dhe përfundimet janë raportuar më poshtë. Qëllimi i sondazhit ishte përfitimi i të dhënave të tjera për procesin e planifikimit të Zhvillimit Ekonomik Vendas në bashkinë e Korçës. Në të njëjtën kohë, mënyra se si sondazhi u krye kishte për qëllim të japë përvojë bashkisë sidomos Zyrës së Zhvillimit.

Raporti i mëposhtëm është një prezantim i shkurtër i përfundimeve kryesore të sondazhit. Gjithashtu është përfshirë edhe një raport më i gjerë që bën krahasimin e punës së bërë të pesë bashkive pjesëmarrëse në DELTA. Të dhënat e sondazhit janë të disponueshme elektronikisht, duke i dhënë mundësinë çdo bashkie të bëjë analiza të mëtejshme sipas nevojave të tyre.

Ky sondazh, i cili u analizua nga Z. Gent Dakoli, u krye në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Zhvillimit Ekonomik në bashkinë Korçës. Znj. Albana Çule dha një kontribut të veçantë në organizimin e sondazhit, me asistencën e Z. Fatlum Nurja.

Përshkrimi statistikor i modelit të bizneseve të intervistuar

- Shtatëdhjetë biznese që veprojnë në Korçë u intervistuan, që përfaqësonin rreth 3.9 për qind të bizneseve të regjistruara me bashkinë (1,800 biznese sipas listës së siguruar nga bashkia).
- Opinionet u mblodhën nga përfaqësuesit e mëposhtëm të biznesit: pronarë në 54 biznese, menaxherë të përgjithshëm në gjashtë biznese dhe menaxherë të lartë në dhjetë biznese.
- Dyzet e gjashtë nga 70 bizneset kishin një pronar, pesë ishin kooperativa dhe nëntëmbëdhjetë kishin më shumë se një pronar
- Njëzet e katër biznese ishin biznese prodhuese, 25 merreshin me tregti, 15 në ofrimin e shërbimeve dhe gjashtë ishin biznese ndërtimi.
- Koha që bizneset kishin qenë aktivë varionte nga një deri dhjetë vjet, me shumicën aktive nga gjashtë deri dhjetë vjet.
- Tridhjetë e shtatë biznese raportuan se kishin më pak se pesë punonjës (më shumë një), dhjetë kishin gjashtë deri dhjetë punonjës, 16 kishin njëmbëdhjetë deri 50 punonjës dhe shtatë më shumë se 50 punonjës.

Gjetjet kryesore

Opinione rreth klimës së biznesit në Korçë

- 54% e bizneseve raportuan se ishte e vështirë për ta të gjenin punonjës të kualifikuar, ndërsa 34% raportuan të kundërtën. (Pyetja 9.)
- 40% raportuan se s’kishin aftësitë e shitjes, marketingut dhe menaxhuese (të marra së bashku). (Pyetja 10.)
- 58% raportuan se burimi i vetëm i konkurrencës ishin bizneset vendase, ndërsa 26% e tyre raportuan importet si konkurentin kryesor. (Pyetja 11.)
- Ka një numër shoqatash biznesi në qytet. (Pyetja 12.) 33% e bizneseve raportuan se këto shoqata po bënin një punë të mirë. (Pyetja 22.)
- 70% e bizneseve raportuan se ju nevojiteshin 10–40 ditë të rinovonin liçencat tyre. Vetëm 10% raportuan se iu nevojiteshin më pak se 10 ditë. (Pyetja 16.)
- Përveç çështjes së furnizimit me energji elektrike, shërbimet e tjera publike nuk konsiderohen si problem i madh. (Pyetja 21.)
- 65% e bizneseve raportuan ish-in inspektuar më pak 5 herë nga autoriteti tatimeve. 19% raportuan se kishin paguar gjobë dhe 4% se i kishin dhënë ryshfet autoriteti tatimeve. (Pyetja 20.)
- 41% e bizneseve raportuan se mjedisi i biznesit është përmirësuar dhe 39% thanë të kundërtën. (Pyetja 33.)
- 27% e bizneseve raportuan se Departamenti i Taxa-tatimeve ka një ndikim negativ në biznesin e tyre. (Pyetja 25.)
- 3 problemet më të mëdha që bizneset kishin në lidhje me marrëdhëniet me qeverinë vendore ishin: korrupsioni dhe praktikat joligjore, kostot (shumë të larta dhe të paparashikuara; lidhur me taksat vendore) dhe mungesa e rregulloreve të qarta. (Pyetja 17.)

Pritshmëritë e bizneseve

- 50% e bizneseve raportuan se ata kanë planifikuar të investojnë brenda në bashki. 19% raportuan se ata kanë planifikuar të investojnë si brenda dhe jashtë bashkisë. (Pyetja 8.)
- Tre pritshmëritë më të përmendura ishin: reduktimi i taksave (51%), barazi për të gjithë bizneset (49%) dhe përmirësimi i infrastrukturës (20%). (Pyetja 18.)



- 20% e bizneseve priste që bashkia të ofrojë stimuj financiarë nëpërmjet politikave të veta mbi taksat lokale.

Sensibilizimi i bizneseve për funksionet e bashkisë

- 70% dhe 67%, përkatësisht, e bizneseve raportuan se nuk e dinin për rolin e zyrave të ZhEV dhe DAR. (Pyetja 22.)
- 76% e bizneseve raportuan se nuk kishin dijeni për organizatat profesionale apo për rolin që luajnë këto shoqata. (Pyetja 22.)
- 46% e bizneseve nuk ishin në dijeni të shërbimeve private profesionale që ishin të gatshme në bashki. (Pyetja 22.)
- 59% e bizneseve nuk e dinin ose nuk e raportuan cili nga departamentet e bashkisë ka luajtur një rol pozitiv në biznesin e tyre (Pyetja 24), ndërsa më shumë se 50% nuk emërtuan një departament që kishte një efekt negativ. (Pyetja 25.)
- Mbi 80% e bizneseve nuk e njihnin një departament në bashki që merrej me Zhvillimin Ekonomik Vendor. (Pyetja 26.)

SWOT (në pyetësor)

Pikat e forta

- Pozita gjeografike: lidhur me të qenurit pranë kufijve kombëtarë, bollshmëri në toka bujqësore të pasura që mund të përdoret në bujqësi, burimet turistike, etj;
- Popull i arsimuar dhe i bindur: të arsimuar në lidhje me etikën dhe shprehitë teknike; i bindur përse i përket ligjit;
- Kosto e ulët pune: pagat në zonë janë të ulëta.

Mundësitë

- Pritshmëri realiste të bizneseve: më shumë se 75% e bizneseve raportuan se do të ishin të lumtur nëse licencat e tyre të mund të rinovoheshin brenda 10 ditëve;
- Pjesa më e madhe e pritshmërive të bizneseve nuk përfshin kosto të larta, kryesisht procedura të përmirësuara;
- Komuniteti i biznesit dëshiron të bashkëpunojë dhe ka shumë ide;
- Shumë biznese do të preferonin të qëndronin brenda bashkisë.

Pikat e dobëta

- Infrastrukturë e dobët;
- Furnizim i dobët me energji elektrike;
- Nivel i ulët i zhvillimit ekonomik: fuqia blerëse e popullsisë është shumë e ulët dhe popullsia vendase ka një zakon që të mos shpenzojë shumë;
- Madhësia e vogël e tregut vendas: në këtë kuptim, pozita gjeografike bëhet pikë e dobët sepse qyteti është shumë larg nga tregjet e tjera kryesore të vendit;
- Politikë e dobët mbi taksat.

Kërcënimet

- Një numër i konsiderueshëm i bizneseve, veçanërisht i bizneseve të mëdha, po mendojnë të zhvendosen;
- Korrupsioni: ky përmendet shumë herë si një pengesë shumë e madhe;
- Perceptimi i bizneseve për qeverinë vendore është më shumë i lidhur me burokracinë, korrupsionin dhe paaftë sinë;
- Ekonomia informale: një nga faktorët më të rëndësishëm që redukton numrin e bizneseve të licencuara;
- Mungesa e sensibilizimit dhe, për rrjedhojë mosangazhimi i komunitetit të biznesit me politikën e bashkisë që synojnë zhvillimin ekonomik.

